

RAPORT MBI PROCESIN E RINDËRTIMIT



Fakt@je.al

RAPORT MBI PROCESIN E RINDËRTIMIT

TABELA E PËRMBAJTJES

A. Financimi i procesit të rindërtimit	5
A.1. Kredi nga konferenca e donatorëve	5
A.2. Grante nga konferenca e donatorëve	7
A.3. Grante të tjera nga donatorë	10
A.4. Buxheti i Shtetit	11
A.5. Alokimi i fondeve me VKM	12
A.6. Disiplina buxhetore e investimeve të procesit të rindërtimit	15
B. Raportimi financiar i procesit të rindërtimit, output-et dhe problematika të identifikuara	20
B.1. Realizimi i fondit të rindërtimit sipas natyrës dhe njësive zbatuese	20
B.2. Grantet e rikonstruksionit sipas bashkive	29
B.3. Demolimi i pallateve ekzistuese	30
B.4. Objektet arsimore dhe financimi tyre	48
B.5. Katër çështje mbi përfituesit nga programi rindërtimit	90
C. Transparenca dhe Llogaridhënia	96
C.1. Raporti i Zbatimit të Buxhetit 2020	96
C.2. FMN	98
C.3. KLSH	98
C.4. Portali i Rindërtimit	99
C.5. Ecuria e kërkesave për informacion	103
C.6. Ankesat e qytetareve të përmbledhura sipas tematikave/problematikave kryesore	107
C.7. Afatet e rindërtimit	108
D. Rekomandime	110

INDIKATORËT E PËRDORUR PËR NDËRTIMIN E KËTIJ RAPORTI

- 1 Niveli i ndryshëm i transparencës publike ndërmjet njësive zbatuese.
- 2 Shtëpitë me kredi dhe të siguruar në privat. Si ka ndodhur procesi? Si janë marrë paratë nga banka?
- 3 Objektet Komerciale (bizneset) a kanë përfituar grante apo rindërtim? Moral Hazard. Transparenca.
- 4 Objektet e banimit që janë shtëpi të dyta (në plazh apo fshat) kanë përfituar grante ose rindërtim? Moral Hazard.
- 5 Vëzhgimet në terren. Monitorimi.
- 6 Grante dhe kredi të përfituara dhe disbursuara nga Konferenca e Donatorëve
- 7 Inspektimet në terren.
- 8 Ndërtimi i Databazës me Vendime të Këshillit të Ministrave
- 9 Kërkesa për informacion tek njësitë zbatuese, sa është numri i objekteve të klasifikuara deri më tani si DS1 deri DS5. Sa është numri deri më tani i aplikimeve sipas secilës kategori? Sa është numri i aplikimeve të miratuara? Sa është numri i aplikimeve të paguara apo të pajisura me njësi banimi?
- 10 Niveli i transparencës ndërmjet objekteve të ndërtuara nga donatorë dhe atyre me fonde publike.
- 11 Niveli i raportimit nga Ministria e Rindërtimit në lidhje me rindërtimin.
- 12 Raportimet periodike (historiku i daljeve në publik), raportet periodike të gjeneruara për informacion, raportet vjetore, të dhënat interaktive në faqen e Ministrisë së Rindërtimit.
- 13 Niveli i raportimit në nivel projekti nga Ministria e Financave në lidhje me rindërtimin, në përputhje me kërkesat e transparencës financiare.
- 14 Transparenca nga njësitë zbatuese, vendore dhe Ministria e Rindërtimit, në përputhje me kërkesat e përgjithshme ligjore për transparencën.
- 15 Transparenca nga njësitë zbatuese, vendore dhe Ministria e Rindërtimit, në përputhje me kërkesat specifike ligjore për transparencën për rindërtimin.
- 16 Mbatja e angazhimeve kohore në krahasim me premtimet. Mbatja e angazhimeve për financimin nga Konferenca Donatorëve.

DATABAZAT E TË DHËNAVE DHE PËRPUNIMI TYRE

- 1 Fondet buxhetore për shpenzimet e rindërtimit, ndryshimet në të, realizimi dhe raportimi.
- 2 Burimet e financimit për shpenzimet e rindërtimit, grante dhe kredi nga konferenca, financim i brendshëm ndryshime në të, realizimi dhe raportimi.
- 3 Alokimi i fondeve me VKM sipas njësive zbatuese, ndryshimet në alokime, gjendja.
- 4 Lista e individëve që kanë aplikuar për të përfituar nga fondi rindërtimit, shtesat, ndryshimet, datat e shlyerjes, gjendja ende e pakompensuar.
- 5 Databaza e Thesarit me pagesat faktike sipas datave, faturave, njësive zbatuese.
- 6 Databaza e Prokurimeve nga Njësitë Zbatuese dhe të Dhënat e APP.



FINANCIMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT

A.1. KREDI NGA KONFERENCA E DONATORËVE

Nga Konferenca e Donatorëve në shkurt të vitit 2020 Shqipëria përfitoi një angazhim për të asistuar në përbushjen e nevojave në shumën totale të premtuar prej 1.15 miliard euro, nga të cilat rreth 295 milion euro në grante dhe rreth 853 milion euro në kredi. Kjo pohohet edhe në raportin e buxhetit faktik për vitin 2020 ku citohet:

“Në Konferencën e Donatorëve në Bruksel më 17 shkurt 2020 u premtuan 1.15 miliardë euro fonde për rindërtimin dhe rimëkëmbjen pas tërmetit; ndër të cilat 295.73 milionë euro ishin grante, 853 milionë euro hua dhe 3.42 milionë euro kontribute në natyrë.”

Në buxhetin faktik 2020, Qeveria deklaroi në lidhje me kreditë nga Konferenca e Donatorëve se **deri në dhjetor 2020, 11% e huave (90 milionë euro) u finalizuan në marrëveshje konkrete; ndërsa 160 milionë euro hua ishin në proces negociimi.**

Edhe 11 muaj më vonë nga mbyllja e vitit 2020, shihet se fare pak progres është bërë në lidhje me përthithjen e kredive nga Konferenca e Donatorëve. Në raportimin e tij, Ministri i Rindërtimit Arben Ahmetaj, në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave në datë 10 nëntor 2021 deklaroi:

“Janë në proces negociatat për huatë e buta në vlerën 150 milion euro dhe ka përfunduar negociata prej 90 milionë euro me qeverinë italiane”.

Kur po mbushen 2 vite nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe kur jemi rreth 6 muaj larg angazhimit të qeverisë shqiptare për përfundimin e procesin e rindërtimit, asnjë kredi nga Konferenca e Donatorëve nuk është finalizuar me marrëveshje dhe është ende shumë larg disbursimit.

Kreditë e supozuara të nënshkruara 11% e totalit, rreth 90 milion euro, nuk raportohen as të nënshkruara dhe mungon informacioni mbi realizimin e tyre. Ky konkluzion arrihet së pari, sepse nuk ka asnjë projekt për rindërtim në investimet e raportuara përgjatë vitit 2020, në investimet publike që gjenden të publikuara në [web](#)-in e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Së dyti, në regjistrin e borxhit, të publikuar po nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nuk raportohet asnjë kredi e marrë me qëllim financimin e procesit të rindërtimit, madje kredi të reja ka pasur, por ato janë marrë më së shumti për financimin e shpenzimeve buxhetore, duke mos shfrytëzuar angazhimet nga kreditorët e huaj, sipas Konferencës së Donatorëve.

Gjithashtu, informacioni që gjendet në raportin e buxhetit faktik është kontradiktë me atë të paraqitur në regjistrin e borxhit, ku nuk reflektohet asnjë kredi për rindërtimin, referuar përshkrimit të kredisë.

E njëjta situatë paraqitet edhe në raportimin më të fundit të regjistrit të kredisë, atë të botuar në tetor 2021, ku nuk rezulton asnjë kredi e marrë për procesin e rindërtimit.

Në faqen tjetër tabela e kredive të reja që vërteton këtë fakt.

Kontrolli i Lartë i Shtetit në Raportin mbi Zbatimin e Buxhetit të vitit 2020 informon gjithashtu mbi mungesën e raportimit të granteve dhe kredive për procesin e rindërtimit duke cituar:

“Në bazën e të dhënave të investimeve me financim të huaj për vitin 2020, rezulton se nuk ka projekte të reja të cilat mund të lidhen me Rindërtimin”.

KOD KREDIE	KREDITORI	PERSHKRIM KREDIE	SHUMA E NENSHKRUAR	MONEDHA	STOKU DERI NE 30.09.2021
20/01/IBRD	IBRD	Barazia gjinore ndaj mundësive ekonomike	9,100,000.00	EUR	9,100,000.00
20/02/EBRD	EBRD	Rrugët Sekondare Lokale	50,000,000.00	USD	400,000.00
20/03/IMF	IMF	Instrument i financimit të shpejtë	139,300,000.00	SDR	139,300,000.00
EUR7Y/20/01	EuroBond	Mbështetje për buxhetin	650,000,000.00	EUR	650,000,000.00
20/04/IBRD	IBRD	Mbështetje për situatën e emergjencës covid-19	15,000,000.00	EUR	9,380,801.08
20/05/EU	Keshilli i Europës	Mbështetje për buxhetin	180,000,000.00	EUR	90,000,000.00
20/06/KfE	KfE	Furnizimi me ujë i zonave rurale V	80,000,000.00	EUR	-
20/07/EBRD ²	EBRD	Zhvillimi i Turizmit & Infrastruktura në Shqipëri	60,000,000.00	EUR	-
21/01/IBRD	IBRD	Politikat e zhvillimit të qëndrueshmërisë fiskale dhe rritjes	80,000,000.00	USD	80,000,000.00
21/03/SAUDIARAB	SaudiArab	Rehabilitimi dhe Rindërtimi i Rrugës Bregdetare Vlorë-Oricum	112,500,000.00	SAR	-
21/04/KFW	KfW	Reforma në sektorin e energjisë	100,000,000.00	EUR	-

Dy vite pas tërmetit dhe nga nisja e procesit të rindërtimit, asnjë kredi e butë nga Konferenca e Donatorëve nuk është përthithur. Kjo do të thotë se financimi i faturës së rindërtimit është realizuar duke marrë borxh në tregjet vendase dhe ndërkombëtare, si përshtetja Eurobondi i fundit. Nëse qeveria shqiptare do të kishte përthithur kreditë e buta nga konferenca e donatorëve, automatikisht nuk do t'i nevojitej Eurobondi.

Pas Konferencës së Donatorëve, Ministri i Shtetit për Rindërtimin **argumentoi** rëndësinë e suksesit të arritur në marrjen e angazhimeve për kreditë nga kjo konferencë, për mbështetjen e procesit të rindërtimit:

“Rreth 400 milionë euro janë grante, pra që do të thotë se janë para që nuk na i japin borxh, por na i dhurojnë. Pjesa tjetër, 750 milionë euro janë kredi e butë, që do të thotë me një kosto shumë të ulët qoftë në aspektin e koston së parasë dhe koston së operacionit, pra nuk janë kredi tregtare”

Për ta konkretizuar më tej në terma më specifike mbi kreditë nga kjo konferencë, zoti Ahmetaj [shtoi](#): *“Ishte një mbështetje spektakolare, dhe solidaritet për*

familjet që kanë humbur pjesëtarët e tyre.... Shumë prej këtyre kredive, interesat i kanë të përcaktuara dhe janë nën 2%. Kredia e Bankës Islamike, që është 365 milionë euro, është me interesa gati gati 1%”

Pra edhe financimi me anë të **Eurobondit** me norma interesi prej 3.75% në rreth 650 milion euro edhe në vitin 2021, rezulton në 1 deri 2% më i lartë se normat e interesit nga kreditë e premtuara në konferencën e donatorëve, duke paraqitur një **kosto shtesë financimi prej rreth 14.6 milion euro/vit**. Në këto kushte, mos shfrytëzimi i mundësisë së financimit të procesit të rindërtimit me kredi të buta, përveç mungesës së monitorimit më të imët nga kreditorët me anë të projekteve specifike, shoqërohet edhe me kosto më të lartë të shpenzimeve të interesit, si pasojë e normës me anë të së cilës është siguruar financimi i kërkuar.

Faktoje.al dërgoi në 10.11.2021 një listë me kërkesa për informacion ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ku ndër të tjera kërkonim të informoheshim në lidhje me “Listën e të gjitha marrëveshjet e huase të nënshkruara nga Qeveria Shqiptare në lidhje me programin e rindërtimit. Për

secilën marrëveshje, detajoni: Vlerën e marrëveshjes së huasë, objektin e marrëveshjes së huasë, datën e nënshkrimit të marrëveshjes së huasë, normën e interesit, kohëzgjatjen, institucionin kreditues, dhe vlerën totale të disbursuar të huasë deri në datën e kësaj kërkesë.”

Ndryshe nga sa raportuar në relacionin e zbatimit të buxhetit për vitin 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në përgjigjen e saj të datës 9 Dhjetor 2021 në lidhje me këtë pikë konfirmon konstatimin e Faktoje mbi mungesën e kredive nga procesi i rindërtimit duke u shprehur se **“Nuk është nënshkruar deri në këto momente asnjë kredi, qëllimi direkt i të cilës të lidhet me financimin e aktiviteteve të rindërtimit të objekteve nga dëmi i shkaktuar nga tërmeti.** Informacion mbi marrëveshjet e huasë që lidhen nga Republika e Shqipërisë dhe /ose Këshilli i Ministrave mund të gjendet në publikimet tremujore të regjistrit të borxhit që mundëson Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në linkun e mëposhtëm.”

A.2. GRANTE NGA KONFERENCA E DONATORËVE

Bazuar në burime të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (raporti i zbatimit të buxhetit faktik 2020) dhe informacionit të marrë nga Ministria e Rindërtimit rezulton se 277 milionë Euro ose 94% e granteve të premtuara në Konferencën e Donatorëve janë nënshkruar dhe në zbatim. Faktoje ka konstatuar se, megjithëse të deklaruara të nënshkruara dhe në zbatim, këto grante, projektet që ato mbështesin dhe ecuria e zbatimit të tyre nuk janë pjesë e detajimit dhe planifikimit buxhetor dhe as nuk raportohet periodikisht mbi ecurinë faktike të realizimit të tyre si pjesë e ciklit buxhetor.

Në Konferencën e Donatorëve, në shkurt 2020, Shqipëria përfitoi një angazhim për të asistuar në përmbushjen e nevojave në shumën totale të premtuar prej 1.15 miliard euro, nga të cilat rreth 295 milion euro në grante. Kjo pohohet edhe në raportin e buxhetit faktik për vitin 2020 ku citohet:

“Në Konferencën e Donatorëve në Bruksel më 17 shkurt 2020 u premtuan 1.15 miliardë Euro fonde për rindërtimin dhe rimëkëmbjen pas tërmetit; ndër të cilat 295.73 milionë Euro ishin grante, 853 milionë Euro hua dhe 3.42 milionë Euro kontribute në natyrë.”

Në po të njëjtin raport citohet:

“Deri në dhjetor 2020, u finalizuan në marrëveshje konkrete 94% e granteve (277 milionë Euro); ndërsa 1.1 milionë Euro grante ishin në proces negociimi. Disa donatorë po i zbatojnë kontributet nëpërmjet sistemeve të tyre; në bashkërendim me Qeverinë shqiptare, përfshirë donatorët më të mëdhenj si BE (115 milionë Euro); Emiratet e Bashkuara Arabe (75 milionë USD) dhe Turqia (44.8 milionë Euro). Disa donatorë kanë zgjedhur të përdorin sistemet e shtetit shqiptar, si Gjermania nëpërmjet KfW-së (11 milionë Euro); Zvicra, e cila ka kaluar një pjesë të kontributit të saj prej 9.5 milionë Euro nëpërmjet Fondit të Rindërtimit, si dhe Republika Çeke dhe Sllovakia. Donatorët vendas kanë akorduar 12.2 milionë Euro për rindërtimin, kryesisht nëpërmjet Fondit të Rindërtimit. Sektorët kryesorë që përfitojnë nga grantet e donatorëve ndërkombëtarë janë strehimi (39%); arsimit (35%) dhe infrastruktura publike, përfshirë kulturën (20%).”

Por sa nga këto projekte janë raportuar dhe si paraqitet realizimi i tyre deri tani, në raport me shkallën e përthithjes së financimeve?

Në portalin e rindërtimit (<https://rindertimi.gov.al/>) nuk raportohen informacione në lidhje me shkallën e përfitimit të granteve në funksion të procesit të rindërtimit, sipas angazhimit në Konferencën e Donatorëve. **Në Raportin e Buxhetit Faktik për vitin 2020, të raportuar në Kuvend, nuk jepet informacion se sa nga këto projekte, grante nga donatorët janë realizuar dhe cilat janë përkthyer në investime publike për qytetarët shqiptarë.**

Grantet e supozuara të nënshkruara ose 94% e totalit, rreth 277 milion euro nuk raportohen se sa janë realizuar. Kjo **nëse do i referohemi investimeve publike të raportuara nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë** (<http://www.financa.gov>).

al/investimet-vjetore/). Sipas bazës së të dhënave deri në Dhjetor 2020 për investimet publike me financim të huaj (ku raportohen ato investime të kryera me burim financimi grante), projektet kryesore të raportuara përfshijnë projekte infrastrukturore si ndërtim rrugësh, furnizim me ujë, ujitje, menaxhim mbetjesh, blerje automjesh, mbështetje për shëndetësinë, por **asnjë projekt për rindërtimin me burim financimi për grante apo kredi.**

Nga Ministria e Rindërtimit, në përgjigjen e kërkesës për informacion, është referuar se janë negociuar dhe nënshkruar përgjatë muajve në vijim të Konferencës së Donatorëve nga Ministri

i Shtetit për Rindërtim marrëveshje granti, për financimin e projekteve konkrete në sektorin e edukimit, strehimit, infrastrukturës publike apo granteve të rikonstruksionit për të cilat janë lidhur marrëveshjet përkatëse ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe donatorëve të huaj si më poshtë. Vlera totale e granteve të nënshkruara nga Konferenca e Donatorëve sipas tabelës është rreth 277 milion euro.

Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në përgjigje të kërkesës zyrtare, **nuk u dha informacion për listën e granteve aktive dhe realizimin faktik të disburseve, por u referua vetëm lista e granteve të premtuara** gjatë Konferencës së Donatorëve.

TABELA – DONACIONET E HUAJA SIPAS GRANTEVE TË NËNSHKRUARA NË VIJIM TË KONFERENCËS SË DONATORËVE

DONATORI	EURO	USD	PROGRAMI/KOMENTE
Bashkimi European	15,000,000		Programi për objektet arsimore faza 1 dhe faza 2
	60,000,000		
	40,000,000		Programi për trashëgiminë kulturore
Gjermani	11,000,000		Programi për objektet arsimore
Sllovenia	250,000		Programi për objektet arsimore
Katari	4,200,000		Programi për objektet arsimore (5 milion USD konvertuar)
Sllovakia	300,000		Programi për objektet arsimore
Turqia		45,000,000	Rindërtimi i 524 apartamenteve, plus parkim plus Qendër Tregtare në bashkinë Kurbin
Emiratet e Bashkuara Arabe		70,000,000	Ndërtimi i rreth 2000 apartamenteve
Italia	5,000,000		Për objektet publike dhe arsimore
Austria dhe Lihtenshtein	1,050,000		Për ndërtimin e banesave individuale
Zvicra	1,450,000		Grante rikonstruksioni disbursuar për rikonstruksionin e banesave DS1-DS3 në Shijak dhe Kurbin
Danimarka	11,800,000		Programi i zhvillimit të qëndrueshëm për projekte komunitare
Finlanda			
Hollanda			
Suedia			
Britania e Madhe			
Polonia			
Norvegjia			
Greqia	2,500,000		Programi për rindërtimin e objekteve publike
Kroacia	1,000,000		Programi për objektet arsimore
Zvicra	7,500,000		Për projekte ekzistues të shëndetësisë dhe reduktimin e riskut të fatkeqësive
Totali	161,050,000	115,000,000	

PARTNER	TOTAL GRANTS PLEDGED
Algeria	50,000.00
Austria	1,000,000.00
Azerbaijan	500,000.00
Bosnia and Herzegovina	51,129.00
Brunei Darussalam	33,409.00
Bulgaria	100,000.00
Caritas Europa	609,600.00
Council of Europe Development Bank (CEB)	500,000.00
Croatia	1,000,000.00
Cyprus	20,000.00
Czechia	374,016.00
Denmark	2,000,000.00
Estonia	50,000.00
European Bank for Reconstruction and Development (EBRD)	1,000,000.00
European Commission	115,000,000.00
European Investment Bank (EIB)	2,500,000.00
Finland	300,000.00
France	1,000,000.00
Germany	11,000,000.00
Greece	2,500,000.00
Hungary	250,000.00
Italy	5,000,000.00
Japan	223,000.00
Korea	280,000.00
Kosovo	200,000.00
Liechtenstein	50,000.00
Luxembourg	150,000.00
Montenegro	500,000.00
Netherlands	3,000,000.00
Norway	498,142.00
Oman	922,935.00
Poland	2,700,000.00
Portugal	250,000.00
Qatar	4,614,675.00
Romania	50,000.00
Serbia	2,000,000.00
Slovakia	250,000.00
Slovenia	300,000.00
Sweden	5,600,000.00
Switzerland	9,000,000.00
Turkey	44,719,941.00
United Arab Emirates	70,000,000.00
United Kingdom	1,201,374.00
United States of America	4,390,401.00
Grand Total	295,738,622.00

Pra edhe në këtë përgjigje, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk jepet informacion mbi realizimin faktik për vitin 2020 dhe 8 mujorin e vitit 2021 sipas kërkesës, as për fondet që zbatohen nga donatorët dhe as për fondet që janë kanalizuar drejtpërdrejt si transfertë buxhetore dhe si janë përdorur këto fonde më pas.

Faktoje.al ridërgoi në 10.11.2021 një listë me kërkesa për informacion ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ku ndër të tjera kërkonim të informoheshim në lidhje me "Listën e të gjitha marrëveshjeve të Grantit të nënshkruara nga Qeveria Shqiptare në lidhje me programin e rindërtimit. Për secilën marrëveshje, detajoni: Vlerën e marrëveshjes së Grantit, objektin e marrëveshjes së grantit, datën e nënshkrimit të marrëveshjes së grantit, donatorin, dhe vlerën totale të disbursuar/realizuar të grantit deri në datën e kësaj kërkesë."

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në përgjigjen e saj të datës 9 Dhjetor 2021 në lidhje me këtë pikë na ridërgon edhe një herë listën e granteve të premtuara, por jo të granteve faktike dhe konfirmon konstatimin e Faktoje mbi mungesën e raportimit të granteve nga procesi i rindërtimit duke u shprehur se: "Në lidhje me nivelin e disbursimit të granteve për rindërtimin, nuk identifikohen në databazën e Sistemit Informatik të Menaxhimit të Ndihmës së Huaj, të dhëna të raportuara nga partnerët për zhvillim."

A.3. GRANTE TË TJERA NGA DONATORË

Në informacionin e përcjellë nga Ministri i Shtetit për Rindërtimin është referuar se në procesin e rindërtimit janë përfshirë edhe financimet nga organizatat jo-fitimprurëse shqiptare të angazhuara në projekte që zbatohen nga këto donatorë si më poshtë.

Faktoje.al		
DHURIME NGA FONDACIONE TË NDRYSHME		
FONDACIONI FIRDEUS Për rindërtimin e banesave 9 MLN EURO	FONDACIONI FUNDJAVE NDRYSHE Për rindërtimin e banesave 1 MLN EURO	SHOQATA "RRËNJË SHQIPTARE" Për rindërtimin e banesave 1.3 MLN EURO
SHOQATA JETIMËT E BALLKANIT Për rindërtimin e banesave 900 MIJË EURO	CARITAS ALBANIA Për ndërtimin e banesave Kurbin e Lezhë 1.2 MLN EURO	FONDACIONI "BEHGJET PACOLLI" Për ndërtimin e banesave Thumanë 1 MLN EURO
FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT Për rindërtimin e banesave 14.5 MLN LEKË	SHOQATA TIFOZËT KUQ E ZI Për projekte në shëndetësi 3 MLN LEKË	

Ministria e Rindërtimit në përfundim të përgjigjes ndaj kërkesës për informacion dërguar për Faktoje, është shprehur se e gjithë shuma e granteve dhe kredive është angazhuar në projekte që zbatohen nga donatorët dhe se pjesa tjetër e donatorëve i kanë kanalizuar fondet drejtpërdrejt si transfertë buxhetore.

DONATORI	EURO	LEK	PROGRAMI/KOMENTE
Fondacioni Firdeus	9,000,000		Për rindërtimin e banesave
Fondacioni Fundjave Ndryshe	1,000,000		
Shoqata "Rrënjë Shqiptare"	1,300,000		
Shoqata Jetimët e Ballkanit	900,000		
Caritas Albania	1,200,000		Për ndërtimin e banesave Kurbin dhe Lezhë
Fondacioni "Behgjet Pacolli"	1,000,000		Për ndërtimin e banesave Thumanë
Federata Shqiptare e Futbollit		14,500,000	Për rindërtimin e banesave
Shoqata Tifozët Kuq e Zi		3,000,000	për projekte në shëndetësi
Totali	14,400,000	17,500,000	

A.4. BUXHETI I SHTETIT

Fondi i rindërtimit është parashikuar në ligjin nr. 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", ku në nenin 7 është përcaktuar fillimisht shuma prej 20 miliardë lekësh, kompetenca e Këshillit të Ministrave për: mënyrën e përdorimit, programet buxhetore ku do alokohet fondi dhe institucionet zbatuese; si dhe kalimi për vitin pasardhës i fondeve të pashpenzuara dhe përdorimi për të njëjtin qëllim.

Me Aktin Normativ **nr. 28 datë 02.07.2020**, është ndryshuar vlera e fondit të rindërtimit duke e përcaktuar në shumën 34 miliardë lekë (ndarë në shumën 3 miliardë lekë grante dhe shpenzime të buxhetit të shtetit plus 31 miliardë lekë) me një rritje 14 miliardë lekë në total.

Me Aktin Normativ **nr. 34 datë 16.12.2020**, është ndryshuar vlera e fondit të rindërtimit duke e përcaktuar në shumën 32 miliardë lekë (ndarë në shumën 3 miliardë lekë grante dhe shpenzime të buxhetit të shtetit plus 29 miliardë lekë), me një ulje 2 miliardë lekë në total, reflektuar në shpenzimet e buxhetit të shtetit.


Sipas pasqyrit në tabelat shoqëruese (**tabela 4-treguesit fiskalë të buxhetit të konsoliduar, ligji nr.88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020"**) janë parashikuar fonde vetëm për vitin 2020 dhe jo për vitet 2021 dhe 2022. Buxheti i parashikuar për fondin e rindërtimit për vitin 2020, sipas ndryshimeve me akte normative paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Realizimi i fondit të rindërtimit për vitin buxhetor 2020, sipas raportimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në treguesit e konsoliduar fiskalë, është në shumën **16,591 milion lekë**, me një realizim të ulët ose në masën 52% të planit të ndryshuar. (<http://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/treguesit-fiskal-12-2020-dt.06.04.2021-format-publikimi.pdf>)

Në ligjin nr. 137 datë 16.12.2020 "Për buxhetin e vitit 2021", në tabelën 4 - treguesit fiskalë të buxhetit të konsoliduar të ligjit, fondi i rindërtimit është parashikuar në shumën 28 miliardë lekë për vitin 2021, në vitin 2022 janë parashikuar 6 miliardë lekë dhe 0 lekë në vitin 2023 (<http://www.financa.gov.al/buxheti-2021/>). Kjo vlerë e parashikuar për

Nr	E M E R T I M I	Buxheti 2020					Buxhe ti 2021	Buxhe ti 2022
		Ligji nr. 88/2019	Akti Normati v 6 date 21.03.2020	Akti Normati v 15 date 15.04.2020	Akti Normati v 28 date 02.07.2020	Akti Normati v 34 date 16.12.2020		
VI	Fondi I Rindertimit	20,000	20,000	20,000	34,000	32,000		
	Grante				3,000	3,000		
	Shpenzime				31,000	29,000		

Nr.	E M E R T I M I	Akti Normativ 2020	Buxheti 2021					Buxheti 2022	Buxheti 2023
			Ligji nr. 137/2020	Akti Normativ 4 date 05.02.2021	Akti Normativ 8 date 22.03.2021	Akti Normativ 26 date 23.06.2021	Akti Normativ 31 date 28.10.2021		
III.	Shpenizme kapitale								
	Fondi I Rindërtimit		28,000	28,000	28,000	28,000	28,000	6,000	0
VII	Fondi I Rindertimit	32,000							
	Grante	3,000							
	Shpenzime	29,000							




financimin e fondit të rindërtimit përgjatë vitit 2021 dhe dy viteve të ardhshme buxhetore ka mbetur e pandryshuar me aktet normative që kanë ndryshuar buxhetin për vitin 2020.

Realizimi i fondit të rindërtimit për 9-mujorin e vitit 2021, sipas raportimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në treguesit e konsoliduar fiskalë, është në shumën 19,987 milionë lekë ose 71.4%.

A.5. ALOKIMI I FONDEVE ME VKM

Qeveria shqiptare u angazhua që fondet e rindërtimit do të zbatoheshin “sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe ligjit përkatës për buxhetin vjetor”.

Nga analiza e Vendimeve të Këshillit të Ministrave që alokojnë fondet për rindërtimin dhe mundësojnë firmosjen e kontratave dhe fillimin e punimeve rezulton se, vlera e alokuar ka qenë që prej vitit 2020 në tejkallim të buxhetit vjetor dhe atij 3-vjeçar të miratuar nga Kunvedi i Shqipërisë, duke ndërmarrë kështu një faturë që nuk reflektohet në treguesit fiskalë. Në vitin 2020, qeveria ka alokuar me VKM, duke hapur kështu kantiere pune, një vlerë prej 46.5 miliardë lekë (ose rreth 381 milionë euro) në tejkallim të buxhetit në fuqi në atë vit. Kjo situatë ka vijuar edhe në vitin 2021, vit në të cilin kanë vijuar të miratohen fondet me VKM të reja dhe që sot janë të pambështetura me fonde buxhetore. Edhe me Buxhetin e ri 2022-2024 vlera, megjithëse është ngushtuar, e pambështetur në fonde buxhetore



është 33.7 miliardë lekë (ose rreth 276 milionë euro). Këto angazhime të pambështetura në fonde buxhetore rrezikojnë të kthehen në një borxh të fshehur dhe të ndikojnë drejtpërdrejt në kapjen e afateve të rindërtimit dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura. Në daljen publike të datës 9 Dhejtor 2021, pas miratimit të buxhetit të vitit 2022-2014 dhe vetëm 22 ditë nga mbyllja e vitit fiskal, Zv. Kryeministri Ahmetaj deklaroi që fondi i rindërtimit për vitin 2021 do të rritet me 7 miliardë lekë, duke mbyllur një pjesë të diferencës ndërmjet vlerës së VKM-ve dhe Buxhetit dhe konfirmuar kështu konstatimin e Faktoje.

Në dokumentacionin e projektligjit "Për miratimin e buxhetit faktik 2020", në "Tabela analitike e përdorimit të Fondit të Rindërtimit 2020" paraqitet lista e VKM-ve të dala gjatë vitit për përdorimin e fondit të rindërtimit, që përfshijnë një vlerë të alokuar prej 28,079 milionë lekë. <https://parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/54637>

Nga analiza e këtyre VKM-ve, për të cilën është krijuar databaza me të gjitha VKM të dala vetëm për vitin 2020, rezulton se kostoja totale e parashikuar për realizimin e fondit është 78,471 milionë lekë, nga të cilat vetëm vlera e alokuar për vitin 2020 është 28,079 milionë lekë. Pjesa tjetër e pambuluar me fonde parashikohet në vitet e ardhshme buxhetore, ndërkohë që sipas tabelës 4 të ligjit nr. 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020" nuk janë parashikuar fonde për vitet e ardhshme buxhetore.

Megjithëse realizimi i fondit të parashikuar për vitin 2020, u arrit vetëm në rreth 50% të tij (16,591 milionë lekë nga 32,000 milionë lekë planifikuar për vitin 2020), vlera e mbetur si pasojë e VKM-ve të dala në vitin 2020 (në shumën 78,471 milion lekë), nuk është buxhetuar as në buxhetin e miratuar për vitet

2021-2023 (28,000 milionë lekë për vitin 2021 dhe 6,000 milionë lekë për vitin 2022).

Përgjatë vitit 2021, kanë dalë VKM të tjera për fondin e rindërtimit, të cilat:

- kanë ndryshuar vlerën e VKM-ve që kanë alokuar fonde në vitin 2020 dhe;
- kanë alokuar fonde të reja përgjatë vitit 2021.

Efekti i përditësimit të VKM-ve të vitit 2020 në vitin 2021 reflektohet duke rritur vlerën e fondit nga 78,470 milionë lekë në 80,511 milionë lekë (përditësuar deri në 30.09.2021, sipas <https://qbz.gov.al/search>). Pra rritja e vlerës së fondit është kryer në rreth 2,041 milionë lekë.


Efekti i VKM-ve të reja të dala në vitin 2021 që nuk ndryshojnë VKM-të e vitit 2020, por alokojnë fonde për herë të parë për njësitë përfituese, llogaritet në vlerën 19,155 milionë lekë.

Në total, sipas VKM-ve të përditësuar deri në 30.09.2021, që nga 01.01.2020 fondi i rindërtimi i shpërndarë me VKM vlerësohet në shumën 99,666 milionë lekë. Vlera e buxhetuar në 2020, sikurse u përmend më sipër është 28,078 milionë lekë, ajo e alokuar në 2021 është 23,781 milionë lekë (për VKM të 2020 dhe 2021), duke sjellë që vlera e mbetur për t'u financuar për vitin 2022 e në vijim të paraqitet si diferencë në shumën 47,808 milionë lekë.

Mbulimi me fonde buxhetore për vitin 2021, sipas ligjit të buxhetit të vitit 2021 është 28 miliardë lekë për atë vit, 6 miliardë lekë për vitin 2022 dhe 0 lekë për vitin 2023, duke mos mbuluar me fonde të parashikuara në ligj shpërndarjen e kryer me VKM. Tabelat në vijim paraqesin në mënyrë të përmblodhur

VKM NË VLERË TOTALE PËR PROCESIN E RINDËRTIMIT SIPAS VITEVE, NË LEKË

	Kosto totale deri ne 2020	Kosto totale deri shtator 2021	Buxhetuar ne 2020	Buxhetuar ne 2021	Mbetur per 2022 dhe me tej
VKM te dala ne 2020	78,470,721,494	80,510,557,544	28,077,992,717	11,969,971,666	40,462,593,161
VKM te dala ne 2021		19,155,489,931		11,810,552,548	7,344,937,383
Totali	78,470,721,494	99,666,047,475	28,077,992,717	23,780,524,214	47,807,530,544




efektin e VKM-ve dhe në të njëjtën kohë parashikimin në ligjin nr.137 datë 16.12.2020 "Për buxhetin e vitit 2021":


Krahasimi i vlerës së shpërndarë në total me VKM për rindërtimin sipas VKM-ve të përditësuara deri në 30.09.2021, me buxhetin e planifikuar në ligje të buxhetit vjetor për periudhën 3 vjeçare, sipas të cilës miratohet buxheti 2021-2023 dhe me vlerat e parashikuara në projekt buxhetin 2022-2024, paraqitet grafikisht si më poshtë:

Vlera e alokuar me VKM në shumën 99,666 lekë, duke marrë parasysh nivelin e realizimit të vitit 2020 në shumën 16,591 milionë lekë, nuk është

shpërndarë në vitet 2021-2023, pasi diferenca prej 83,075 milionë lekë (99,666 milionë lekë – 16,591 milionë lekë) është më e madhe se vlera e buxhetuar për 2021-2023, prej 34,000 milionë lekë.

E njëjta situatë paraqitet edhe në parashikimet për 2022-2024, nëse do marrim në konsideratë realizimin e vitit 2020 (16,591 milionë lekë) dhe në të njëjtën kohë supozimin se i gjithë fondi i parashikuar për vitin 2021 do realizohet (28,000 milion lekë), ku diferenca prej 55,075 milionë lekë (99,666 milionë lekë – 16,591 milionë lekë – 28,000 milionë lekë) është më e madhe se vlera e parashikuar për 2022-2024 prej 20,000 milionë lekë.





Mosmbulimi me fondet e kërkuara, përveçse krijon presione për rritjen e vlerave nga parashikimi vit pas viti, rrezikon edhe përfundimin e procesit të rindërtimit sipas afateve të parashikuara.

Ky konstatim i Faktoje konfirmohet edhe nga zhvillimet e fundit. Në daljen publike në datë 9 Dhejtor 2021, Zv. Kryeministri Ahmetaj deklaroi që fondi rindërtimit për vitin 2021 **rritej me 7 miliardë lekë**, duke shkuar nga 28 miliardë në 35 miliardë lekë. Këto ndryshime vijnë menjëherë pasi Kuvendi ka miratuar buxhetin e vitit 2022. Sipas tij, qëllimi ishte për të përshpejtuar procesin e rindërtimit. Kjo shtesë buxheti e ardhur në fund të vitit 2021, mbyll një pjesë të diferencës së pa mbuluar me fonde ndërmjet buxhetit dhe VKM-ve të miratura. E ardhur në fund të vitit ajo ka mundësi të përshpejtoj pagesat për punë faktike të kryera gjatë vitit dhe për të cilat siç kemi argumentuar, me anë të VKM-ve është mundësuar marrja e angazhimeve përtej fondeve në dispozicion në kohën e nxjerrjes së tyre.

A.6. DISIPLINA BUXHETORE E INVESTIMEVE TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT

Procesi i rindërtimit, sikurse është trajtuar edhe në analizën e zhvilluar mbi buxhetin në dispozicion për rindërtimin, është drejtuar nëpërmjet VKM-ve rast pas rasti nga Këshilli i Minsitrave, të cilat kanë pësuar ndryshime të vazhdueshme përgjatë

viteve 2020 dhe 2021. Në dokumentacionin e projektligjit "Për miratimin e buxhetit faktik 2020", në "Tabela analitike e përdorimit të Fondit të Rindërtimit 2020" paraqitet lista e VKM-ve të dala gjatë vitit për përdorimin e fondit të rindërtimit, që përfshijnë një vlerë të alokuar prej 28,079 milionë lekësh. (<https://parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/54637>) dhe që paraqet edhe një detajim të fondeve, duke i klasifikuar ato në artikuj buxhetorë në llogaritë korente dhe kapitale si dhe në ndarje sipas grante/donacione dhe pushtetit qendror e vendor vetëm për pjesën e vitit 2020. Ndarja sipas pushteti vendor, qendror dhe grant donacion për vitin 2020 paraqitet sipas grafikut më lart.

Ndërkohë, ndarja sipas artikujve të publikuar në këtë tabelë analitike në artikuj buxhetorë, për fondet e pushtetit qendror dhe vendor paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

ARTIKULLI	602	604	606	230	231
Shuma	201,080	15,068,747	44,890	137,420	10,314,118

Vlera më e madhe e akorduar për vitin 2020 është shpërndarë në artikujt buxhetorë 604 dhe 231, pra në pjesën e transfertave drejt të tretëve dhe në investime. Faktoje analizoi raportin mbi zbatimin e buxhetit të raportuar nga KLSH, ku ishin paraqitur problematikat e identifikuara në lidhje me investimet e procesit të rindërtimit. Sipas

Fondi i rindërtimit	Nga drejtoria e investimeve		Publikuar ne treguesit fiskale	
Institucioni	Plani perfundimtar	Realizimi faktik	Plani perfundimtar	Realizimi faktik
Agjencia Kombetare e Planifikimit te Territorit	137,420,000	89,467,590	137,420,000	89,467,590
Agjencia Kombetare e Shqerise se Informacionit	18,360,360	16,501,200	18,360,360	16,501,200
Autoriteti Rrugor Shqiptar	151,539,896	-	151,539,896	-
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	9,907,591,022	6,824,263,928	9,605,548,026	6,522,220,932
Instituti Kombetar i Trashegimise Kulturore Tirane	236,627,069	190,174,800	236,627,069	190,174,800
Totali i investimeve me financim te brendshem	10,451,538,347	7,120,407,518	10,149,495,351	6,818,364,522

këtij raporti, identifikohen diferenca në raportim për planin dhe realizimin e investimeve sipas subjekteve përfituese nga fondet e investimit për rindërtimin si më lart.

Vlera më e madhe e fondeve në artikullin 231, ishte akorduar në FSHZH në programin 6210 programe zhvillimi, sipas VKM-ve përkatëse, reflektuar kjo edhe në databazën interaktive të VKM-ve të konsoliduar nga Faktoje. Të detajuara sipas projekteve, investimet e FSHZH për rindërtimin paraqiten në tabelën më poshtë:

NDËRTIMI I BANESAVE DHE INFRASTRUKTURËS PUBLIKE NGA FSHZH

Projekti i investimit për rindërtimin e banesave individuale, me kod projekti 19AD201 paraqet fondet e shpërndara sipas: VKM nr.202 datë 05.03.2020 e ndryshuar, nr.307 datë 16.04.2020 e ndryshuar dhe nr.587 datë 22.07.2020 e ndryshuar, për ndërtimin e banesave individuale, ndërtimin e banesave pallat dhe infrastrukturën publike. Sipas KLSH, *“konstatohet se këto fonde janë përmbledhur në një kod projekti të vetëm investimi, ndërkohë që për nga natyra, projektet e investimit përfshijnë:*

Kodi i projektit	Emertimi i Projektit	Plani perfundimtar	Realizimi faktik
19AD201	Rindërtimi i banesave individuale	5,137,671,726	3,267,506,730
19AD203	Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termeti, Qarku Lezhë (Bashkia Kurbin dhe Lezhë)	444,865,289	309,706,000
19AD204	Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termeti, Qarku Krujë (Bashkia Krujë)	442,297,664	215,429,457
19AD205	Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termeti, Qarku Durrës (Bashkia Durrës1)	845,723,696	695,099,636
19AD206	Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termeti, Qarku Durrës (Bashkia Durrës2)	850,692,969	631,596,146
19AD207	Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termeti, Qarku Tiranë (Bashkia Kavajë, Bashkia Rrogozhinë)	462,882,154	367,803,511
19AD208	Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termeti, Qarku Tiranë (Bashkia Kamëz)	621,757,340	471,578,998
19AD209	Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termeti, Qarku Tiranë (Bashkia Vorë) Qarku Durrës, (Bashkia Shijak)	506,998,739	408,094,074
19AD210	Mbeshtetje per programin "Sherbime mbikqyrjeje dhe kolaudim per Objektet Arsimore"	45,901,781	23,066,879
19AD211	Hartimi i projekteve per banesa individuale	246,756,668	132,339,501
M560322	Projekti i Rrugëve Dytësore dhe Lokale (Kosto Lokale)	302,042,996	302,042,996
Totali		9,907,591,022	6,824,263,928

infrastrukturë publike, banesa individuale dhe ndërtesa pallat në rajone të ndryshme gjeografike si dhe për të cilat përfshihen kontrata të ndryshme....”.

Në vijim është raportuar në lidhje me kontraktimin dhe përdorimin e fondeve duke cituar:

“Nga auditimi konstatohet se buxheti i akorduar në total për FSHZH, në programin buxhetor 6210 për rindërtimin e banesave individuale, infrastrukturën publike dhe banesat pallat, sipas VKM-ve përkatëse dhe ndryshimeve deri në 31.12.2020 rezulton në shumën 26,639 milionë lekë, nga të cilat 6,465 milionë lekë për banesat individuale, 3,975 milionë lekë për infrastrukturën publike dhe 16,198 milionë lekë për banesat pallat. Nga kjo vlerë totale e buxhetuar deri në 31.12.2020 janë kontraktuar punime në shumën 16,543 milionë lekë (62%) nga të cilat 5,684 milionë lekë për banesa individuale, 2,685 milionë lekë për infrastrukturën publike dhe 8,173 milionë lekë për banesa pallat. Realizimi faktik i punimeve deri në 31.12.2020 sipas regjistrimeve në SIFQ për kod projekti 19AD201 rezulton në shumën 3,268 milionë lekë, duke mos detajuar se për cilin komponent të rindërtimit janë paguar, duke qenë se janë përmbledhur të gjithë në një kod projekti....

Nga auditimi mbi rindërtimin e banesave individuale, sipas VKM nr. 202, dt 5.03.2020, konstatohet se kontratat janë lidhur në periudhën gusht-dhjetor 2020, ndërkohë që regjistrimi i tyre në SIFQ është kryer në dhjetor-prill 2021. Gjithashtu, në një rast, konstatohet se nuk është regjistruar kontrata e lidhur sipas minikonkursit nr.3 në shumën 629 milionë lekë deri në datën 30.06.2021, duke mos regjistruar obligimet që rrjedhin nga kjo kontratë në sistem.

Nga auditimi mbi rindërtimin e infrastrukturës publike, sipas VKM nr. 307 datë 16.04.2020 konstatohet se kontratat janë lidhur në periudhën qershor-dhjetor 2020, ndërkohë që regjistrimi i tyre në SIFQ është kryer në periudhën gusht 2020-prill 2021. Gjithashtu në një rast, konstatohet se nuk është regjistruar kontrata e lidhur sipas minikonkursit nr.7 në shumën 237 milionë lekë.

Nga auditimi mbi rindërtimin e banesave pallat sipas VKM nr. 587 datë 22.07.2020 konstatohet se kontratat janë lidhur më së shumti në muajin dhjetor 2020, ndërkohë që regjistrimi i tyre në SIFQ është kryer në periudhën janar-qershor 2021. Janë konstatuar 3 raste në të cilat kontratat e lidhura në 16.12.2020 në shumën 692 milionë lekë, në 18.12.2020 në shumën 519 milionë lekë dhe në 28.12.2020 në shumën 508 milionë lekë, nuk janë regjistruar në SIFQ deri në 30.06.2021.”

Pra, procesi i regjistrimit të kontratave në rindërtimin e banesave dhe infrastrukturën publike është shoqëruar me vonesa (pasi kontrata të dhjetorit 2020 janë regjistruar në janar-qershor 2021), përtej afatit 5-ditor për regjistrimin e tyre dhe në disa raste edhe me kontrata të lidhura, por të paregjistruara deri në 30.06.2021.

Duke u bazuar në sa më lart, Faktoje.al dërgoi në 10.11.2021 një listë me kërkesa për informacion ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ku ndër të tjera kërkonim të informoheshim në lidhje me “1. Të gjitha kontratat (angazhimet) e ndërmarra nga njësitë publike dhe që lidhen me programin e Rindërtimit nga fillimi i vitit 2020 e deri në datën e kësaj kërkesë të regjistruara në sistemin e thesarit (të cilat duhet të regjistrohen brenda afatit 3-5 ditor) me vlerën e plotë të kontratës dhe vlerën e paguar deri në fund të Tetorit 2021. Kjo e dhënë kërkohet në nivel kontrate, objekt kontrate, datë kontrate, njësi publike (Institucioni), subjekt kontraktor privat (furnitori), vlerë kontrate totale, vlerë e paguar kontrate. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në përgjigjen e saj të datës 9 Dhjetor 2021 në lidhje me këtë pikë nuk na vendos në dispozicion informacionin, por na drejton tek faqja e saj zyrtare duke u shprehur se **“Informacioni i plotë për të gjitha angazhimet e ndërmarra nga njësitë publike publikohet mbi baza mujore në linkun <https://www.financa.gov.al/ecuria-e-investimit-te-projekteve-2/>**

Në linkun <https://www.financa.gov.al/sistemi-amofts/> publikohen të dhënat mbi shpenzimet dhe të ardhurat mbi baza mujore accrual/cash të njërive të qeverisjes së përgjithshme.”

RAPORTI I PUBLIKUAR	CURRENT YEAR	F-Y	F-Y	F-Y	F-Y	ACTUAL EXPENCE	TOTAL COMMITMENT	PAYMENTS	UNPAID COMMITMENTS
	MY Commitment	Commitments 1	Commitments 2	Commitments 3	Commitments 4				
Dhjetor 2020	1,059,087,210.00			4,239,687,507		3,196,936,730	8,495,711,447	2,417,671,524	6,078,039,923
Tetor 2021	98,957,450		783,286,326	7,726,203,441		11,078,995,351	19,687,442,568	11,040,795,360	8,646,647,208

Faktoje analizoi ecurinë e investimeve publike, sipas raportimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (<http://www.financa.gov.al/ecuria-e-investimit-te-projekteve-2/>) për fundvitin 2020 dhe publikimin e 10 muorit të vitit 2021, ku për projektin e investimit publik 19AD201 Rindërtimi i banesave individuale, rezultoi si në tabelën më lart.

Nga kjo tabelë rezulton se angazhimi i regjistruar deri në 31.12.2020 për këtë investim është në shumën 8,495,711,447 lekë ndërkohë që sipas vlerës së shpërndarë me VKM-të përkatëse, shuma rezulton 26,639 milionë lekë deri në 31.12.2020, duke mos buxhetuar vlerën e plotë të projekteve edhe duke qenë të grupuara dhe të pashpërndara në projekte specifike të investimit publik, por në një projekt të vetëm.

Deri në Tetor 2021, vlera totale e buxhetuar rezulton 19,687,442,568 lekë, duke mos përfshirë të gjithë shumën e shpërndarë me VKM edhe pasi vlera e përditësuar e VKM për këtë investim publik (VKM nr. 202 datë 05.03.2020 e ndryshuar, nr.307 datë 16.04.2020 e ndryshuar dhe nr.587 datë 22.07.2020 e ndryshuar) përditësuar deri në 30.09.2021 paraqitet në shumën 28,642,456,699 lekë. Të krahasuara në dy momente kohore, kostoja

e këtij projekti investimi sipas vlerave të përcaktuara në VKM paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Mungesa e përfshirjes në ciklin buxhetor të investimeve krijon një risk për përfundimin në kohë të procesit si dhe në tërësi për financimin e tij, ku vlera e paraqitur si e realizuar, sipas raportimit nga dokumenti i publikuar nga Minsitria e Financave dhe Ekonomisë deri në Tetor 2021, në shumën 11 miliardë lekë dhe angazhimet e papaguara në vlerë 8.6 miliardë lekë, janë larg vlerave të shpërndara me VKM dhe për të cilat janë lidhur kontrata, që në disa raste nuk regjistrohen sipas raportimit të KLSH. Këto shuma rëndojnë buxhetet e viteve të ardhshme dhe krijojnë presione për rritjen e kërkesës për financim.

Problematikë tjetër në këtë proces është edhe mospublikimi i të dhënave në projekt-buxhet apo në PBA ku edhe për vitin 2022, në listën e investimeve publike 2022-2024, pjesë e Projekt-Buxhetit 2022 (<http://financa.gov.al/projektbuxheti-2022/>) për Fondin Shqiptar të Zhvillimit nuk parashikohet asnjë fond për investime që financohen nga fondi i rindërtimit, megjithëse janë pjesë e programit buxhetor 6210 programe zhvillimi të këtij institucioni, referuar përcaktimeve të bëra në VKM për alokimin e këtyre fondeve. Nga ana tjetër, PBA 2022-2024

VKM		VLERA DERI DHJETOR 2020	VLERA DERI SHTATOR 2021
nr.202 date 05.03.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave	6,465,467,211	5,430,065,414
nr. 307 date 16.04.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike, në zonat e reja të shpallura për zhvillim të detyruar	3,975,401,851	4,770,482,221
nr. 587 date 22.07.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësisë të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e reja për zhvillim dhe rindërtim në të njëjtin truall	16,198,330,089	18,441,909,064
Totali		26,639,199,151	28,642,456,699

është publikuar vetëm faza e parë (<http://financa.gov.al/programi-buxhetor-afatmesem-ne-vite-2/>) dhe jo faza e dytë dhe në këtë dokument nuk ka PBA të publikuar për FSHZH, sikurse për institucionet e tjera. **Në listën e investimeve kapitale 2022-2024, pjesë e projekt-buxhetit 2022, nuk parashikohet asnjë projekt investimi rindërtimi (jo vetëm FSHZH) në proces apo i ri, ndërkohë që viti 2022 presupozohet të jetë viti i përfundimit të procesit të rindërtimit, për më tepër, që gjatë vitit 2021 kanë dalë VKM të tjera të cilat kanë shpërndarë fonde të tjera investimesh.** Një shembull përfshin VKM nr. 169 datë 17.03.2021 *“Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të objekteve të ish-repartit “Renea”, Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale, Linzë, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si njësi zbatuese” (pjesë e databazës së krijuar nga Faktoje)* në shumën totale 263,752,795 lekë dhe fond për vitin 2021 në shumën 131,876,397 lekë, që do të thotë se pjesa tjetër zbatohet në vitet e ardhshme. Kjo nuk reflektohet në dokumentat në këtë listë, pjesë përbërëse e Buxhetit 2022 dhe as në relacionin shoqërues të projekt-ligjit mbi nivelin e kontratave të firmosura, zbatimi i tyre dhe sa janë për t’u paguar në vitin 2022.


Në relacionin shoqërues të projektligjit të buxhetit 2022 është saktësuar se vlera prej 28 miliardë lekësh për vitin 2021 është planifikuar për të përballuar kostot e financimit të projekteve të miratuara dhe të pafinancuara në vitin 2020, si dhe të projekteve të reja në vitin 2021. Ndërkohë është cituar që rreth 18.1 miliardë lekë janë akorduar për financimin e projekteve të reja të vitit 2021, në zbatim të Vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave. **Kështu, jo vetëm që projektet në vazhdim nuk janë buxhetuar si projekte në proces, të miratuara nga vitet e kaluara, por janë hapur projekte të tjera përgjatë vitit 2021, të cilat nuk detajohen në vitin 2022.**

Për këtë arsye, edhe FMN në deklaratën publike mbi procesin e rindërtimit citon:

“Duhet masa për të rritur transparencën dhe llogaridhënien lidhur me shpenzimet e kryera me procedura emergjence. Këto masa duhet të zbatohen sa më shpejt të jetë e mundur, si dhe përdorimi i fondeve të rindërtimit duhet të jetë subjekt i kontrolleve standarde të menaxhimit të financave publike”.



RAPORTIMI FINANCIAR I PROCESIT TË RINDËRTIMIT, OUTPUT-ET DHE PROBLEMATIKA TË IDENTIFIKUARA



B.1. REALIZIMI I FONDIT TË RINDËRTIMIT SIPAS NATYRËS DHE NJËSIVE ZBATUESE

Deri në maj 2021 janë disbursuar 25,76 miliardë lekë në total nga fondi i rindërtimit, shifër nga e cila 16,591 miliardë janë disbursuar në vitin 2020, ndërsa 9,169 miliardë janë disbursuar në 5-mujorin e parë të vitit 2021. Dy muajt me pagesat më të larta janë Dhjetori 2020 dhe Prilli 2021.

VITI 2020

Në 27 maj 2021, Faktoje botoi një artikull mbi ecurinë dhe përdorimin e fondit të rindërtimit për vitin 2020. Faktoje kërkoi informacion të detajuar për pagesat e kryera për rindërtimin tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Bazuar në raportimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, realizimi i fondeve të rindërtimit në 2020-n nuk e ka kaluar 52%. Subjektet më të mëdha përfituese të këtyre fondeve janë FSHZH, Bashkitë


Durrës, Tiranë e Shijak, ndërsa mes subjekteve private spikasin kompani që kanë përfituar fonde për vepra madhore publike. Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për vitin 2020, shpenzimet për rindërtimin kapën një vlerë prej 16.59 miliardë lekë ose rreth 136 milionë Euro. Plani buxhetor për këtë vit ishte 32 miliardë lekë me një realizim prej 52% të fondit në dispozicion.

Gjatë vitit 2020, rezultoi se 9 miliardë lekë janë përdorur për ndërtimin e objekteve të dëmtuara nga tërmeti dhe akomodimin e banorëve, ndërsa 7.6 miliardë lekë për transferta bankare tek individët.

Më poshtë jepet në formë tabele dhe grafike përdorimi i fondit të rindërtimit sipas institucioneve qendrore dhe lokale për vitin 2020.


Transferrat tek individët në vlerë rreth 7.7 miliardë lekë (prej të cilave rreth 84 milionë lekë për shpronësime) janë kryer me bankë ose me anë të Postës Shqiptare. Më poshtë jepen në formë grafike vlerat e transfertave, sipas institucioneve financiare që i kanë zbatuar.

FONDI RINDERTIMIT - 2020




INSTITUCIONI	Fakti 2020 (ne lek)
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	6,522,220,932
Bashkia Durres	3,708,237,149
Bashkia Tirana	2,154,086,563
Bashkia Shijak	798,504,296
Bashkia Kruje	754,835,326
Bashkia Lac	574,905,738
Bashkia Lezhe	447,476,144
Bashkia Kamez	350,025,702
Bashkia Kavaja	334,350,000
Instituti Kombetar i Trashegimis	190,174,800
Bashkia Vore	183,900,000
Aparati i Ministrise se Infrastruktures	160,000,000
Agjencia Kombetare e Bregdetit	152,535,999
Bashkia Rogozhine	110,900,000
Agjencia Kombetare e Planifikimi	89,467,590
Bashkia Rreshen	29,815,000
AKSHI	16,501,200
Enti Kombëtar i Banesave	13,275,898
TOTAL	16,591,212,337

Fakti 2020 (ne lek)



Transfertat sipas Institucioneve (ne Lek)



KONTRAKTORI	SHUMA NE LEK
KEVIN KONSTRUKSION	1,214,158,750
"GENER 2"	442,861,171
COMPANY RIVIERA 2008	409,826,276
Ante-Group	370,217,401
G J I K U R I A	339,310,996
G. P. G. COMPANY	324,020,060
ARKONSTUDIO	294,934,277
AGI KONS	217,529,000
4 A-M	212,937,799
FUSHA	202,050,000
KLAJGER KONSTRUKSION	187,057,251
ARIFAJ	182,823,798
ZDRAVO	167,244,858
INSTITUTI I NDERTIMIT (I N)	161,298,196
SENKA	153,264,393
ULZA - NDERTIM	143,658,892
AURORA KONSTRUKSION	141,140,000
CURRI- Sh.p.k	138,600,000
EURO-ALB	134,298,000
BOSHNIJAKU. B	123,625,080
GECI	123,149,581
ALB-BUILDING	121,732,606
THE BEST CONSTRUCTION	117,630,000
D E N I S - 05	114,246,642
EVEREST	106,402,390
Grand Total	6,144,017,417

Si pjesë e rindërtimit, gjatë 2020-s janë bërë pagesa tek kontraktorët privatë në vlerën 8.9 miliardë lekë, ose rreth 73 milionë euro. Më poshtë paraqiten në mënyrë tabelore, 25 subjektet kryesore që kanë marrë 68% të pagesave të kryera për furnitorë të ndryshëm gjatë vitit 2020 nga Thesari gjatë 2020-s.

Ky artikull u bazua në të dhënat e dërguara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë pas një kërkesë

të Faktoje. Bazuar në këto të dhëna, Faktoje mundi të raportojë për qytetarët mbi përdorimin e fondit të rindërtimit duke identifikuar:

- 1 Vlerën e transfertave monetare tek individët dhe vlerën e pagesave për ndërtim objektsh të reja publike ose banimi;
- 2 Përdorimin e fondit të rindërtimit sipas Institucioneve Zbatuese qendrore dhe lokale;

1					Rakordim	-
2					Fakti 2020	16,591,212,337.00
3					Kthim te pagesave 2020	(10,248,512.00)
4					SUBTOTAL	16,601,460,849.00
5	EMRI_TDO	PERSHKRIMI_FATURES	KC	PROJECT_DESCRIPTION	FURNITORI	SHUMA
13	Kruje	2123001- Bashkia Kruje Shp 00		Shpronësim për zhvillimin e njëjës BANKA E TIRANES		1,105,000.00
14	Kruje	2123001- Bashkia Kruje Shp 00		Shpronësim për zhvillimin e njëjës Banka OTP Albania		17,517.00
15	Lezhe	BASHKIA LEZHE PAG FAT 73 00		Hartim projekt/plane vendore NG STRUCTURES		37,713,301.00
16	Lezhe	BASHKIA LEZHE PAG FAT NF 00		Hartim projekt/plane vendore ARENA MK		16,162,843.00
17	Tirane	1056001 FZHS, lik ft rinde 56		Rindërtimi i Objekteve Arsimore S I R E T A 2F		44,444,444.00
18	Tirane	1056001 FZHS, rikonstr.o 56		Rindërtimi i Objekteve Arsimore CURRI- Sh.p.k		46,200,000.00
19	Tirane	2101001 Bashkia Tirane she 00		Vlerësim dhe inspektim i dëmev ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS		11,508,900.00
20	Tirane	1012101 Instit Komb Trashg 12		Hartim "Plani i Konservimit, Ndë A & E ENGINEERING SH.P.K		1,292,000.00
21	Tirane	1087034 Pagese per hartim 87		Hartimi I Planeve te detyruara v A K - U A		2,400,000.00
22	Tirane	1012101 Instit Komb Trashg 12		Hartim "Plani i Konservimit, Ndë FOCUS ARCHITECTURE		1,104,000.00
23	Tirane	1056001 FZHS, lik ft sherb 56		Mbeshtetje per programin "She HE&SK 11		330,395.00
24	Tirane	1056001 FZHS,lik ft rinder 56		Rindërtimi i Objekteve Arsimore G. P. G. COMPANY		12,788,140.00
25	Tirane	1056001 FZHS, lik ft rinde 56		Rindërtimi i Objekteve Arsimore THE BEST CONSTRUCTION		13,070,000.00
26	Tirane	1056001 FZHS, lik ft supe 56		Mbeshtetje per programin "She STUDIO-REBUS		916,937.00
27	Tirane	2101001 Bashkia Tirane Liki 00		Hartimi I Planeve te Detyruara \ ARCHISPACE		300,000.00
28	Tirane	1087034 Pagese per hartim 87		Hartimi I Planeve te detyruara v STUDIO B&L		2,635,200.00
29	Tirane	1087034, lik pag PDYV , FT 187		Hartimi I Planeve te detyruara v Varka arkitekturë		1,308,000.00
30	Tirane	2101001 BASHkia Tirane Nd 00		Ndërtim i shkollës 9-vjecare "Q: BE - IS SH.P.K		12,065,873.00
31	Tirane	1056001 FZHS, lik ft rinde 56		Rindërtimi i Objekteve Arsimore G J I K U R I A		99,999,999.00
32	Tirane	2101001 Bashkia Tirane Nd 00		çNdërtim i shkollës çSami Frash ZENIT&CO		310,025.00
33	Tirane	1087034 Pagese per hartim 87		Hartimi I Planeve te detyruara v Varka arkitekturë		2,640,000.00
34	Tirane	1087034, lik pdyv, Bashkia 187		Hartimi I Planeve te detyruara v I RI		3,713,160.00

- Transfertat monetare sipas Institucioneve Financiare që i kishin zbatuar ato;
- Vlerat e paguara ndaj subjekteve private, të angazhuara në procesin e rindërtimit dhe listën e kompanive kryesore që kishin përfituar pagesa nga fondi i rindërtimit.

Më poshtë paraqitet një screenshot i informacionit të dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për vitin 2020, ku mund të identifikojmë pagesat e kryera, përshkrimin e tyre dhe subjektet private (furnitorin) ndaj të cilave janë kryer këto pagesa.

VITI 2021 (5 MUJORI I PARË)

Në bazë të treguesve fiskalë të bëra publike nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në 5-mujorin e parë të vitit 2021, nga fondi i rindërtimit prej 28 miliardë lekësh që është buxhetuar për këtë vit, është disbursuar rreth 33% e shumës. Konkretisht, në periudhën janar-maj të vitit 2021 janë përdorur 9,169 miliardë lekë nga fondi i rindërtimit.

Periudha në të cilën janë disbursuar më shumë para

nga ky fond rezulton të jetë muaji prill, që përkoi edhe me fushatën zgjedhore për Kuvendin e ri. Në këtë hark kohor janë shpërndarë rreth 4 miliardë lekë, pothuajse dyfishi i muajit maj, në të cilin u përdorën 2,265 miliardë lekë.


Bazuar në të dhënat e mësipërme, shuma prej 9,169 miliardë lekë ka këtë shpërndarje në përqindje: 43% e shumës është disbursuar në muajin prill, 25% në maj, 22% në mars, 10% në shkurt dhe një shumë minimale krahasimisht me muajt e tjerë, në janar.

Në 17 Qershor 2021, Faktoje ridërgoi kërkesën për informacion në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ku kërkoi ndër të tjera të dhënat e pagesave të kryera për 5 mujorin e parë të vitit 2021, periudhë që përkonte me zgjedhjet e përgjithshme në vend.

Në këtë kërkesë thuhej:

“Për secilën nga kontratat e lidhura në zbatim të procesit të rindërtimit, na detajoni pagesat e kryera nga sistemi i thesarit për 5-mujorin e parë të vitit 2021.”

Kërkesa shkante në linjë me të njëjtin informacion



Bazuar në Ligjin Nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit";

Nr. kërkesë:

TË DHËNAT E KËRKUESIT		
Emër Mbiemër: Z. Joel Çela	Adresa postare: Rruga "Nasi Payllo", Pllati "Edil-al", shk 1, kati 3, ap.8 Adresa elektronike: joelcela@faktoje.al Nr. Tel: 0694760600	Data e kërkesës: 17.06.2021 Firma:

TË DHËNAT E INSTITUCIONIT PUBLIK	
Institucioni Publik që i drejtohet kërkesa: Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Qyteti i Institucionit Publik: Tiranë

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Në vijim të kërkesës për informacion për zbatimin e procesit të rindërtimit për vitin 2020, kërkoj, aty ku është e aplikueshme, përditësimin me të dhënat nga 5-mujori i parë i vitit 2021 (Janar-Maj), për kërkesat e mëposhtme:

- Detajimin e planit buxhetor dhe realizimin e tij për pagesat e kryera në nivel projekti sipas VKM-ve të rindërtimit:
 - Pagesat mujore dhe numri i përfituesve për bonus qeraje çdo muaj
 - Pagesat e kryera (grantet e rikonstruksionit) ndaj qytetarëve për dëmtimet në nivel DS1-DS3 në nivel mujor në vlerë monetare dhe individ përfitues
 - Pagesat e kryera për rregullimet e pallateve të dëmtuara në nivel DS1-DS3
 - Pagesat e kryera për rindërtimin e pallateve me dëmtime të rënda DS4-DS5
 - Pagesat e kryera për rindërtimin e banesave individuale
 - Pagesat e kryera për rindërtimin e objekteve publike (shkolla, spitale, qendra shëndetësore etj.)
- Për fondet e alokuara me VKM për të cilat ju jeni njësi zbatuese, listën e celive buxhetore në nivel projekti investimi të detajuar sipas viteve (2021,2022).
- Listën e urdhër-prokurimeve (me datë dhe objekt urdhëri) me vlera përkatëse në nivel projekti investimi për procedura prokurime të kryera nga ju në funksion të rindërtimit.
- Për secilin projekt investimi në zbatim të rindërtimit për të cilat ju jeni përgjegjës, listën e kontratave/angazhimeve buxhetore me datë e lidhjes së kontratës, datën e përfundimit të saj, objektin e kontratës, vlerën e plotë të kontratës, subjekti fitues i kontraktuar, dhe detajimin e vlerës së plotë sipas viteve të zbatimit [2021,2022].
- Për secilin nga kontratat e lidhura në zbatim të procesit të rindërtimit, na detajoni pagesat e kryera nga sistemi i thesarit për 5-mujorin e parë të vitit 2021.
- Një kopje të regjistrit të plotë të realizimit të prokurimeve për 5-mujorin e parë të vitit 2021 ku përfshihen të gjitha prokurimet e realizuara nga institucioni juaj.


2									Shpenzime per Rindertimin 2021			
3									Current Period: 05-2021			
4												
5	Currency: ALL											
6									SUBTOTAL	9,169,065,071.00	27,060,138,456.93	
7	Enti Qe	Emertimi I	Kap	Prograr	Emertir	Llogariz	TDO	Kodi Pr	Emertimi kodit te projektit	Fakti	Buxheti Operativ	
8	1 Autoriteti Rru	1	4520	Transport	231	3535	19AH101		Rindertim i ures se Tapizes	-	151,539,896.00	
9	1 Enti Kombëta	1	6190	Strehimi	606	3535	91010AF		Pronare te shpronesuar ne zbatim te programit te rindertimit,	1,418,037.00	29,733,441.00	
10	1 Instituti Komk	1	8220	Trashegim	230	3535	19AD706		Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restaur	-	1,861,526.00	
11	1 Instituti Komk	1	8220	Trashegim	230	3535	19AD707		Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restaur	-	8,001,008.00	
12	1 Instituti Komk	1	8220	Trashegim	230	3535	19AD708		Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restaur	-	22,400,138.00	
13	1 Instituti Komk	1	8220	Trashegim	230	3535	19AD803		Kryerja e Monitorimit Arkeologjik në 26 zonat e reja të Zhvill	-	13,521,750.00	
14	1 Fondi i Zhvillir	1	6210	Programe	230	3535	19AD211		Hartimi i projekteve per banesa individuale	23,179,286.00	114,417,167.00	
15	1 Fondi i Zhvillir	1	6210	Programe	231	3535	19AD201		Rindërtimi i banesave individuale	2,341,752,457.00	3,264,655,947.00	
16	1 Fondi i Zhvillir	1	6210	Programe	231	3535	19AD203		Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termet	63,767,600.00	87,786,000.00	
17	1 Fondi i Zhvillir	1	6210	Programe	231	3535	19AD204		Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termet	90,174,057.00	246,640,003.00	
18	1 Fondi i Zhvillir	1	6210	Programe	231	3535	19AD205		Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termet	122,471,450.00	122,471,454.00	
19	1 Fondi i Zhvillir	1	6210	Programe	231	3535	19AD206		Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termet	32,107,350.00	70,197,352.00	
20	1 Fondi i Zhvillir	1	6210	Programe	231	3535	19AD207		Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termet	60,230,625.00	95,078,643.00	
21	1 Fondi i Zhvillir	1	6210	Programe	231	3535	19AD208		Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termet	52,397,665.00	52,397,667.00	
22	1 Fondi i Zhvillir	1	6210	Programe	231	3535	19AD209		Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termet	130,977,281.00	182,325,059.00	

që Ministria e Financave na kishte paraqitur për vitin 2020.

Përgjigjja e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë erdhi në datë 30 Gusht 2021, gati dy muaj e gjysmë më vonë dhe pas ankimimit të mospërgjigjes në kohë nga MFE, te Komisioneri për të Drejtën e Informimit. Në përgjigjen e mbërritur, na vihej në dispozicion

detajimi i realizimit të fondit të rindërtimit për 5 mujorin sipas projekteve dhe njësisë zbatuese, **por ndryshe nga përgjigjja për vitin 2020, nuk vihej në dispozicion lista me pagesat e kryera nga sistemi i thesarit. Kjo e bën të pamundur nga ana jonë identifikimin e subjekteve private që kanë përfutur fonde publike nga procesi i rindërtimit për 5 mujorin e parë të vitit 2021.** Ministria na

INSTITUCIONI	VLERA NE LEK
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	2,922,746,388
Bashkia Tirana	2,437,856,139
Bashkia Durres	1,440,838,789
Bashkia Vore	512,788,179
Bashkia Shijak	485,168,694
Bashkia Lezhe	439,545,343
Bashkia Lac	353,419,961
Bashkia Kamez	249,468,292
Bashkia Kavaja	153,135,582
Bashkia Kruje	94,618,667
Bashkia Rogozhine	61,270,000
Bashkia Rreshen	10,250,000
Agjencia Kombetare e Planifikimit	6,541,000
Enti Kombëtar i Banesave	1,418,037
TOTALI	9,169,065,071



referoi tek të dhënat ditore të pagesave nga thesari që publikohen në faqen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, por në këtë faqe informacioni nuk mundëson ndarjen e pagesave për rindërtimin nga pagesat e tjera të buxhetit.

Më poshtë paraqitet një screenshot i informacionit të vënë në dispozicion nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për 5 mujorin e parë të vitit 2021, **ku mungojnë detajimi i pagesave dhe subjekteve përfituese.**

Si rrjedhojë Faktoje, **nuk mund të raportojë** për subjektet private që kanë përfituar pagesa nga procesi i rindërtimit si kontraktor për shërbime, mallra dhe punë. Më poshtë, bazuar në të dhënat e paraqitura po përmbledhim të dhënat e paraqitura nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në formë grafike dhe tabelore.

Në total fondi i përdorur për rindërtimin për 5 mujorin e parë 2020, kap një vlerë prej 9.17 miliardë lekë ose rreth 90 milionë dollarë. Më poshtë paraqitet fondi i përdorur sipas Institucioneve Publike në formë tabelore dhe grafike.

Nga sa më lart shohim që institucionet kryesore janë Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Tiranë dhe Bashkia Durrës.

Më poshtë paraqitet natyra e përdorimit të fondeve të rindërtimit të grupura:

Në vijim, me qëllim faktimin e pohimeve dhe raportimin mbi transparencën dërguam kërkesat e mëposhtme për informacion në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (për periudhën nga fillimi i vitit 2020 deri në Tetor 2021) për të cilat nuk morëm përgjigje.

PERSHKRIMI	VLERA NE LEK	VLERA NE %
Rikonstruksion/Riparim i Banesave Individuale	2,676,893,899	29%
Rindertim i Banesave Individuale	4,128,880,617	45%
Rindertim objektsh publike dhe instrastructure	2,363,290,555	26%
TOTALI	9,169,065,071	100%

KËRKESË PËR INFORMACION

Bazuar në Ligjin Nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit";

Nr. kërkesë:

TË DHËNAT E KËRKUESIT		
Emër Mbiemër: "Faktoje.al" përfaqësuar nga gazetare : Ina Allkanjari	Adresa postare: Rruga "Nasi Pavlo", Pallati "Edil-al", shk 1, kati 3, ap 8 Adresa elektronike: [Redacted]	Data e kërkesës: 10.11.2021 Firma: [Signature]

TË DHËNAT E INSTITUCIONIT PUBLIK	
Institucioni Publik që i drejtohet kërkesa: Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Qyteti i Institucionit Publik: Tiranë

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Në zbatim të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore", në nenin 36 "Fondi i Rindërtimit", pika 2, thuhet "Menaxhimi, përdorimi dhe transferimi i fondeve të programit të veçantë në buxhetin e shtetit, në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit dhe të mirëfunksionimit të fondit të rindërtimit kryhet sipas parashikimeve të legjislativës në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe ligjit përkatës për buxhetin vjetor."

Në zbatim të Ligjit për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, kërkojmë të na vihet në dispozicion nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë informacioni i kërkuar nga sistemi informatik për buxhetin:

1. Të gjitha kontratat (angazhimet) e ndërmarrë nga njësitë publike dhe që lidhen me programin e Rindërtimit nga fillimi i vitit 2020 e deri në datën e kësaj kërkesë të regjistruara në sistemin e thesarit (të cilat duhet të regjistrohen brenda afatit 3-5 ditësh) me vlerën e plotë të kontratës dhe vlerën e paguar deri në fund të Tetorit 2021. Kjo e dhënë kërkohej në nivel kontrate, objekt kontrate, datë kontrate, njësi publike (Institucioni), subjekt kontraktor privat (furnitori), vlerë kontrate totale, vlerë e paguar kontrate.
2. Të gjitha pagesat e kryera nga njësitë publike dhe që lidhen me programin e Rindërtimit nga fillimi i vitit 2020 e deri në datën e kësaj kërkesë të regjistruara në sistemin e thesarit. Kjo e dhënë kërkohej në nivel pagese, përshkrim pagese, datë pagese, njësi publike (Institucioni), subjekt përfitues privat (Furnitori), vlerë pagese. Fushatë kërkuara janë të paktën këto më poshtë:
 - Emri TDO
 - Invoice ID
 - Numri Fatures
 - Përshkrimi Fatures
 - Ministria e Linjes
 - Kodi Institucionit
 - Emri Institucionit
 - EC Account Description
 - Kodi Projektit
 - Project Description
 - Furnitori
 - Shuma
 - Data Furnitorit
 - Data urdher Shpenzimit
 - GL Date
 - Data Rregjistrimit
 - Data Ekzekutimit
3. Listën e të gjitha marrëveshjet e huase të nënshkruara nga Qeveria Shqiptare në lidhje me programin e rindërtimit. Për secilën marrëveshje, detajoni: Vlerën e marrëveshjes së huase, objektin e marrëveshjes së huase, datën e nënshkrimit të marrëveshjes së huase, normën e interesit, kohëzgjatjen, institucionin kreditues, dhe vlerën totale të disbursuar të huase deri në datën e kësaj kërkesë.
4. Listën e të gjitha marrëveshjet të Grantit të nënshkruara nga Qeveria Shqiptare në lidhje me programin e rindërtimit. Për secilën marrëveshje, detajoni: Vlerën e marrëveshjes së Grantit, objektin e marrëveshjes së grantit, datën e nënshkrimit të marrëveshjes së grantit, donatorin, dhe vlerën totale të disbursuar/realizuar të grantit deri në datën e kësaj kërkesë.

Forma që kërkohej informacioni / dokumentacioni:

Këtë informacion mund ta vini në dispozicion nëpërmjet postës elektronike.

	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M												
1	EMRI	TDC	NUMRI	FATURES	PERSHKRIMI	FATURES	KODI	LM	MINISTRIA	LINJES	KODI	INSTITUCIONIT	EMRI	INSTITUCIONIT	EC	ACCOUNT	EC	ACCOUNT	DESCRIPTION	FURNITOR	SHUMA	DATA	REC	DATA	EKZEK
2	Berat	7451013064	2021	1013064	Spitali Rajonal	13	Ministria e Shendetesise	1013064	Sp. Berati (0202)	6001001	Paga neto për punonjesit e m	BANKA AL	1431360	06.12.202	07.12.2021										
3	Berat	1352102019	2021	2102019	qendra e zhvillimit	13	Ministria e Shendetesise	2102019	Qendra e Zhvillimit Berat	6001001	Paga neto për punonjesit e m	RAIFFEISE	322795	06.12.202	07.12.2021										
4	Berat	2321028003	2021	1028003	prokuroria,shf	28	Prokuroria e Pergjithshme	1028003	Prokuroria e rrethit Berat	6022002	Uje	UJESIELLE	1718	06.12.202	07.12.2021										
5	Berat	1392102019	2021	2102019	qendra e zhvillimit	13	Ministria e Shendetesise	2102019	Qendra e Zhvillimit Berat	6022004	Posta dhe sherbimi korrier	POSTA SH	685	06.12.202	07.12.2021										
6	Berat	2341028003	2021	1028003	prokuroria,shf	28	Prokuroria e Pergjithshme	1028003	Prokuroria e rrethit Berat	6022003	Sherbime telefonike	ALBTELEKI	1920	06.12.202	07.12.2021										
7	Berat	7491013064	2021	1013064	Spitali Rajonal	13	Ministria e Shendetesise	1013064	Sp. Berati (0202)	6001001	Paga neto për punonjesit e m	Banka e P	48410	06.12.202	07.12.2021										
8	Berat	1481005119	2021	1005119	AKU Berat, fat	05	Ministria e Bujqesise	1005119	Drejtoria Rajonale AKU Berat	6022004	Posta dhe sherbimi korrier	POSTA SH	15645	06.12.202	07.12.2021										
9	Berat	1971014051	2021	1014051	paraburgimi	14	Ministria e Drejtesise	1014051	Paraburgimi Berat (0202)	6023900	Shpenzime te tjera transporti	DREJT. PEI	15036	06.12.202	07.12.2021										
10	Berat	2021026061	2021	1026061	drejtoria e mjekshme	26	Ministria e Turizmit	1026061	Agjencia Rajonale e Mjedisit	6022003	Sherbime telefonike	ALBTELEKI	2500	06.12.202	07.12.2021										
11	Berat	2031026061	2021	1026061	drejtoria e mjekshme	26	Ministria e Turizmit	1026061	Agjencia Rajonale e Mjedisit	6022003	Sherbime telefonike	ALBTELEKI	3000	06.12.202	07.12.2021										
12	Berat	10442102001	2021	2102001	bashkia berat	00	Unspecified	2102001	Bashkia Berat (0202)	2315210	Shpenz. per rritjen e AQT - m	DREJTORIA	1371141	03.12.202	07.12.2021										
13	Berat	1351012014	2021	1012014	qendra muzei	12	Ministria e Kultures	1012014	Qendra Muzeore Berat	6022002	Uje	UJESIELLE	1534	06.12.202	07.12.2021										
14	Berat	2141029012	2021	1029012	gjykata,shpen	29	Keshilli i Larte Gjyqesore	1029012	Gjykata e rrethit Berat	6022002	Uje	UJESIELLE	3586	06.12.202	07.12.2021										
15	Berat	7461013064	2021	1013064	Spitali Rajonal	13	Ministria e Shendetesise	1013064	Sp. Berati (0202)	6001001	Paga neto për punonjesit e m	BANKA CR	1.1E+07	06.12.202	07.12.2021										
16	Berat	841013111	2021	1013111	insp. shendetesise	13	Ministria e Shendetesise	1013111	ISHSH Rajonal Berat	6023300	Shpenzimet e siguracimit te	SIGAL UNI	18770	06.12.202	07.12.2021										
17	Berat	1361012014	2021	1012014	qendra muzei	12	Ministria e Kultures	1012014	Qendra Muzeore Berat	6022099	Sherbime te tjera	"BERNET"	9900	06.12.202	07.12.2021										
18	Berat	1882102022	2021	2102022	drejtoria e bujqesise	00	Unspecified	2102022	Drejtoria e Bujqesise Adm	6022099	Sherbime te tjera	"BERNET"	8000	06.12.202	07.12.2021										
19	Berat	10342102001	2021	2102001	bashkia berat	00	Unspecified	2102001	Bashkia Berat (0202)	6001001	Paga neto për punonjesit e m	BANKA E	38957	06.12.202	07.12.2021										
20	Berat	1981014051	2021	1014051	paraburgimi	14	Ministria e Drejtesise	1014051	Paraburgimi Berat (0202)	6022004	Posta dhe sherbimi korrier	POSTA SH	7685	06.12.202	07.12.2021										
21	Berat	2041026061	2021	1026061	drejtoria e mjekshme	26	Ministria e Turizmit	1026061	Agjencia Rajonale e Mjedisit	6022003	Sherbime telefonike	ALBTELEKI	1400	06.12.202	07.12.2021										

Përgjigja për këtë kërkesë erdhi rreth një muaj më vonë në datë 9.12.2021. Në këtë përgjigje, në lidhje me pyetjen 2, dhe ndryshe nga dy herët e kaluara, nuk na vihet në dispozicion asnjë e dhënë, por drejtohem tek faqja zyrtare e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në përgjigjen e kësaj Ministrie thuhet se “Informacioni për të gjitha pagesat e kryera nga njësitë publike mbi baza ditore publikohen në linkun <https://www.financa.gov.al/pagesa-te-kryera-nga-drejtoria-e-pergjithshme-e-thesarit-2/>”.

Faktoje ju drejtua linkut të mëposhtëm. Një screenshot i të dhënave ditore që jepën në këtë publikim paraqitet më poshtë.

Konstatohet se, ndryshe nga sa kërkuar, në këto botime të MFE-së **mungojnë fusha të rëndësishme informacioni për çdo pagesë që Faktoje ka kërkuar si: Kodi i projektit, Project Description, Data e Furnitorit, GL Date, dhe Data e Urdhër Shpenzimit.** Mungesa e këtyre fushave, informacioni i cili na u vu në dispozicion për vitin 2020, e bën shumë të vështirë të identifikojmë saktë pagesa që lidhen me rindërtimin, si dhe të raportojmë jo vetëm për përfituesit e rindërtimit dhe datat e pagesave, por edhe mbi datat e lëshimit të faturave.

B.2. GRANTET E RIKONSTRUKSIONIT SIPAS BASHKIVE

VITI 2020

Më poshtë paraqitet lista sipas Institucioneve Publike për fondin prej 7.61 miliardë lekë ose rreth 74 milionë dollarë, për zërin “Rikonstruksion/Riparim i Banesave Individuale” dhe “Rindërtim i banesave individuale” që janë transferta korrente në formë granti tek individë për vitin 2020.

INSTITUCIONI	VLERA NE LEK
Bashkia Durres	3,317,300,000
Bashkia Tirana	1,089,025,000
Bashkia Kruje	689,100,000
Bashkia Shijak	671,886,209
Bashkia Lac	476,800,000
Bashkia Lezhe	393,600,000
Bashkia Kavaja	334,350,000
Bashkia Kamez	331,762,000
Bashkia Vore	183,900,000
Bashkia Rogozhine	110,900,000
Bashkia Rreshen	29,815,000
TOTALI	7,628,438,209

VITI 2021 (5 MUJORI I PARË)

Më poshtë paraqitet lista sipas Institucioneve Publike për fondin prej 3.35 miliardë lekë ose rreth 31 milionë dollarë, për zërin “Rikonstruksion/Riparim i Banesave Individuale” dhe “Rindërtim i banesave

individuale” që janë transferata korrente në formë granti tek individë për 5 mujin e parë 2021.

INSTITUCIONI	VLERA NE LEK
Bashkia Durrës	856,075,518
Bashkia Tirana	624,126,052
Bashkia Vore	512,788,179
Bashkia Shijak	485,168,694
Bashkia Lac	340,784,330
Bashkia Lezhe	285,784,035
Bashkia Kamez	128,148,000
Bashkia Rogozhine	61,270,000
Bashkia Kavaja	33,904,964
Bashkia Kruje	12,850,000
Bashkia Rreshen	10,250,000
TOTALI	3,351,149,772

B.3. DEMOLIMI I PALLATEVE EKZISTUESE

Faktoje ka analizuar procesin e demolimit të pallateve për të cilat është marrë vendimi për shembje tyre dhe më pas rindërtimin e tyre. Nga verifikimet e kryera në vendndodhje të ndryshme, **Faktoje konstatoi se procesi i shembjes së pallateve paraqitet me vonesa, të cilat janë duke sjellë zvarritur procesin e rindërtimit në tërësi, në rajonet e Krujës, Lezhës**

dhe sidomos Tiranës. Në të njëjtën kohë, është krijuar edhe databaza e pallateve të klasifikuar për shembje, bazuar në kërkesat për informacion drejtuar bashkive, për ato bashki të cilat është përcjellë informacion.

B.3.1. BANORËT NË KOMBINAT JETOJNË ENDE NË PALLATET QË DUHEN SHEMBUR

Publikuar më 7.10.2021 në faktoje.al

Në Kombinat, më shumë se 1 vit e gjysmë pas tërmetit të 26 nëntorit, procesi i shembjes së pallateve të dëmtuara rëndë nga tërmeti për t'i hapur rrugë rindërtimit vijon të jetë ende me shumë vonesa. Gjatë inspektimit në terren në datën 26.05.2021 Drejtori i Përgjithshëm i Bashkëpronësisë në Bashkinë e Tiranës, Aurel Çuko u shpreh se vetëm në Kombinat janë për t'u demolu 67 pallate dhe se ky proces parashikohej të mbyllej brenda 3 muajsh.

“Sot jemi në Kombinat, ku po vazhdojmë me procesin e demolimit, proces që ka filluar prej disa kohësh. Këtu jemi në pallatin nr. 155. Është një pallat relativisht i madh dhe besojmë se fazën e parë në Kombinat



TË DHËNAT E INSTITUCIONIT PUBLIK	
Institucioni Publik që i drejtohet kërkesa: Bashkia Tiranë	Qyteti i Institucionit Publik: Tiranë

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar
Objekt kërkesë: Lista e pallateve për rindërtim

Sa pallate janë demoluara? Cilat janë ato?
 Sa pallate janë në proces vlerësimi? Cilat janë ato?
 Sa pallate janë klasifikuar për t'u rindërtuar plotësisht? Cilat janë ato?

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni:

Këtë informacion mund ta vini në dispozicion nëpërmjet postës elektronike.

e mbarojmë brenda pak ditëve. Në total ne kemi 198 pallate, të cilave u kemi bërë akt-ekspertizë të thelluar. 111 janë për t'u demoluara dhe vetëm në Kombinat janë për t'u demoluara 67 pallate. Besoj se brenda 2-3 muajve e përfundojmë procesin e demolimit.”- u shpreh Çuko.

Ministri i Rindërtimit, Arben Ahmetaj, deklaroi se në tetor të 2020-s do të fillonte prishja dhe pastrimi i inerteve në zonën e Kombinatit dhe deri në fund të tetorit, do të fillonte hedhja e themeleve për pallate të tjera. Ashtu siç Faktoje ka verifikuar në terren edhe më parë, situata ka “ngecur”, pasi shumë nga pallatet e dëmtuara nga tërmeti, nuk janë shembur.

Në përfundim të afatit të premtuar për shembjen e pallateve të pabanueshme, Faktoje i dërgoi një kërkesë për informacion bashkisë Tiranë, ku kërkonte informacion se sa pallate ishin shembur.

Në përgjigjen për Faktoje, Bashkia Tiranë informoi se shembja e detyruar dhe zbatimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak për këto objekte, është ende në proces. Në përgjigjen zyrtare të bashkisë Tiranë bie në sy përgjysmimi i numrit të pallateve për t'u shembur. Nga 67 pallate që u deklaruan për t'u shembur në datën 26.05.2021, zyrtarisht bashkia konfirmon vetëm 32.

Në vijim të kërkesës suaj ardhur nëpërmjet adresës së koordinatorit për të drejtën e informimit Bashkisë Tiranë, protokolluar me nr. prot. A-16627, datë 28.07.2021 ju informojmë se Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, nëpërmjet Drejtorisë së Emergjencave Civile ka kthyer përgjigje, dhe ju bën me dije përsa më poshtë:

“Për të gjitha pallatet e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, të cilat sipas aktvlerësimeve paraprake nga Instituti i Ndërtimit, apo nga grupet e vlerësimit në njësitet administrative, kanë pasur nevojë për një verifikim më të thelluar për të përcaktuar gjendjen teknike të këtyre objekteve, Bashkia Tiranë ka ndjekur procedurën për kryerjen e aktekspertizës së thelluar duke kontraktuar operatorë ekonomik për kryerjen e këtij shërbimi, referuar Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019. Mbi bazën e aktekspertizës së thelluar dhe opionencës së Institutit të Ndërtimit, me Vendim të Këshillit Bashkiak është vendosur prishja e këtyre objekteve (pallate).

Sa i përket demolimit të detyruar dhe zbatimit të vendimeve të Këshillit Bashkiak për këto objekte, ju informojmë se është ende në proces. Bashkëlidhur, lista e skanuar e pallateve”.

Sheet4

Pallatet e miratuara me vendim të Këshillit Bashkiak për prishjen e detyruar.				
Nr.	Njësia Administrative	Pallati	Adresa	VKB
1	6	12 dhe 13	Benardin Palja	102 prot, datë 28.09.2020
2	6	131	Llambi Bonata	103 prot, datë 28.09.2020
3	6	131	Llazi Miho	104 prot, datë 28.09.2020
4	6	141	Sokrat Mosko	105 prot, datë 28.09.2020
5	6	145	Sokrat Mosko	106 prot, datë 28.09.2020
6	6	146	Sokrat Mosko	107 prot, datë 28.09.2020
7	6	152/3	Haki Stermilli	108 prot, datë 28.09.2020
8	6	154	Sokrat Mosko	109 prot, datë 28.09.2020
9	6	155/1	Llambi Bonata	110 prot, datë 28.09.2020
10	6	159	Llazi Miho	111 prot, datë 28.09.2020
11	6	163/1,163/3	Sokrat Mosko	112 prot, datë 28.09.2020
12	6	163	Ali Kelmendi	113 prot, datë 28.09.2020
13	6	149	Llazi Miho	114 prot, datë 28.09.2020
14	6	151	Sokrat Mosko	115 prot, datë 28.09.2020
15	6	155/1	Llambi Bonata	116 prot, datë 28.09.2020
16	6	157	Hamdi Cenoimeri	117 prot, datë 28.09.2020
17	6	160	Sokrat Mosko	118 prot, datë 28.09.2020
18	6	165, 165/1, 1652/2, 165/3	Tanush Frasheri	119 prot, datë 28.09.2020
19	6	174	Hamdi Cenoimeri	120 prot, datë 28.09.2020
20	6	153, 153/1	Sokrat Mosko	121 prot, datë 28.09.2020

Screenshot, përgjigja e Bashkisë Tiranë 07.10.2021

28 pll.

Nr.	Operatorët Ekonomik	Pallati	Rruga	N.J. Adm.
1	Infrakonsulti	434/1	Behlul Hatibi	4
2	Infrakonsulti	14	Aleksander Moisiu	4
3	Infratech & Archimade	45	Myslym Keta	4
4	Infratech & Archimade	66, 3 hyrje	Aleksander Moisiu	4
5	Infratech & Archimade	4	Myslym Keta	4
6	Infratech & Archimade	73/2	Niko Avrami	4
7	ICE	369/4	Ferit Xhajko	8
8	Net Group	26	Rr. "Fortuzi"	9
9	Net Group	415/1,objekti I, II, III	Ferit Xhajko	8
10	Net Group	1	Rr. "Karl Gega"	9
11	UTS -01	164/2	Ali Kelmendi	6
12	UTS -01	150	Sokrat Mosko	6
13	UTS -01	127	Llazi Miho	6
14	UTS -01	147	Tanush Frasheri	6
15	UTS - 01	22	Qendra e Re	Krrabe
16	UTS - 01	140	Sokrat Mosko	6
17	Archispace shpk	11/ 01	Vath Koreshi	2
18	Archispace shpk	104, H 6	Ali Demi	1
19	Archispace shpk	5	Todi Shkurti	2
20	Archispace shpk	5	Marsel Kasemi	2
21	Klodioda shpk	152	Haki Stermilli	6
22	Klodioda shpk	140	Haki Stermilli	6
23	Klodioda shpk	168	Hamdi Cenoimeri	6
24	Klodioda shpk	138	Haki Stermilli	6
25	Klodioda shpk	Dritas	Dritas	Zall Herr
26	Klodioda shpk	161	Sokrat Mosko	6
27	Klodioda shpk	14	Llambi Bonata	6
28	Klodioda shpk	158	Llambi Bonata	6

Screenshot, përgjigja e Bashkisë Tiranë 07.10.2021

Bashkia e Tiranës na vuri gjithashtu në dispozicion dy lista. Në listën e parë përfshihen 20 pallate të përcaktuara për t'u shembur, të gjitha në zonën e Kombinatit, njësisia administrative numër 6.

Sipas "Open Procurement" kontrata e tenderit për demolim dhe evadim të mbetjeve ndërtimore, është publikuar në Buletinin e Posaçëm Nr. 48 datë 02 Prill 2021, ndërsa procesi i demolimit ka nisur në maj 2021.

Për listën e dytë ku përfshihen 28 pallate, një pjesë e të cilëve ndodhen po në zonën e Kombinatit, sipas Open Procurement tenderi për demolimin dhe evadimin e mbetjeve ndërtimore, është shpallur me Buletinin e Posaçëm Nr. 133 datë 7 Shtator 2021. Nga verifikimi i informacionit, që jepet në dokumentat e Open Procurement rezulton se për 12 pallate, kontratat/shpallja e tenderave etj, janë bërë shtatorin e vitit 2021, çka dëshmon se procesi i shembjes ende nuk ka nisur.

SITUATA NË TERREN

Faktoje verifikoi në terren se në çfarë faze është shembja e pallatave të planifikuara, që i hap më pas

rrugën rindërtimit. Banorë të zonave ku ndodhen objektet (pallate të pabanueshme për t'u shembur) pranojnë se procesi ka filluar, por ka ende shumë pallate, që nuk janë shembur.

"Deri tani janë rreth 11 pallate të shembura, nuk e dimë dhe sa kohë do zgjasë ky proces. Nuk kemi asnjë informacion, nuk e dimë çfarë do të bëhet. Që kur ra tërmeti po luajnë me ne, nuk jemi ende të qartë çfarë do të ndodhë. Nuk kemi informacion, por nëse është vendosur që pallati do të shembet pse nuk na lajmërojnë se ku do rindërtohet, ku do të jetë banesa jonë." - shprehet një banor i Kombinatit, i cili nuk pranoi të identifikohet.

Gjatë vëzhgimit në terren, identifikuam raste të banorëve, të cilët jetonin ende në pallate për të cilat ka dalë vendimi për shembje.

"Na erdhi vendimi që pallati 168/2 është për shembje, por nuk kemi asnjë të dhënë që të tregojë ku do jetojmë ne që kemi apartamentet këtu, ku do ndërtohen banesat tona, në çfarë zone. Informacioni i vetëm është që pallati është për shembje, na thanë merrni këtë 180 mijë lekë të vjetra bonus qera dhe gjeni ambient me qira ku të dëshironi dhe do t'ju njoftojmë ne se ku do i përfiton banesat tuaja. Nuk të japin



Foto nga vendi ku janë shembur pallatet në rrugën Kristo Nakuçi, Kombinat, 15 shtator 2021



garanci, që pasi të shembet pallati do e përfitojmë sërish në këtë zonë banesën. Unë kam 45 vjet që jetoj këtu, si mund të mos më japin një informacion se në çfarë zone do e përfitoj unë apartamentin kur të shembet pallati?”- shprehet për Faktoje, Novruz Sekollari i cili nuk ka dalë nga apartamenti, ndonëse vendimi për shembjen e pallatit ku jeton, i ka ardhur rreth 2 muaj më parë.

“Unë jam banore e pallatit numër 158, që doli njëherë për shembje, njëherë për riparim. Është shumë e paqartë kjo situatë! Ne nuk kemi asnjë informacion se ku do ndërtohen pallatet që do jetojmë. Akoma nuk dimë nëse do shembet apo jo, pallati ku kam apartamentin, ca thonë riparim, disa thonë prishje. Vetëm dy familje kemi ngelur te ky pallati, të tjerët kanë lëvizur.”- tregon Lumturie Hysa, banore e zonës së Kombinatit.

Tjetër shqetësim i banorëve të Kombinatit është se disa pallate, të cilat janë boshatisur disa muaj pas tërmetit të 26 nëntorit, ende nuk janë shembur, dhe sot janë kthyer në vatra problematike.

“Kanë rreth 1 vit e gjysëm që na kanë thënë që pallati 174 do të shembet sot, do shembet nesër, por ende nuk është shembur. Banorët e këtij pallati kanë më shumë se 1 vit që janë larguar dhe janë akomoduar në banesa me qira. Problem është bërë për ne që jetojmë këtu, pasi është kthyer në vatër infeksioni, prostitucioni dhe droge!”- shprehet për Faktoje një banor i zonës, që nuk pranoi të identifikohet.

Faktoje iu drejtua me një tjetër kërkesë për informacion në datë 21.09.2021 Bashkisë Tiranë nëse ua kanë bërë transparente banorëve vendndodhjen e pallateve që do rindërtohen.

Më datë 28.10.2021 në përgjigjen e ardhur për Faktoje, Bashkia Tiranë konfirmon se nga 20 pallatet e para të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, janë demoluar 13 pallate.

Në vijim të përgjigjes së saj, bashkia shtoi listën me 8 pallate të miratuara për demolim.

Faktoje ankimoi përgjigjen e ardhur nga Bashkia duke e konsideruar të paplotë, pasi nuk kishte asnjë



Foto nga pallati nr.168/2 në Kombinat, 15 Shtator 2021



Foto nga pallati 158 në Kombinat, 15 Shtator 2021



Pallati nr 174 në Kombinat, 15 shtator 2021

Bazuar në Ligjin Nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit";

Nr. kërkesë:

TË DHËNAT E KËRKUESIT		
Emër Mbiemër: Znj. Ina Allkanjari	Adresa postare: Rruga "Nasi Pavlo", Pallati "Edil-al", shk 1, kati 3, ap 8 Adresa elektronike: [Redacted] Nr. Tel: [Redacted]	Data e kërkesës: 21.09.2021 Firma: [Signature]

TË DHËNAT E INSTITUCIONIT PUBLIK	
Institucioni Publik që i drejtohet kërkesa: Bashkia Tiranë	Qyteti i Institucionit Publik: Tiranë

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Në vijim të kërkesës së Faktoje drejtuar Bashkisë Tiranë protokolluar me nr. prot. A-16627, datë 28.07.2021, për demolimin e pallateve në zonën e Kombinatit, ju lutem na vendosni në dispozicion:

1. Nga lista e pare me 20 pallate, ku me vendim te keshillit Bashkiak te dates 28.09.2020 jane shpallur per tu shembur, ju lutem na specifikoni sa është ne total numri i pallateve te shembura dhe cilat jane konkretisht? (Listoni pallatet e shembura me adresat perkatese)
2. Nga lista e dyte me 28 pallate, te cilat me vendim te vendimit te keshillit Bashkiak jane shpallur per tu shembur, ju lutem na specifikoni sa është ne total numri i pallateve te shembura dhe cilat jane konkretisht? (Listoni pallatet e shembura me adresat perkatese)
3. Sa pallate jane vendosur qe do te demolohen por ende nuk jane shembur?
(Na vendosni ne dispozicion listen e pallateve te cilat nuk jane shembur ende, me adresat perkatese)
4. Cila eshte arsyeja qe keto pallate nuk jane shembur ende?
5. Brenda cilit afat pritet te perfundoj shembja e pallateve te vendosura per demolim?
6. Banoret, pallatet e te cileve jane vendosur per shembje, a jane informuar se ku do te ndertohen banesat e tyre te reja?
7. A do te rindertohen ato ne zonen ku po behet shembja e pallateve? Nese jo, ku do te ndertohen?
8. A do te jete projekti "KombinaArt" i vendosur ne zonen ku do te shemben pallatet?

Screenshot i kërkesës për informacion drejtuar Bashkisë Tiranë, datë 21.09.2021

Sheet1

8 PALLATE PËR DEMOLIM ME VKB

Nr.	Studio e kontraktuar	Pallati	Nj. Adm.	Rruga:	VKB
1	Dea-N Construction&Viant Construction	15	5	Preng Bib Doda	Nr. 103 datë 02.08.2021
2	Instituti Dekliada – Alb Shpk.	3	7	Viktor Hygo	Nr. 104 datë 02.08.2021
3	Arabel Studio Shpk.&Llazo Shpk.	8(44)	4	Myslym Keta	Nr. 105 datë 02.08.2021
4	Arabel Studio Shpk.&Llazo Shpk.	15	5	Margarita Tutulani	Nr. 106 datë 02.08.2021
5	Arabel Studio Shpk.&Llazo Shpk.	8	6	Reshat Baxhaj	Nr. 107 datë 02.08.2021
6	Arabel Studio Shpk.&Llazo Shpk.	44	6	Hamdi Cenoimeri	Nr. 108 datë 02.08.2021
7	Arabel Studio Shpk.&Llazo Shpk.	6	6	Sejfi Villamasi	Nr. 109 datë 02.08.2021
8	Arabel Studio Shpk.&Llazo Shpk.	19	6	Llambi Bonata	Nr. 110 datë 02.08.2021

Screenshot, përgjigja e Bashkisë Tiranë e ardhur më datë 28.10.2021

Në vijim të komunikimit tuaj të mëposhtëm, ju bëj me dije se për pyetjet 6,7 dhe 8 nga Drejtoria e Përgjithshme dhe Zhvillimit të Territorit është vënë në dispozicion informacioni që disponojnë të cilin e gjeni më poshtë:

Pyetja nr. 6: Bashkia e Tiranës ka hartuar Planin e Detyruar Vendor, i cili përcakton vendodhjen e godinave ndërtohen për të mundësuar strehimin e familjeve që kanë humbur banesat e tyre nga tërmeti i datës 26.11.2019. keni Planin e Detyruar Vendor të miratuar. Në harte, me vijen blu të ndërprerë keni të përcaktuar kufirin e zonës së ndërtimit.

Pyetja nr. 7: Studimi i miratuar, të cilin e keni bashkëlidhur detajon se, ku do të ndërtohen objektet e reja. Në hartë, me vijen blu të ndërprerë keni të përcaktuar kufirin e zonës së ndërtimit.

Pyetja nr. 8: Kombinart është emri që ka marrë i gjithë masterplani i miratuar si Plan i Detyruar Vendor. Ai përcaktuar në VKM dhe sipas studimit, të cilin e keni bashkëlidhur këtij emaili.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

Ju uroj ditë të mbare.

Blerta Goxha
KOORDINATORE PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT



Screenshot përgjigja e Bashkisë Tiranë e ardhur më datë 10.11.2021



Pamje nga projekti 3D i zonës së Kombinatit i prezantuar në 7 korrik 2020

RINDËRTIMI

Në fund të pranverës së vitit 2022 nuk do të ketë më asnjë gjurmë të tërmetit

Rindërtimi është sot programi më i madh urban, ekonomik e social, që garanton më shumë se veç rimëkëmbjen pas tërmetit. Çdo familje që humbi shtëpinë, do të marrë një të re, falas, të ndërtuar më mirë, më fort, më bukur, me standarde ndërkombëtare, e po njësoj të gjitha shkollat, çerdhet, kopshtet dhe objektet publike. Sot e gjithë zona e dëmtuar është një kantier ndërtimi, që ka krijuar punësim masiv dhe një impakt ekonomik të konsiderueshëm.

Vendosim mbi 60 miliardë lekë nga buxheti i shtetit në funksion të Programit të Rindërtimit për tre vite. 100% e granteve të premtuara në Konferencën e Donatorëve, 300 milionë euro, janë aktive në mbi 30 projekte konkrete në strehim, arsim dhe infrastrukturë publike. Mbi 33 mijë e 400 familje kanë përfituar grante rikonstruksioni dhe rindërtimi në vlerën 12.7 miliardë lekë, krahas rikonstruksionit të ambienteve të përbashkëta në mbi 1100 pallate. 13 mijë e 325 qytetarë janë trajtuar me bonus qiraje, pagesa që do të vazhdojnë deri në rikthimin në banesat e reja. 27 shkolla kanë përfunduar, ndërsa puna vijon çdo ditë në kantieret e rinj të objekteve arsimore, pallateve dhe infrastrukturës publike në lagjet e reja, që do t'i shërbejë 500 mijë banorëve.

450 kompani kanë angazhuar mbi 24 mijë punëtorë në rreth 3100 kantiere ndërtimi, ku po marrin formë çdo ditë godinat e reja, të pakrahasueshme me ato që shkatërroi tërmeti.

Në fund të pranverës së vitit 2022 nuk do të ketë më asnjë gjurmë të tërmetit shkatërrues të 26 nëntorit 2019!

të dhënë për pyetjet 6,7 dhe 8. Më datë 10 nëntor 2021, Bashkia Tiranë ktheu përgjigje lidhur me kërkesën e dërguar.

Shembja që i hap rrugë rindërtimit

Në zonën ku ndodhen pallatet për t'u shembur qeveria ka planifikuar projektin "KombiArt". Ky projekt, që parashikon të shndërrojë tërësisht lagjen e ish Kombinatit në Tiranë, u prezantua në 7 korrik 2020, nëpërmjet një projekti 3D nga ana e kreut të Bashkisë Veliaj. Sipas këtij plani, sipërfaqja prej 1.5 milionë m2 në zonën e Kombinatit, do të përdoret për ndërtim me qëllim strehimin e 21 mijë individëve.

E ndërsa procesi i shembjes së pallateve të shpallura të pabanueshme, ende vijon të ecë më ritme të ngadalta, premtimi i qeverisë është se i gjithë procesi 3-vjeçar i rindërtimit, përfundon në pranverën e vitit 2022.

B.3.2. Lezhë, në pallatin gjysmë të shembur jeta 'vazhdon normalisht'

Publikuar më 8.10.2021 në faktoje.al

"Do të procedohet me rindërtimin nga e para të 10 pallateve, nga të cilat do përfitojnë apartamente të tjera më shumë se 200 familje." - deklaroi në një intervistë për ATSH-në, më 2 janar të vitit 2021, prefekti i Qarkut të Lezhës, Gjok Jaku.

Nisur nga kjo deklaratë, ne iu drejtuam me një kërkesë për informacion **bashkisë Lezhë** dhe pyetëm se sa pallate janë planifikuar për t'u shembur dhe më pas për t'u rindërtuar.

Sipas përgjigjes së Bashkisë Lezhë për Faktoje, janë 91 pallate të dëmtuara nga tërmeti, ku nga këto:

- 39 pallate janë për përforsim
- 42 pallate janë për rikonstrukcionin e ambienteve të përbashkëta
- 10 pallate janë për shembje (9 pallate janë shembur dhe janë në proces rindërtimi)

Pallatet per shembje dhe rindertim		
Nr.	Pallati	Rruga
1	Pallati nr. 3	Rruga "Lissus"
2	Pallati nr. 5	Rruga "Lissus"
3	Pallati nr. 3	Rruga "Hydajet Lezha"
4	Pallati nr. 71	Rruga "Luigj Gurakuqi"

5	Pallati nr. 1	Rruga "Princat e Kuvendit"
6	Pallati nr. 27	Rruga "Kol Toma"
7	Pallati nr. 23	Rruga "Kol Toma"
8	Pallati nr. 7	Rruga "Manatisë"
9	Pallati nr. 41	Rruga "Abat Preng Doçi"
10	Pallati nr. 8	Rruga "Abat Preng Doçi"

Screenshot, përgjigja e Bashkisë Lezhë për Faktoje, datë 13.08.2021



Pallat në rrugën "Luigj Gurakuqi", 14 shtator 2021



Pallat në rrugën "Luigj Gurakuqi", 14 shtator 2021



Pallat në rrugën "Luigj Gurakuqi", 14 shtator 2021

Bashkia nuk specifikon se cili është pallati që ende nuk është shembur.

Faktoje shkoi në Lezhë në muajin shtator për të verifikuar se cili është objekti i fundit i planifikuar të shembet dhe se në çfarë faze ishte procesi i rindërtimit të pallateve të reja. Gjatë vëzhgimit në terren, vumë re se pallatet nuk kishin numra, ashtu siç identifikohen në listën e dërguar nga bashkia e Lezhës.

Në rrugën "Luigj Gurakuqi", aty ku figuron objekti për t'u shembur sipas bashkisë, rezulton se ishte shembur gjysma e pallatit. Pavarësisht pamjes së rrënuar, mësuam se pallati gjysmë gërmadhë banohet nga disa familje. Banorë të këtij pallati, na komunikuan se ata nuk kishin dëmtime brenda apartamenteve të tyre.

"Nuk kemi pasur dëmtime nga tërmeti. Nuk na është thënë gjë për t'u shembur kjo pjesa ku jetojmë ne"- thotë për Faktoje një prej banorëve, që nuk pranoi të identifikohet.

"S'kemi informacion që do shembet. Është dëmtuar pjesa tjetër e pallatit, jo kjo këtu"- shprehet një tjetër banor.

Në katin e parë të këtij pallati ushtrojnë qetësisht aktivitetin disa biznese që ashtu si banorët, nuk kanë informacion nëse objekti është në plan për t'u shembur ose jo.

Përreth këtij gjysmëpallati, gjenden inertet e papastruara pas shembjes së gjysmës tjetër, ndërsa banorët bashkëjetojnë qetësisht me këtë realitet.

Ne iu drejtua sërish me një kërkesë për informacion Bashkisë Lezhë, ku u interesuam nëse objekti ekzistues në rrugën "Luigj Gurakuqi" është pallati 71, i renditur në listën e objekteve për t'u shembur dhe si do veprohet me këtë gjysmë-ndërtesë.

Në përgjigjen e rradhës të ardhur më datë 25.11.2021 nga Bashkia Lezhë, konfirmohet se pallati nr.71 do t'i nënshtrohet rikonstruksionit.

"Bashkia Lezhë do të bëjë rikonstruksionin dhe



Kantier ndërtimi në rrugën "Kolë Toma", Lezhë 14 shtator 2021



Kantier ndërtimi në rrugën "Hydajet Lezha", 14 shtator 2021

përforcimin e këtij pallati. Projekti i hartuar nga Bashkia Lezhë për përforcimin e pallatit nr.71 është në vlerë 23,680,035 lekë pa TVSH. Me akordimin e fondit nga Këshilli i Ministrave do të fillohet me procedurën ligjore të zbatimit të projektit"- shkruan Bashkia Lezhë.

Procesi i rindërtimit të pallateve po zvarritet

Pas verifikimit në pallatin në rrugën "Luigj Gurakuqi" Faktoje bëri një vëzhgim në kantierët ku po punohet për rindërtimin e pallateve të tjerë.

Në rrugën "Kolë Toma" është hapur kantieri për 3 pallate, sipas informacionit të shpallur në tabelën e punimeve, por puna ishte ende në fazën fillestare.

Në tabelë shfaqen të dhëna për investitorin, zbatuesit e projektit dhe vlerën prej 283.150.000 lekë, por mungon afati i punimeve, data e nisjes dhe përfundimit të tyre, edhe pse ky është një detyrim ligjor.

Gjatë verifikimit që bëmë në kantierin pranë rrugës "Hydajet Lezha", konstatuam se janë ngritur strukturat për 4 pallate, të cilat, sipas informacionit të tabelës së punimeve, duhet të kishin përfunduar

në maj 2021. Projekti, me financues qeverinë, zhvillues FSHZH-në dhe me vlerë 467,500.00 lekë mban si datë të nisjes së punimeve nëntorin 2020.

Ndërkohë, në lagjen "Skënderbeg" ka përfunduar ndërtimi i pallatit 88.

Në vitin 2020, **Komisioni Shtetëror i Rindërtimit miratoi Vendimin e Këshillit Bashkiak të Lezhës për** financimin e rikonstruksionit të objekteve të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, që rezultojnë me shkallë dëmtueshmërie DS1-DS3, që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime.

Sipas vendimit për 43 përfitues të klasifikuar me shkallë dëmtimi DS1 do të lëvrohet fondi me vlerë 4,3 milionë lekë; për 53 përfitues të klasifikuar me shkallë dëmtimi DS2 vlera e fondit do të jetë 13,2 milionë lekë; për 111 përfitues të klasifikuar me shkallë dëmtimi DS3 vlera e fondit do të jetë 55,5 milionë lekë. Në vendim përcaktohet se për qytetin e Lezhës do të lëvrohet edhe fondi me vlerë 63 milionë lekë për ndërhyrjet në strukturë për pallatet me dëmtime, sipas shkallës DS4 dhe DS5.



Lagja "Skënderbeg", Pallati nr.88, Lezhë 14 shtator 2021

50. Të miratojë kërkesën për financim të Bashkisë Lezhë, për kryerjen e punimeve për rirforcimin e 7 (shtatë) njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore, me shkallë dëmtueshmërie DS4 dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, sipas rekomandimeve të Akt ekspertizave të thelluara të hartuara nga Instituti i Ndërtimit dhe përcjellë pranë Komisionit Shtetëror për Rindërtim, me shkresën Nr. 13751 prot., datë 21.07.2021, në masën prej 136 176 129.63 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzet e nëntë pikë gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

B.3.3. Vonesa shembjes së pallateve në Krujë, po pengon rindërtimin

Publikuar më 13.11.2021 në faktoje.al

Në janar 2021 duhej të niste shembja e pallateve të dëmtuara rëndë nga tërmeti, çka do t'i hapte rrugë rindërtimit të pallateve në sitin e katërt në bashkinë Krujë. Ky ishte premtimi i dhënë nga kryebashkiaku, Artur Bushi gjatë një interviste për ATSH në ditët e

para të janarit 2021. Faktoje verifikoi së në muajin tetor 2021, kishte ende pallate që nuk ishin shembur dhe se vendosja e sitit të katërt të rindërtimit, ende është e paqartë.

Faktoje i dërgoi një kërkesë për informacion bashkisë Krujë ku mes të tjerash pyeti nëse kishte nisur procesi i ndërtimit në sitin e katërt.

Bashkia Krujë, dërgoi si përgjigje një link nga Agjencia e Planifikimit të Territorit.



Pamje nga brenda të pallateve të dëmtuara nga tërmeti dhe të braktisura nga banorët, Krujë, shtator 2021

KËRKESË PËR INFORMACION



Emër Mbiemër: Znj. Inva Hasanaliaj	Adresa postare: Rr. "Nasi Pavlo", Pall. "Edil- Al", shk.1, kati 3, A-8, Tirana 1001 Adresa elektronike: invahasanaliaj@faktoje.al Nr. Tel:	Data: 17/08/2021 Nënskrimi:
---	---	--

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

- 1) Vendodhja e sitit të katër të Bashkisë Krujë ku do të nisë rindërtimi i pallateve
- 2) A ka nisur procesi i rindërtimit në këtë zonë?
- 3) Kopje të dokumentave të tenderit të hapur
- 4) Sa është vlera totale e projektit?
- 5) Në çfarë faze është projekti?
- 6) A furnizohen sot banorët Fushë Krujë me ujë 24 orë?
- 7) Sa godina arsimore janë ndërtuar/rindërtuar/rikonstruktuar në bashkinë Krujë nga janari deri në muajin korrik 2021?

Kërkesa për informacion dërguar bashkisë Krujë, datë 17.08.2021

1) Siti i katërt i rindërtimit është në territorin e qytetit Krujë, mund ta gjeni në faqjen e AKTP dhe faqjen zyrtare të Bashkisë Krujë. <http://planifikimi.gov.al/index.php?id=1024>. Projekti përfshin rindërtimin e pallateve të dëmtuara nga tërmeti në dy lote, (Derede dhe Vrana Konti)

2) Procesi i rindërtimit deri në këtë moment: janë realizuar (akt-konstatimet e dëmeve të tërmetit, analizat e thelluara inxhinjerike, caktimi i sitit të ndërtimit, demolimi i pallateve) Aktualisht, **jemi në fazën e shpronësimeve të pallateve të cilat do të prishen për interes publik,** e cila realizohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit).

Përgjigjja e bashkisë Krujë për Faktoje, shtator 2021

Linku i faqes zyrtare të AKTP (Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit) ofron informacion mbi projektet dhe skemat e shpërndarjes së apartamenteve dhe banesave në të gjithë territorin e bashkisë së Krujës, por nuk ka informacion specifik për shtet të katërt, sikurse ishte kërkuar specifikisht në kërkesën dërguar Bashkisë Krujë.

Bashkia Krujë informon vetëm për vlerën e projektit për shtet të katërt, që llogaritet në 210.000.000 lekë, ndërsa thekson se aktualisht është në fazën

e shpronësimeve të pallateve, të cilat do të prishen për interes publik.

Edhe nga një kërkim në faqen zyrtare të bashkisë së Krujës, nuk jepet informacion se cila është vendndodhja e sitit të katërt.

Nga një verifikim i Faktoje në terren në shtator 2021, konstatuam se në lagjen Derede, kishte ende dy pallate të pashembur. Banorët e kësaj zone të pyetur nga Faktoje refuzonin të jepnin informacion në mënyrë kategorike.

AKPT
 AGJENCIA KOMBËTARE E
 PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

SQ EN NË PYESNI KONTAKT SAQ PUBLIKIME BIBLIOTEKA HART

e Harte Në Proje **Krujë**

LLOJË TË SHPËTIA

Paceli (Nëqillobam Kombe)

PINS Bregdeti

PINS Trans-Durres

Drejtësi 10020

Rishikimi PDyV

në fuqi

miratuar: 29.09.2020

[Vendim nr.199 dt.29.09.2020 "Për miratimin e Rishikimit të PDyV për zonën e re që shtrihet zona 1 bashkia Krujë"](#)

1.Bazanti i Rishikimit të Përshirjes Detajuar Vendor për Zonën e Re në Zhvillim Zona 1 Krujë

[2.Harta e qendrimit të tokës Zona 1 Krujë](#)

[3.Harta e projektit urban Zona 1 Krujë](#)

[4.Harta e infrastrukturës së Transportit dhe Rrethit Imbrihorik Zona 1 Krujë-1](#)

[5.Harta e infrastrukturës së Transportit dhe Rrethit Imbrihorik Zona 1 Krujë-2](#)

6.Skema e apartamenteve dhe Banesave kolektive Zona 1 Krujë-1

[7.Skema e apartamenteve dhe Banesave kolektive Zona 1 Krujë-2](#)

miratuar: 27.03.2020

[Vendim nr.58 dt.27.03.2020 "Vendim për miratimin e PDyV për Zonën e Re të Zhvillimit 1 Njësia Administrative Krujë Bashkia Krujë"](#)

1.Bazanti i Planit të Detajuar Vendor për Zonën e Re që Zhvillim Zona 1 Krujë

2.Harta e përcaktimit të tokës Zona 1 Krujë

3.Harta e projektit urban Zona 1 Krujë

4.Harta e infrastrukturës së Transportit dhe Rrethit Imbrihorik Zona 1 Krujë-1

5.Harta e infrastrukturës së Transportit dhe Rrethit Imbrihorik Zona 1 Krujë-2

[6.Skema e apartamenteve dhe Banesave kolektive Zona 1 Krujë-1](#)

[7.Skema e apartamenteve dhe Banesave kolektive Zona 1 Krujë-2](#)

8.Skema e apartamenteve dhe Banesave kolektive Zona 1 Krujë-3

[9.Skema e apartamenteve dhe Banesave kolektive Zona 1 Krujë-4](#)

10.Skema e apartamenteve dhe Banesave kolektive Zona 1 Krujë-5

[11.Skema e apartamenteve dhe Banesave kolektive Zona 1 Krujë-6](#)

[12.Skema e apartamenteve dhe Banesave kolektive Zona 1 Krujë-7](#)



Lagja "Derede", Pallati nr.1, Krujë shtator 2021




Lagja "Derede", Pallati nr.2, Krujë, shtator 2021

Në njërin prej pallateve në këtë lagje qëndronte ende njoftimi se 28 shkurti 2021, ishte afati i fundit për boshatisjen e objektit i cili do shembet.

Nga vëzhgimi, rezultoi se mungonte rrethimi i perimetrit të sigurisë duke u kthyer në rrezik potencial për personat që mund të hynin në gërmadhat e pallatit.

Në gjithë bashkinë Krujë, sipas vetë institucionit rezultoi se janë shembur 27 pallate gjithsej, ndërsa 15 janë për rindërtim, por në asnjë rast nuk specifikohen zonat ku do të rindërtohen këto pallate.

Nga kërkimet e Faktoje dhe verifikimi në terren, premtimi i kreut të Bashkisë Krujë, Artur Bushi se në janar 2021, do të niste demolin e pallateve në Krujë dhe hapja e kantierit të ndërtimeve në sitin e katërt, rezultoi i pambajtur.



*Njoftimi nga bashkia Krujë në pallatin e planifikuar për shembje, shtator 2021

Përshëndetje,

Në vijim të kërkesës për informacion, mbi pallatet që janë në proces të rindërtimit.

1) Pallate të demoluara, janë 18 në NJA Thumane, 2 në NJA Bubq, 12 në NJA Fushë Krujë dhe 27 në NJA Krujë. Në total janë 59 pallate të demoluara.

2) Procesi i vleresimit është mbyllur, janë vetëm rastet në ankimin gjyqësor, 1 në Krujë dhe 1 në Fushë Krujë.

3) Për rindërtim janë, NJA Thumane 14 pallate, NJA Krujë 21 pallate, Bubq 7 pallate, NJA Fushë Krujë 15 pallate, pra 57 pallate në total.

Ju faleminderit,

Drini Masha

Zyra e Informacionit dhe Turizmit

Bashkia Krujë

sheshi "Skenderbej" Krujë

*Përgjigjja e Bashkisë Krujë për Faktoje.al, 4 gusht 2021

B.4. OBJEKTET ARSIMORE

B.4.1. FINANCIMI I OBJEKTEVE ARSIMORE

B.4.1.1 Bashkia Tiranë

Objektet Arsimore të Financuara nga VKM nr. 212

Me VKM Nr. 212, datë 11.03.2020, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore", Bashkisë Tiranë iu alokua një vlerë totale prej 3.63 miliardë lekë (ose rreth 30 milionë euro) për rindërtimin e objekteve arsimore, dhe FSHZH-së një vlerë prej 4.35 miliardë lekë (ose rreth 36 milionë euro). Gjatë viteve fondet e alokuara në total me VKM 212 janë ndryshuar dy herë sipas

VKM-ve të paraqitura në tabelën më poshtë. Fondi total për FSHZH-në nuk ka ndryshuar. Ndërsa fondi total i alokuar Bashkisë Tiranë është rritur me 2.48 miliardë lekë (ose rreth 20 milionë euro) duke kapur një vlerë totale prej 6.11 miliardë lekë (ose rreth 50 milionë euro) për rindërtimin e objekteve arsimore në këtë njësi zbatuese.

Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të botuara në OpenProcurement.AL, rezulton se me fondet e alokuara me VKM 212, të ndryshuara, do të financohej rindërtimi i 22 objekteve arsimore në Bashkinë Tiranë, mbikqyrja e punimeve të tyre dhe mobilimi. Më poshtë paraqitet lista e objekteve arsimore të financuara nga VKM 212, e ndryshuar.

Në këto objekte arsimore, përfshihet dhe Godina nr. 22 në Bulevardin Zogu i Parë, e cila nuk ka

VKM Nr.	Data	FSHZH	Shtesa FSHZH	Bashkia Tirane	Shtesa BT	Totali VKM	Ndryshimi Total
212	11.03.2020	4,347,753,223	N/A	3,630,381,708	N/A	7,978,134,931	N/A
631	29.07.2020	4,347,753,223	-	5,184,188,593	1,553,806,885	9,531,941,816	1,553,806,885
612	20.10.2021	4,347,753,223	-	6,111,730,973	927,542,380	10,459,484,196	927,542,380

Rindertimi i 14 objekteve Arsimore Tirane
<i>Ndërtimi i godinës Qendra Sociale "Të Qëndrojmë së Bashku", Kombinat</i>
<i>Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.2 (Nr.3)</i>
<i>Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.2 (Nr.4)</i>
<i>Ndërtimi i godinës "Godina nr.22, blv. Zogu I (7-katëshi</i>
<i>Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.1)</i>
<i>Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.2)</i>
<i>Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.3)</i>
<i>Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.4)</i>
<i>Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.5)</i>
<i>Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.6)</i>
<i>Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.7)</i>
<i>Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.8)</i>
<i>"Ndërtimi i shkollës "Sami Frashëri"</i>
<i>"Ndërtimi i kopshtit "Fikas"</i>
Rindertimi i 8 (tetë) objekteve Arsimore në Bashkinë e Tiranës
<i>Ndërtim i Shkollës 9- Vjeçare 17-Shkurti Qesarakë E Vjetër</i>
<i>Ndërtim i Shkollës 9- Vjeçare " Hasan Vogli"</i>
<i>Ndërtim i Shkollës 9- Vjeçare " Mangull"</i>
<i>Ndërtim Kopshti Gurre</i>
<i>Ndërtim i Shkollës 9- Vjeçare "Murat Toptani"</i>
<i>Ndërtim i Shkollës 9- Vjeçare " Pajan"</i>
<i>Ndërtim i Shkollës 9- Vjeçare " Pezë e Vogël"</i>
<i>Ndërtim i Shkollës 9- Vjeçare " Qazim Turdiu"</i>

qenë objekt arsimor. Nga analiza e Dokumentave Standarde të Tenderave, rezulton se për këto objekte arsimore janë nënshkruar 5 marrëveshje kuadër, për rindërtimin, mbikqyrjen e punimeve dhe mobilimin e tyre. Më poshtë paraqiten në formë tabelore këto marrëveshje.

Ajo që vihet re është se vlera totale fondit limit të marrëveshjeve të lidhura është afërsisht 6 miliardë lekë. Ndërkohë deri në datën e fundit kur këto

marrëveshje kanë hyrë në fuqi, vlera e alokuar me VKM për Bashkinë Tiranë ka qenë 5.18 miliardë lekë. Pra Bashkia në Tiranë ka hyrë në marrëveshje kuadër për një vlerë rreth 810 milionë lekë (ose rreth 6.64 milionë euro) në tejkalim të fondeve të alokuara në atë moment. Siç shihet, vetëm në 20 tetor 2021, ndonëse këto marrëveshje ishin lidhur pa patur plotësisht fondet në dispozicion, qeveria me VKM nr. 612 i ka shtuar fondet Bashkisë Tiranë duke e çuar vlerën totale të alokuar në 6.1 miliardë lekë.

Burimi i Financimit	Data e Zhvillimit	Objekti Marrëveshjes Kuader	Fondi Limit
VKM 212, ndryshuar	10.08.2020	Rindertimi i 8 (tetë) objekteve Arsimore në Bashkinë e Tiranës	1,308,064,646
VKM 212, ndryshuar	31.08.2020	Rindertimi i 14 objekteve Arsimore Tirane	3,711,884,202
VKM 212, ndryshuar	10.08.2020	Mbikqyrja e punimeve per Rindertimin e 8 (tetë) objekteve arsimore në Bashkinë e Tiranës	12,728,533
VKM 212, ndryshuar	31.08.2020	Mbikqyrja e punimeve per: Rindertimin i 14 (katërmbdhjete) objekteve Arsimore ne Bashkinë e Tiranës	34,524,353
VKM 212, ndryshuar	03.06.2021	Mobilimi me paisje dhe orendi i objekteve arsimore të dëmtuara nga tërmeti	927,542,378
TOTALI			5,994,744,112

Burimi i Financimit	Data e Zhvillimit	Objekti Marrëveshjes Kuader	Fondi Limit	Vlera e Kontraktuar
VKM 212, ndryshuar	10.08.2020	Rindërtimi i 8 (tetë) objekteve Arsimore në Bashkinë e Tiranës	1,308,064,646	1,293,052,896
VKM 212, ndryshuar	31.08.2020	Rindërtimi i 14 objekteve Arsimore Tirane	3,711,884,202	3,697,602,351
VKM 212, ndryshuar	10.08.2020	Mbikqyrja e punimeve per Rindërtimin e 8 (tetë) objekteve arsimore në Bashkinë e Tiranës	12,728,533	10,142,141
VKM 212, ndryshuar	31.08.2020	Mbikqyrja e punimeve per: Rindërtimin i 14 (katërmbëdhjetë) objekteve Arsimore ne Bashkinë e Tiranës	34,524,353	32,644,764
VKM 212, ndryshuar	03.06.2021	Mobilimi me paisje dhe orendi i objekteve arsimore të dëmtuara nga tërmeti	927,542,378	171,479,025
TOTALI			5,994,744,112	5,204,921,177

Legjislacioni në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor nuk lejon marrjen e angazhimeve financiare (kontratave) në tejkalim të fondeve të alokuara në momentin e firmosjes së tyre. Për më tepër ky legjislacion kërkon që kontratat të regjistrohen në sistemin e thesarit brenda 5 ditëve nga data e firmosjes së tyre. Moszbatimi i dispozitave ligjore, ka dhe masat përkatëse administrative që duhen marrë.

Nëse i referohemi kontratave specifike të nënshkuara në zbatim të marrëveshjeve kuadër publikuar nga OpenProcurement.al do të shohim se vlera e firmosur për objektet në zbatim të marrëveshjeve kuadër është lehtësisht mbi fondin e alokuar prej 5.184 miliardë lekë me VKM 212, të ndryshuar, në atë kohë.

Ndërkohë që kontratat e rindërtimit dhe mbikqyrjes së 22 objekteve janë firmosur, rezulton se janë

firmosur kontrata mobilimi për 12 objekte arsimore dhe ende nuk ka kontrata sidomos për mobilimin e rezidencave studentore (konvikteve). Procesi rindërtimit të tyre vijon siç është trajtuar në artikujt e mëparshëm të Faktoje. Kjo shpjegon edhe vlerën e ulët të kontratave të firmosura në krahasim me fondin limit për marrëveshjen kuadër për "Mobilimin me paisje dhe orendi të objekteve arsimore të dëmtuara nga tërmeti". Rritja e fondit nga Qeveria me VKM-në e datës 20 tetor 2021 i hap rrugën fondeve edhe për këto mobilime nëse janë të përshtatshme dhe të arsyeshme.

Siç mund të shohim, kontratat e rindërtimit dhe mbikqyrjes janë firmosur për të 22 objektet arsimore. Ndërkohë janë krijuar premiset edhe për financimin e realizimit të kontratave për mobilimin e tyre.

Objekti Tenderit	Rindërtimi			Mbikqyrja		
	Fondi Limit	Vlera e Kontrates	Efienca	Fondi Limit	Vlera e Kontrates	Efienca
Rindërtimi i 14 objekteve Arsimore Tirane	3,711,884,202	3,697,602,351	99.62%	34,524,353	32,644,764	94.56%
Ndërtimi i godinës Qendra Sociale "Të Qëndrojmë së Bashku", Kombinat		129,297,155			1,071,180	
Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.2 (Nr.3)		193,399,999			1,496,585	
Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.2 (Nr.4)		195,294,562			1,870,000	
Ndërtimi i godinës "Godina nr. 22, blv. Zogu I (7-katëshi		143,814,171			1,163,625	
Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.1)		305,946,636			2,569,108	
Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.2)		305,996,838			2,750,842	
Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.3)		306,499,751			2,766,160	
Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.4)		306,626,622			2,830,000	
Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.5)		305,798,306			2,823,193	
Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.6)		306,667,237			2,720,000	
Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.7)		305,615,961			2,766,260	
Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.8)		305,330,900			2,830,000	
"Ndërtimi i shkollës "Sami Frashëri"		567,492,069			4,769,609	
"Ndërtimi i kopshtit "Fikas"		19,822,144			218,202	
Rindërtimi i 8 (tetë) objekteve Arsimore në Bashkinë e Tiranës	1,308,064,646	1,293,052,896	98.85%	12,728,533	10,142,141	79.68%
Ndërtim i Shkollës 9- Vjeçare 17-Shkurti Qesarakë E Vjetër		191,167,917			1,488,380	
Ndërtim i Shkollës 9- Vjeçare " Hasan Vogli"		253,492,727			1,917,024	
Ndërtim i Shkollës 9- Vjeçare " Mangull"		101,800,000			838,584	
Ndërtim Kopshti Gurre		30,760,000			325,462	
Ndërtim i Shkollës 9- Vjeçare "Murat Toptani"		180,549,814			1,403,417	
Ndërtim i Shkollës 9- Vjeçare " Pajan"		62,500,000			573,197	
Ndërtim i Shkollës 9- Vjeçare "Pezë e Vogël"		110,068,839			914,101	
Ndërtim i Shkollës 9- Vjeçare " Qazim Turdiu"		362,713,599			2,681,976	

Më poshtë paraqitet efienca e konkurrencës për secilin grup kontratash për rindërtim dhe mbikqyrje punimesh, si dhe vlerat përkatëse të kontraktura për secilin nga 22 objektet arsimore. Kontratat e firmosura për rindërtim dhe mbikqyrje të objekteve arsimore kanë rezultuar në një vlerë sa 99.3% e fondit limit.

Ndonëse 5 marrëveshjet kuadër janë firmosur me disa operatorë ekonomikë, të cilët më pas do të konkurronin për kontratat e objekteve arsimore brenda çdo kontrate, ajo që vihet re është se vlera e kontratave faktike të finalizuara me operatorët fitues është shumë afër fondit limit të përcaktuar për to.

Objektet Arsimore të Financuara nga VKM nr. 1134

Qeveria Shqiptare me VKM nr. 1134, datë 24.12.2020, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, në bashkinë Tiranë dhe caktimin e bashkisë Tiranë si njësi zbatuese" i caktoi bashkisë Tiranë një fond prej rreth 1.61 miliardë lekë (ose rreth 13.2 milionë euro) për rindërtimin e disa rezidencave studentore (konvikte) dhe një shkolle. Në këtë VKM lista e objekteve arsimore të financuara dhe vlera për secilin prej tyre janë të listuara dhe detajuara shprehimisht si më poshtë.

Objekti	Vlera VKM
RSU Nr.1 (Nr. 15)	313,436,038
RSU Nr.1 (Nr. 16)	311,425,288
RSU Nr.1 (Nr. 18)	311,425,288
RSU Nr.1 (Nr 20-21 dhe 22-23)	456,772,100
Shkolla 9 Vjecare "Dritas"	215,496,468
TOTALI	1,608,555,182

Nga të dhënat e publikuara në Openprocurement.al dhe buletinët e APP, rezulton se bashkia Tiranë në mars 2021 ka zhvilluar 4 tendera të kufizuar për lidhje të marrëveshjes kuadër, të cilët financohen pikërisht nga VKM nr. 1134.

Nga krahasimi i 4 procedurave të shpallura më lart me VKM 1134 vëmë re:

- 1 Vlera e fondit të këtyre 4 kontratave në total është në tejkallim të fondit të alokuar me VKM për një vlerë rreth 150 milionë lekë, ose rreth 1.23 milionë dollarë.
- 2 Fondi për marrëveshjen kuadër të rindërtimit të 3 godinave rezidenciale studentore dhe pjesa përkatëse e mbikqyrjes së punimeve është brenda fondit të miratuar me VKM për rindërtimin e RSU 15, 16 dhe 18 nga Qeveria.
- 3 Fondi për marrëveshjen kuadër të rikonstruksionit të godinave rezidenciale studentore Nr.20-21; Nr. 22-23, në RSU Nr.1 dhe pjesa përkatëse e mbikqyrjes së punimeve është brenda fondit të miratuar me VKM për rindërtimin e këtyre objekteve.
- 4 Fondi për marrëveshjen kuadër, rindërtimi 2 objekteve arsimore në bashkinë Tiranë është në tejkallim të fondit të miratuar në VKM për ndërtimin e shkollës 9 vjeçare "Dritas".
- 5 Kur Qeveria ka alokuar fond për ndërtimin e një shkolle specifike në këtë VKM, bashkia Tiranë ka lidhur marrëveshje për 2 objekte ose një në tejkallim të VKM-së.

Data e njoftimit	Objekti i kontratës	Fondi	Burimi i Financimit sipas DST
01.03.2021	Rindërtimi i 3 (tre) godinave të Rezidencave Studentore Universitare (RSU) në Bashkinë Tiranë	926,511,984	VKM Nr.1134, datë 24.12.2020 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, në Bashkinë Tiranë dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si Njësi Zbatuese"
05.03.2021	Rikonstruksioni i godinave Nr.20-21; Nr. 22-23, në RSU Nr.1	452,657,841	
02.03.2021	Rindërtimi i 2 (dy) objekteve arsimore në Bashkinë Tiranë	363,664,802	
08.03.2021	Mbikqyrja e punimeve për objektet "Rindërtim dhe rikonstruksion i infrastrukturës Arsimore, në Bashkinë Tiranë"	15,751,585	
	TOTALI	1,758,586,212	

BASHKIA TIRANË
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Bashkimi i Operatoreve Ekonomik "C O L O M B O" FIER Lagjia Kryengritja e Fierit, Rr: Vangjel Rrushku, godina nr.67 J82916489E & "XHENGU" Korce KORCE, DON: GJON, BUZUKU, L.5 J64103171M & "ERGI" Autostrada Elbasan-Metallurgji km.3, - numri i pasurisë 328/6-NDI, zona kadastrale nr.8526, lagjia 28 Nentori, Rajoni nr.3, Elbasan, K02727229P

Procedura e prokurimit: "Ndërtimi i ri i shkollës në rrugën "Besim Daja".

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-8843-03-01-2021

Fondi limit për objektin "Ndërtimi i ri i shkollës në rrugën "Besim Daja", është 142,040,943.99 (njëqind e dyzet e dy milion e dyzet mijë e nëntëqind e dyzet e tre pikë nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Tender i Kufizuar" me Marrëveshje Kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit, e përzgjedhur në mbështetje të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Udhëzimit Nr. 1, datë 13.02.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik, pika 7.1; Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 31 dhe Neni 35/1 si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Kreu V, Neni 34 dhe Neni 41.

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar: Sipas short-listing të pasqyruar në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik "C O L O M B O" J82916489E & "XHENGU" J64103171M & "ERGI" K02727229P.
- Operatori Ekonomik "NDERTIM MONTIMI PATOS" J63229454K
- Operatori Ekonomik "R&T" J61901094G
- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik "STERKAJ" J68310708M & "V.A.S. KONSTRUKSION" L61322023P

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazën tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

Screenshot i njoftimit të fituesit për shkollën "Besim Daja" duke u lidhur me të njëjtën marrëveshje kuadër si shkolla "Dritas"

Marrja e angazhimeve dhe firmosja e kontratave në tejkalim të fondeve të miratura apo për objekte për të cilat nuk janë alokuar fonde nga buxheti, është e ndaluar nga Ligji për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor dhe në këto raste duhet të aplikohen masa përkatëse për titullarët e këtyre autoriteteve kontraktore. Ky ligj parashikon ndër të tjera se *angazhimet e ndërmarrja nga njësitë shpenzuese jashtë fondeve të parashikuara në ligjin e buxhetit vjetor dhe në vendimin e Këshillit të Njësive të Qeverisjes Vendore për buxhetin ose në kundërshtim me këtë akt ose akte të tjera ligjore, nuk përfshihen si pjesë e detyrimeve financiare të qeverisjes së përgjithshme. Kur nëpunësi autorizues i njësive të qeverisjes së përgjithshme merr përsipër angazhime jashtë fondeve të parashikuara në buxhet ose në kundërshtim me këtë akt apo akte të tjera ligjore, është përgjegjës për shlyerjen e detyrimit.*

Faktoje ka kërkuar në buletinët e APP. Në buletinën e posaçëm nr. 73 datë 12 maj 2021 rezulton se është botuar njoftimi i shpalljes së fituesve **si për shkollën "Dritas" dhe atë "Besim Daja" si pjesë e të njëjtës marrëveshje kuadër.** Të dyja kanë datë njoftimi 23.04.2021.

Në zbatim të marrëveshjeve kuadër të lartpërmendura, më poshtë paraqitet lista e objekteve arsimore për të cilat është lidhur kontratë dhe burimi financimit është VKM 1134, e ndryshuar.

Nga tabela shihet qartë se është lidhur kontratë duke përdorur si burim financimi "VKM 1134" për ndërtimin e shkollës "Besim Daja" në vlerë totale rreth 140 milionë lekë ose 1.15 milionë euro, ndërkohë **kjo shkollë nuk është pjesë e VKM 1134 si objekt përfitues.** Për më tepër vlera totale e alokuar me VKM 1134 është 1.608 miliardë lekë, ndërkohë bashkia Tiranë ka lidhur kontrata në zbatim të kësaj VKM-je për një vlerë 1.69 miliardë lekë, **me një tejkalim të fondit të alokuar prej 82 milionë lekë ose rreth 670 mijë euro.**

Pra kemi të bëjmë me një angazhim të ndërmarrë pa qenë alokuar fondet buxhetore me VKM në momentin e marrjes së tij. Për më tepër ende sot VKM 1134 nuk është amenduar që të ketë përfshirë shkollën e re "Besim Daja" apo të ketë rritur vlerën e financimit. Një gjë e tillë s'do e zhbente dot çdo shkelje të mundshme, por do shërbente si legalizim i saj.

Në tabelën më lart paraqitet edhe efienca e konkurrencës për kontratë për rindërtim dhe mbikqyrje punimesh. Kontratat e firmosura për rindërtim dhe mbikqyrje të objekteve arsimore kanë rezultuar në një vlerë sa 98.8% e fondit limit. Ndonëse marrëveshjet kuadër janë firmosur me

Objekti	Vlera VKM 1134	Rikonstruksion			Mbikqyrja e Punimeve		
		Fondi Limit	Vlera Kontrates	Eficienca	Fondi Limit	Vlera Kontrates	Eficienca
RSU Nr.1 (Nr. 15)	313,436,038	308,155,467	305,100,339	99.0%	2,860,174	2,817,300	98.5%
RSU Nr.1 (Nr. 19)	311,425,288	308,155,467	304,149,447	98.7%	2,860,174	2,710,520	94.8%
RSU Nr.1 (Nr. 18)	311,425,288	308,155,467	305,684,203	99.2%	2,860,174	2,802,970	98.0%
RSU Nr.1 (Nr 20-21 dhe 22-23)	456,772,100	452,657,841	447,220,000	98.8%	3,374,692	3,369,000	99.8%
Shkolla 9 Vjecare "Dritas"	215,496,468	177,714,390	174,360,646	98.1%	1,756,615	1,700,000	96.8%
Shkolla "Besim Daja"	-	142,040,943	139,200,124	98.0%	1,432,956	1,400,000	97.7%
TOTALI	1,608,555,182	1,696,879,575	1,675,714,759	98.8%	15,144,785	14,799,790	97.7%

disa operatorë ekonomikë, të cilët më pas do të konkurronin për kontratat e objekteve arsimore, ajo që vihet re është se vlera e kontratave faktike të finalizuara me operatorët fitues është shumë afër fondit limit të përcaktuar për to.

Faktoje i ka kushtuar vëmendje rindërtimit të rezidencave studentore në Bashkinë e Tiranës. Si nga VKM 1134 dhe dokumentat e tenderit, konstatohet se Qeveria ka **parashikaur fillimisht shembjen dhe ndërtimin nga e para të tri rezidencave studentore RSU 15, 16, dhe 18** (shih seksionin më poshtë për gjendjen e godinës RSU 16). Faktoje konstatoi se deri në fund të tetorit 2021, ndryshe nga godinat 15 dhe 18, **nuk qe lidhur kontratë dhe as qe vazhduar me shembjen e RSU 16**, ndërkohë që aty banonin studentë. Faktoje dërgoi një kërkesë për informacion në Bashkinë Tiranë në lidhje me këtë çështje. Nga përgjigja e datës 9 Nëntor 2021, rezulton se 'Godinat Nr. 15, 18, **dhe 19** pësuan dëmtime serioze në strukturë dhe u vlerësuan të pabanueshme, dhe u vendos shembja e Godinave.

Sipas VKM 1134, objektet që përfituan nga fondi rindërtimit janë Godinat nr. 15, nr. 18, **dhe nr. 19.**"

Tek përgjigjja e bashkisë nuk përfshihet për rindërtim godina nr. 16 (e miratuar me VKM 1134), por RSU nr. 19. Duke qenë se kanë kaluar 10 muaj nga dalja e VKM 1134, është e paqartë se sa kohë iu desh Qeverisë dhe bashkisë Tiranë për të kuptuar gabimin në VKM. Rezulton se vetëm me VKM nr. 570, datë 6.10.2021, në VKM 1134 emërtimi "... TIP në RSU nr. 1 (nr. 16)...", zëvendësohet me "... TIP në RSU nr. 1 (nr. 19)...". **Ky ndryshim në VKM 1134 i hapi rrugë lidhjes së kontratës ([https://openprocurement.al/](https://openprocurement.al/tenders/kontrata/163757857844631%20l.k.pdf)**

tenders/kontrata/163757857844631%20l.k.pdf) për ndërtimin e RSU nr. 19 në datë 15 nëntor 2021.

Nga sa më lart, del që kontrata për ndërtimin e RSU nr. 19, u lidh vetëm pasi u ndryshua VKM-ja. Sepse kjo VKM përcaktonte dhe listonte objektet që do ndërtoheshin.

Për shkollën "Besim Daja" ky standard nuk është ndjekur, bazuar në dokumentacionin përkatës.

Objektet Arsimore të Financuara nga VKM nr. 307

Bashkia Tiranë ka financuar edhe ndërtimin e një shkolle të re "Bedri Llagami – Vaqarr" me anë të VKM nr. 307, datë 16.04.2020, të ndryshuar. Kjo shkollë parashikohej të përfundonte në fillim të vitit 2021. Më poshtë paraqiten të dhënat për këtë shkollë, ku vlera e kontratës është sa 99.9% e fondit limit.

B.4.1.2. Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Objektet Arsimore të Financuara nga VKM nr. 212

Me VKM Nr. 212, **datë 11.03.2020**, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore", FSHZH-së i alokohet një vlerë prej 4.35 miliardë lekë (ose rreth 36 milionë euro). Gjatë viteve, fondet e alokuara në total me VKM 212 janë ndryshuar dy herë, sipas VKM-ve të paraqitura në tabelën më poshtë. Fondi total për FSHZH nuk ka ndryshuar.

Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të botuara në OpenProcurement.AL, rezulton se me fondet e alokuara me VKM 212, do të financohej rindërtimi i

Objekti	Rikonstruksion		
	Fondi Limit	Vlera Kontrates	Efienca
Shkolla "Bedri Llagami-Vaqarr"	196,188,374	196,084,800	99.9%

VKM Nr.	Data	FSHZH	Shtesa FSHZH	Bashkia Tirane	Shtesa BT	Totali VKM	Ndryshimi Total
212	11.03.2020	4,347,753,223	N/A	3,630,381,708	N/A	7,978,134,931	N/A
631	29.07.2020	4,347,753,223	-	5,184,188,593	1,553,806,885	9,531,941,816	1,553,806,885
612	20.10.2021	4,347,753,223	-	6,111,730,973	927,542,380	10,459,484,196	927,542,380

FSHZH - MARREVESHJE KUADER	Fondi Limit Sipas Loteve
LOTI 1 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Kurbin dhe Lezhë	511,405,370
<i>Shkolla 9-vjecare Gjon Gjonaj</i>	
<i>Shkolla e mesme Arif Halil Sulaj</i>	
<i>Shkolla 9-vjecare Dan Bajrami</i>	
<i>Shkolla e mesme e bashkuar Llesh Nik Daka</i>	
<i>Shkolla 9-vjecare At Zef Pellumbi</i>	
LOT 2 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Krujë	490,413,615
<i>Shkolla 9-vjecare Larush Hajdar Hoxha</i>	
<i>Shkolla 9-vjecare Gjon Luka Luz</i>	
<i>Kopshti Varosh</i>	
<i>Shkolla 9-vjecare Mukje</i>	
<i>Shkolla e mesme e bashkuar Selman Daci</i>	
<i>Shkolla 9-vjecare dhe Kopshti Ramazan Jangozi</i>	
<i>Shkolla 9-vjecare dhe Kopshti Kastrioti Derven</i>	
LOT 3 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Durrës 1	845,723,696
<i>Shkolla 9-vjecare dhe Kopshti Bedrie Bebeziqi</i>	
<i>Kopshti Met Hasa</i>	
<i>Shkolla 9-vjecare Neim Babameto</i>	
<i>Shkolla 9-vjecare dhe Kopshti Qemal Mici</i>	
<i>Shkolla 9-vjecare Hasan Koci</i>	
LOT 4 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Durrës 2	850,692,969
<i>Shkolla 9-vjecare Shaqe Mazreku</i>	
<i>Shkolla 9-vjecare Vellezerit Haradinaj</i>	
<i>Shkolla e mesme e bashkuar Rexhep Mezini</i>	
<i>Shkolla 9-vjecare dhe Kopshti Adem Gjeli</i>	
<i>Shkolla 9-vjecare Xhelal Shtufi Shkafanaj</i>	
<i>Shkolla 9-vjecare Njazi Mastori 2+3</i>	
<i>Shkolla fillore dhe Kopshti Perlat</i>	
LOT 5 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Kavajë dhe Rrogozhinë	414,766,205
<i>Shkolla profesionale Charles Teleford Erikson</i>	
<i>Shkolla 9-vjecare Shtodher</i>	
<i>Shkolla profesionale 26 Marsi</i>	
<i>Konvikti Golem</i>	
<i>Shkolla 9-vjecare Gosë</i>	
<i>Shkolla fillore dhe Kopshti Vilë Bashtovë</i>	
LOT 6 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Kamëz	621,757,340
<i>Shkolla 9-vjecare Halit Coka</i>	
<i>Kopshti Niko Hoxha</i>	
<i>Shkolla e mesme Sulejman Elezi</i>	
<i>Kopshti Lidhja e Prizrenit, Paskuqan</i>	
<i>Kopshti Halit Coka</i>	
LOT 7 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Vorë e Shijak	440,458,658
<i>Shkolla 9-vjecare Ramazan Subashi</i>	
<i>Shkolla 9-vjecare Ahmetaq</i>	
<i>Kopshti Koder Berxulle</i>	
<i>Kopshti Marginet</i>	
<i>Shkolla 9-vjecare Lidhja e Prizrenit</i>	
<i>Shkolla e mesme Gjumnazi 16 Shatori</i>	
<i>Kopshti Nr. 1 Shijak</i>	
<i>Kopshti Mucaj</i>	
<i>Kopshti Vlashaj</i>	
<i>Shkolla e Mesme Kajo Karafili</i>	
TOTALI	4,175,217,853

Lista e objekteve arsimore të planifikuara për financim sipas VKM 212, e ndryshuar

Nr.	Bashkia	Niveli	Emertimi
1	Durres	9-vjecare + kopesht	Bedrie Bebeziqi
2	Durres	kopesht	Met Hasa
3	Durres	9-vjecare	Neim Babameto
4	Durres	9-vjecare + kopesht	Qemal Mici
5	Durres	9-vjecare	Hasan Koci
6	Durres	9-vjecare	Shaqe Mazreku
7	Durres	9-vjecare + kopesht	Adem Gjeli
8	Durres	9-vjecare	Xhelal Shtufi Shkafanaj
9	Durres	9-vjecare	Vellezerit Haradinaj
10	Durres	9-vjecare	Njazi Mastori 1+2+3
11	Durres	fillore + kopesht	Perlat
12	Kruje	e mesme e bashkuar	Selman Daci
13	Kruje	9-vjecare	Larush Hajdar Hoxha
14	Kruje	9-vjecare	Gjon Luka Luz
15	Kruje	9-vjecare + kopesht	Ramazan Jangozi
16	Kruje	9-vjecare + kopesht	Kastrioti Derven
17	Shijak	e mesme	Kajo Karafili
18	Shijak	9-vjecare	Lidhja e Prizrenit + Petrit Llaftiu
19	Shijak	e mesme	Gjimnazi 16 Shatori
20	Shijak	kopesht	Nr. 1
21	Kurbin	9-vjecare	Dan Bajrami
22	Kurbin	e mesme	Arif Halil Sulaj
23	Lezhe	e mesme e bashkuar	Llesh Nik Daka
24	Kamez	9-vjecare	9-Vjecare Halit Coka
25	Kamez	kopesht	Halit Coka
26	Kamez	kopesht	Lidhja e Prizrenit, Paskuqan
27	Kamez	kopesht	Kopesht Niko Hoxha
28	Kavaje	konvikt	Golem
29	Kavaje	9-vjecare	Shtodher
30	Kavaje	profesionale	26 Mars
31	Rrogozhinë	9-vjecare	Gosë
32	Vore	9-vjecare	Ahmetaq
33	Vore	kopesht	Koder Berxulle
34	Vore	9-vjecare	Ramazan Subashi
35	Vore	kopesht	Marqinet
36	Vore	kopesht	Mucaj
37	Kamez	9-vjecare	9-Vjecare Jashar Hoxha

Lista me objektet arsimore për rindërtim, dërguar nga FSHZH

45 objekteve arsimore në disa bashki të vendit si dhe mbikqyrja e punimeve të tyre. Më poshtë paraqitet lista e objekteve arsimore të planifikuara për financim nga VKM 212, e ndryshuar, me vlerë të alokuar 4.175 miliardë lekë për rindërtimin (pa mbikqyrjen) të ndarë në 7 Lote.

Nga analiza e të dhënave për realizimin e kontratave dhe minikonkurseve si pjesë e marrëveshjes kuadër të lidhur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit rezulton se si pjesë e kësaj kontrate është investuar në 37 objekte, nga 45 të planifikuara që do financonte VKM 212. FSHZH na dërgoi listën e objekteve arsimore për të

FSHZH - MARREVESHJE KUADER	
LOTI 1 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Kurbin dhe Lezhë	Shpjegim
Shkolla 9-vjecare Gjon Gjonaj	Transferuar me VKM 828, 12.10.2020 tek Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese. Vlera e alokuar me VKM - 199,602,139 Leke.
Shkolla 9-vjecare At Zef Pellumbi	Transferuar me VKM 1047, 16.12.2020 tek Bashkisë Lezhë si njësi zbatuese. Vlera e alokuar me VKM - 226,500,000 Leke.
LOT 2 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Krujë	
Kopshti Varosh	EU4Schools - Rindertim (vlera 44,646,703 Lek)
Shkolla 9-vjecare Mukje	Nuk del e ribuxhetuar a transferuar
LOT 4 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Durrës 2	
Shkolla e mesme e bashkuar Rexhep Mezini	Financuar me Grant nga Qeveria Gjermane
LOT 5 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Kavajë dhe Rrogozhinë	
Shkolla profesionale Charles Teleford Erikson	EU4Schools - Riparim (Vlera N/A)
Shkolla fillore dhe Kopshti Vilë Bashtovë	EU4Schools - Rindertim (Vlera N/A)
LOT 6 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Kamëz	
Shkolla e mesme Sulejman Elezi	Financuar me Grant nga Qeveria Gjermane
LOT 7 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Vorë e Shijak	
Kopshti Vlashaj	Nuk del e ribuxhetuar a transferuar

cilat ajo është njësi zbatuese dhe vlerat e kontratave për realizimin e tyre. Më poshtë paraqitet lista me objektet arsimore të dërguara nga FSHZH.

Nga analiza, rezulton se shkolla "Jashar Hoxha" nuk ka qenë pjesë e listës fillestare tek dokumentat standardë të tenderit. Ndërkohë nga lista në Dokumenta Standarde të Tenderit të paraqitur më lart mungojnë 9 objekte arsimore.

Faktoje kërkoi dhe mbledhi informacion mbi këto 9 objekte që nuk rezultojnë në listën e FSHZH.

Sipas analizës rezulton se nga këto 9 objekte: 2 janë transferuar për t'u zbatuar nga njësi të tjera dhe jo nga FSHZH, 3 janë për t'u financuar dhe zbatuar nga EU4Schools, 2 objekte për financim nga KfW Gjermane, dhe 2 objekte nuk përcaktohen ende se cilën kanë si njësi zbatimi.

Analiza kërkon të shihet si janë përdorur fondet me efikasitet operacional të alokuara me VKM 212. Është mëse e drejtë që kur një shkollë dhe fondet i kalojnë një njësie tjetër zbatuese, fondet në dispozicion të FSHZH duhet të ulen, siç ulet dhe numri i shkollave që po financon VKM 212. Po të shohim me vëmendje, fondi për rindërtimin e 45 objekteve fillestare ishte 4.175 miliardë lekë. Ndërkohë për realizimin e 36 objekteve (pa shkollën "Jashar Hoxha" që u shtua) janë shpenzuar 3.9 miliardë lekë. Pra numri

objekteve ka rënë me 9, ndërkohë fondet kanë rënë vetëm me 275 milionë lekë, ose aq sa ka kushtuar rindërtimi vetëm i shkollës 9-vjeçare dhe kopshtit "Qemal Mici".

Nëse i referohemi informacioneve të publikuara (Prokurime, EU4Schools, dhe Ministri Rindërtimi), minimalisht duhej që fondi total në dispozicion i FSHZH për 37 objekte të ulej me vlerën totale të rindërtimit të objekteve të transferuara ose financuara nga burime të tjera. Kjo çështje kërkon transparencë.

Nëse llogarisim që Granti Gjerman për 3 shkolla është 11 milionë euro dhe do të financojë dy nga shkollat që më parë kanë qenë pjesë e listës për financim nga VKM, atëherë kursimi që duhet t'i vinte buxhetit të shtetit është rreth 894 milionë lekë ose 7.3 milionë euro. Po kështu nëse dy objekte arsimore si shkollat 9 vjecare "Gjon Gjonaj" dhe "At Zef Pllumi" u transferuan me VKM tek të tjera njësi zbatuese, atëherë edhe vlera respektive e tyre, që në total është 424 milionë lekë ose rreth 3.5 milionë euro duhet të ishte kursyer nga FSHZH. E njëjta gjë mund të thuhet për fondet që do shkonin për rindërtimin e kopshtit "Varosh", që tashmë është pjesë e EU4Schools dhe objekteve të tjera, pjesë e këtij programi.

Më poshtë ndodhet tabela, ku duke përdorur të dhënat publike për 5 nga 9 shkollat që nuk janë më

KONTRATA OBJEKTET ARSIMORE						
1	2	3	4	5	6	7
Lot Nr.	Pershkrimi I Kontrates	Vlera e projektit te zbatimit dhe ndertimit (All)	Vlera e Mbiqyresit (All)	Vlera e kolaudit	Afati i realizimit (%)	Statusi
1	Rindërtimi i objektit të ri: shkollës së mesme "Arif Halil Sulaj"	120,092,000.00	1,190,017.00	435,848.00	98%	Ne përfundim sistemit e jashtme
2	Rindërtimi i objektit të ri: shkollës 9 - vjeçare "Dan Bajrami" & Mesme e bashkuar Llesh Nik Daka"	277,400,000.00	2,994,500.00		100%	Përfunduar
3	Rindërtimi i objektit të ri: 9 - vjeçare dhe Kopsht "Ramazan Jangozi" & Kopshti "Kastriot" Derveni	152,165,757.00	1,282,906.00	474,478.00	100%	Përfunduar
4	Rindërtimi i objektit të ri: Mesme e bashkuar "Selman Daci"	122,510,000.00	1,353,786.00		98%	Ne përfundim sistemit e jashtme
5	Rindërtimi i objekteve të reja: 9-vjeçare dhe parashkollor "Larushkë Hajdar Hoxha" dhe 9-vjeçare dhe kopshtit "Gjon Luka Luz" Bashkia Krujë	187,393,703.00	1,521,458.00		100%	Përfunduar
6	Rindërtimi i objektit të ri: shkollës 9 - vjeçare dhe Kopshti "Bedrie Bebeziqi" dhe Kopshti "Met Hasa"	125,743,421.00	1,101,315.00	747,267.00	100%	Përfunduar
7	Rindërtimi i objektit të ri: shkollës 9 - vjeçare "Hasan Koci"	185,927,669.42	1,514,409.00		100%	Përfunduar
8	Rindërtimi i objektit të ri: 9 vjeçare, "Neim Babameto"	224,500,000.00	1,833,873.00		100%	Përfunduar
9	Rindërtimi i objektit të ri: 9 - vjeçare "Qemal Mici"	281,400,000.00	2,131,950.00		100%	Përfunduar
10	Rindërtimi i objektit të ri: Shkolla 9-vjeçare "Njazi Mastori" dhe Shkolla fillore dhe Kopshti "Perlat"	249,999,999.00	2,207,984.00	680,582.00	100%	Përfunduar
11	Rindërtimi i objektit të ri: Shkollës 9 - vjeçare & Kopsht "Adem Gjeli", dhe 9 - vjeçare "Xhelal Shtufi Shkafanaj"	130,700,000.00	1,233,179.00		100%	Përfunduar
12	Rindërtimi i objektit të ri: 9 – vjeçare "Shaqe Mazreku", 9 – vjeçare dhe kopsht "Vëllezërit Haradinaj", Durrës	321,073,500.00	2,492,000.00		100%	Përfunduar
13	"Rindërtimi i objektit të ri: Shkolla 9-vjeçare "Gosë"	110,100,100.00	1,152,685.00	509,210.00	100%	Përfunduar
14	"Rindërtimi i objektit të ri: Shkolla 9-vjeçare "Shtodhër" dhe Profesionale "26 Marsi"	209,056,073.00	2,325,000.00		100%	Përfunduar
15	Rindërtimi i objektit të ri: Rezidentë studentore kolektive "Konvikt Golem" Kavaje	69,712,050.00	784,657.00		100%	Përfunduar
16	Rindërtimi i objektit të ri: 9-Vjeçare "Jashar Hoxha"	74,013,931.00	1,074,896.00		100%	Përfunduar
17	"Rindërtimi i objektit të ri: Kopshti "Niko Hoxha"	88,888,888.00	784,070.00	492,656.00	100%	Përfunduar
18	Rindërtimi i objektit të ri: Shkollës 9 - vjeçare "Halit Coka"	235,087,777.00	2,131,731.00		100%	Përfunduar
19	Rindërtimi i objektit të ri: Kopshti "Halit Coka" dhe Kopshti "Lidhja e Prizrenit", Kamëz,	200,000,000.00	1,645,241.00		100%	Përfunduar
20	Rindërtimi i objektit të ri: Shkollës 9-vjeçare "Ahmetaq" dhe shkollës 9-vjeçare "Ramazan Subashi"	145,636,977.00	1,349,143.80	614,164.00	100%	Përfunduar
21	"Rindërtimi i objektit të ri: Kopshti "Muçaj" & Kopshti "Nr. 1" & Mesme "16 Shtatori"	137,361,200.00	1,440,700.00		100%	Përfunduar
22	Rindërtimi i objektit të ri: Mesme e Bashkuar "Kajo Karafili", Shijak	123,500,562.00	1,313,298.00		100%	Përfunduar
23	Rindërtimi i objektit të ri: Kopshti "Kodër Bërxullë", Kopshti "Marqinet", 9 - vjeçare "Lidhja e Prizrenit" + "Petrit Llaftiu"	201,000,000.00	1,589,794.00		100%	Përfunduar
TOTALI		3,973,263,607.42	36,448,592.80	3,954,205.00	99.83%	

FSHZH - MARREVESHJE KUADER		
Objekti arsimor	Shpjegim	Vlera llogaritur e projektit
Shkolla 9-vjecare Gjon Gjonaj	Transferuar me VKM 828, 12.10.2020 tek Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese. Vlera e alokuar me VKM - 199,602,139 Leke.	199,602,139
Shkolla 9-vjecare At Zef Pellumbi	Transferuar me VKM 1047, 16.12.2020 tek Bashkisë Lezhë si njësi zbatuese. Vlera e alokuar me VKM - 226,500,000 Leke.	226,500,000
Kopshti Varosh	EU4Schools - Rindertim (vlera sipas EU - 44,646,703 Lek)	44,646,703
Shkolla 9-vjecare Mukje	Nuk del e ribuxhetuar a transferuar	
Shkolla e mesme e bashkuar Rexhep Mezi	Financuar me Grant nga Qeveria Gjermane (1/3 e grantit per 3 shkolla)	447,333,333
Shkolla profesionale Charles Teleford Erikson	EU4Schools - Riparim (Vlera N/A)	
Shkolla fillore dhe Kopshti Vilë Bashtovë	EU4Schools - Rindertim (Vlera N/A)	
Shkolla e mesme Sulejman Elezi	Financuar me Grant nga Qeveria Gjermane (1/3 e grantit per 3 shkolla)	447,333,333
Kopshti Vlashaj	Nuk del e ribuxhetuar a transferuar	
TOTALI I KURSIMIT TE LLOGARITUR		1,365,415,509

në listën e FSHZH, rezulton se duhet të ishin kursyer (si rezultat i uljes së numrit të objekteve arsimore) rreth 1.36 miliardë lekë ose rreth 11 milionë euro nga fondet e VKM 212. Ndërkohë janë kursyer vetëm 275 milionë lekë, me një diferencë rreth 10 milionë dollarë. Kjo çështje kërkon një investigim të mëtejshëm.

Për ta ilustruar, po paraqesim në vijim, në formë tabelore, vlerat e fondit limit sipas Dokumentave Standarde të Tenderit sipas secilit Lot dhe vlerat faktike të kontratave të firmosura për 37 objektet që kanë qenë pjesë e kontratës. Për 9 objektet arsimore, që nuk janë realizuar nga FSHZH, do të vendosim shifrat e tabelës së mësipërme. Për të parë kështu sa planifikohej të shpenzoheshin për 45 objekte dhe sa janë shpenzuar deri tani për to.

Nga tabela shohim që nëse vlera fillestare e alokuar për rindërtimin e 45 objekteve ka qenë 4.175 miliardë lekë, sot fatura faktike, pavarësisht financimit nga çdo burim (qoftë buxheti i shtetit apo grant i EU dhe Gjermanisë), është kapërcyer me rreth 10 milionë dollarë.

Objektet Arsimore dhe KLSH

Edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit në Raportin e Zbatimit të Buxhetit për përdorimin e fondeve të rindërtimit nga FSHZH për objektet arsimore ka bërë konstatime që konfirmojnë ato që kemi ilustruar më lart. Ndryshe nga ndërtimi i banesave dhe infrastrukturës publike

që janë buxhetuar në një projekt të vetëm investimi publik, rindërtimi i objekteve arsimore është detajuar në disa projekte të tilla, ku **KLSH identifikon sipas rajonit gjeografik dhe jo shkollës përkatëse**. Procesi i rindërtimit të objekteve arsimore nga buxheti i shtetit, me njësi zbatuese FSHZH është përcaktuar në VKM nr.212 datë 11.03.2020 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore", të ndryshuar, në të cilën është parashikuar kosto totale e investimit në shumën 4,348 milionë lekë, nga të cilat janë buxhetuar për vitin 2020 në shumën 4,126 milionë lekë, sipas VKM të përditësuar deri në 31.12.2020.

Në raportin për zbatimin e buxhetit analizohet secili prej këtyre projekteve që janë analog me Lotet në sa kemi trajtuar më lart. Në vijim citojmë pjesë nga ky raport.

Projekti 19AD203 "Rindërtimi i Objekteve Arsimore Qarku Lezhë (Bashkia Kurbin dhe Lezhë)"

Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 127.8 milionë lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 444.8 milionë lekë, lidhur 2 kontrata në shumën 397.4 milionë lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 309.7 milionë lekë.

Projekti 19AD204 "Rindërtimi i Objekteve Arsimore Qarku Krujë (Bashkia Krujë)"

Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 122.6 milionë lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 442.2 milionë lekë, lidhur 3 kontrata në shumën

FSHZH - MARREVESHJE KUADER	Fondi Limit Sipas Loteve	Vlera Kontrates	Diferenca
LOT 1 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Kurbin dhe Lezhë	511,405,370	823,594,139	312,188,769
Shkolla 9-vjecare Gjon Gjonaj		199,602,139	
Shkolla e mesme Arif Halil Sulaj		120,092,000	
Shkolla 9-vjecare Dan Bajrami		277,400,000	
Shkolla e mesme e bashkuar Llesh Nik Daka			
Shkolla 9-vjecare At Zef Pellumbi		226,500,000	
LOT 2 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Krujë	490,413,615	506,716,163	16,302,548
Shkolla 9-vjecare Larush Hajdar Hoxha		187,393,703	
Shkolla 9-vjecare Gjon Luka Luz			
Kopshti Varosh		44,646,703	
Shkolla 9-vjecare Mukje			
Shkolla e mesme e bashkuar Selman Daci		122,510,000	
Shkolla 9-vjecare dhe Kopshti Ramazan Jangozi		152,165,757	
Shkolla 9-vjecare dhe Kopshti Kastrioti Derven			
LOT 3 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Durrës 1	845,723,696	817,571,090	(28,152,606)
Shkolla 9-vjecare dhe Kopshti Bedrie Bebeziqi		125,743,421	
Kopshti Met Hasa			
Shkolla 9-vjecare Neim Babameto		224,500,000	
Shkolla 9-vjecare dhe Kopshti Qemal Mici		281,400,000	
Shkolla 9-vjecare Hasan Koci		185,927,669	
LOT 4 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Durrës 2	850,692,969	1,149,106,832	298,413,863
Shkolla 9-vjecare Shage Mazreku		321,073,500	
Shkolla 9-vjecare Vellezerit Haradinaj			
Shkolla e mesme e bashkuar Rexhep Mezini		447,333,333	
Shkolla 9-vjecare dhe Kopshti Adem Gjeli		130,700,000	
Shkolla 9-vjecare Xhelal Shtufi Shkafanaj			
Shkolla 9-vjecare Njazi Mastori 2+3		249,999,999	
Shkolla filllore dhe Kopshti Perlat			
LOT 5 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Kavajë dhe Rrogozhinë	414,766,205	388,868,223.00	(25,897,982)
Shkolla profesionale Charles Teleford Erikson			
Shkolla 9-vjecare Shtodher		209,056,073	
Shkolla profesionale 26 Marsi			
Konvikti Golem		69,712,050	
Shkolla 9-vjecare Gosë		110,100,100	
Shkolla filllore dhe Kopshti Vilë Bashtovë			
LOT 6 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Kamëz	621,757,340	971,309,998	349,552,658
Shkolla 9-vjecare Halit Coka		235,087,777	
Kopshti Niko Hoxha		88,888,888	
Shkolla e mesme Sulejman Elezi		447,333,333	
Kopshti Lidhja e Prizrenit, Paskuqan		200,000,000	
Kopshti Halit Coka			
LOT 7 - Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Vorë e Shijak	440,458,658	607,498,739	167,040,081
Shkolla 9-vjecare Ramazan Subashi		145,636,977	
Shkolla 9-vjecare Ahmetaq			
Kopshti Koder Berxulle		201,000,000	
Kopshti Marqinet			
Shkolla 9-vjecare Lidhja e Prizrenit			
Shkolla e mesme Gjinnazi 16 Shatori		137,361,200	
Kopshti Nr. 1 Shijak			
Kopshti Mucaj			
Kopshti Vlashaj			
Shkolla e Mesme Kajo Karafili		123,500,562	
TOTALI	4,175,217,853	5,264,665,184	1,089,447,331

462 milionë lekë, nga të cilat një kontratë me objekt rindërtim i objektit 1-2 kate të shkollës së mesme të bashkuar "Selman Daci" nuk është regjistruar fare në SIFO në shumën 122.5 milionë lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 215 milionë lekë.

Projekti 19AD205 "Rindërtimi i Objekteve Arsimore Qarku Durrës (Bashkia Durrës1)"

Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 211.4 milionë lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 845.7 milionë lekë, lidhur 4 kontrata në shumën 817.5 milionë lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 695 milionë lekë.

Projekti 19AD206 "Rindërtimi i Objekteve Arsimore Qarku Durrës (Bashkia Durrës2)"

Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 212.6 milionë lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 850.6 milionë lekë, lidhur 3 kontrata në shumën 701.7 milionë lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 631.5 milionë lekë.

Projekti 19AD207 "Rindërtimi i Objekteve Arsimore Qarku Tiranë (Bashkia Kavajë, Bashkia Rrogozhinë)"

Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 103.7 milionë lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 462.8 milionë lekë, lidhur 4 kontrata në shumën 462.8 milionë lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 367.8 milionë lekë.

Projekti 19AD208 "Rindërtimi i Objekteve Arsimore Qarku Tiranë (Bashkia Kamëz)"

Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 155.4 milionë lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 621.7 milionë lekë, lidhur 3 kontrata në shumën 524 milionë lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 471.5 milionë lekë.

Projekti 19AD209 "Rindërtimi i Objekteve Arsimore, Qarku Tiranë (Bashkia Vorë) Qarku Durrës, (Bashkia Shijak)"

Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 110.1 milionë lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën

507 milionë lekë, lidhur 4 kontrata në shumën 607.5 milionë lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 408 milionë lekë.

Në përfundim, KLSH konstaton se **"Detajimi i projekteve të investimit nuk është kryer sipas objektit të investimit në infrastrukturën arsimore përkatëse, por është kryer sipas grupimit në rajone gjeografike të rindërtimit të infrastrukturës arsimore. Përveç problematikave në lidhje me parimet e funksionimit të sistemit buxhetor, kjo praktikë krijon pamundësinë e ndjekjes së historikut të investimit në asetet publike."**

Mosdetajimi fondeve, sipas projekteve individuale, por sipas Loteve (rajoneve gjeografike) ka bërë që ndërkohë që numri i shkollave ulej në këto rajone, fondet qëndronin të hapura në nivel rajoni. Nëse do ishin detajuar në nivel objekti arsimor që në fillim, kjo situatë e trajtuar më lart do të parandalohet dhe investigohet.

B.4.2. Rindërtimi i shkollave nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Faktoje në datë 7 shtator 2021, i dërgoi një kërkesë për informacion Fondit Shqiptar të Zhvillimit ku kërkoj t'i vihej në dispozicion lista e objekteve arsimore për të cilat është përcaktuar FSHZH si njësi zbatuese. Në përgjigjen zyrtare, mësojmë se nga Fondi shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) për 2020-2021 parashikohen të ndërtohen 37 objekte arsimore.

Tabela jep të dhënat për ecurinë e procesit të rindërtimit të objekteve arsimore të raportuara nga FSHZH nga ku rezulton se gati 37 objekte arsimore janë të përfunduara. Ndërkohë në një krahasim mes listës së ardhur nga FSHZH dhe listës sipas dokumentave të tenderit ku janë përcaktuar objektet arsimore në 7 lote, rezultojnë 9 shkolla të cilat nuk janë të përfshira në përgjigjen e FSHZH për Faktoje.

Nëntë objekte arsimore, të cilat nuk figurojnë te lista e ardhur nga FSHZH

Në tabelën e FSHZH specifikohet se vlera e projektit të zbatimit dhe ndërtimit për këto 37 objekte arsimore është 3.973 miliardë lekë.

KONTRATA OBJEKTET ARSIMORE						
1	2	3	4	5	6	7
Lot Nr.	Pershkrimi I Kontrates	Vlera e projektit te zbatimit dhe ndertimit (All)	Vlera e Mbiqyresit (All)	Vlera e kolaudit (All)	Afati i realizimit (%)	Statusi
1	Rindërtimi i objektit të ri: shkollës së mesme "Arif Halil Sulaj"	120,092,000.00	1,190,017.00	435,848.00	98%	Ne përfundim sistemit e jashtme
2	Rindërtimi i objektit të ri: shkollës 9 - vjeçare "Dan Bajrami" & Mesme e bashkuar Llesh Nik Daka"	277,400,000.00	2,994,500.00		100%	Përfunduar
3	Rindërtimi i objektit të ri: 9 - vjeçare dhe Kopsht "Ramazan Jangozi" & Kopshti "Kastriot" Derveni	152,165,757.00	1,282,906.00	474,478.00	100%	Përfunduar
4	Rindërtimi i objektit të ri: Mesme e bashkuar "Selman Daci"	122,510,000.00	1,353,786.00		98%	Ne përfundim sistemit e jashtme
5	Rindërtimi i objekteve të reja: 9-vjeçare dhe parashkollor "Larushkë Hajdar Hoxha" dhe 9-vjeçare dhe kopshtit "Gjon Luka Luz" Bashkia Krujë	187,393,703.00	1,521,458.00		100%	Përfunduar
6	Rindërtimi i objektit të ri: shkollës 9 - vjeçare dhe Kopshti "Bedrie Bebeziqi" dhe Kopshti "Met Hasa"	125,743,421.00	1,101,315.00	747,267.00	100%	Përfunduar
7	Rindërtimi i objektit të ri: shkollës 9 - vjeçare "Hasan Koci"	185,927,669.42	1,514,409.00		100%	Përfunduar
8	Rindërtimi i objektit të ri: 9 vjeçare, "Neim Babameto"	224,500,000.00	1,833,873.00		100%	Përfunduar
9	Rindërtimi i objektit të ri: 9 - vjeçare "Qemal Mici"	281,400,000.00	2,131,950.00		100%	Përfunduar
10	Rindërtimi i objektit të ri: Shkolla 9-vjeçare "Njazi Mastori" dhe Shkolla fillore dhe Kopshti "Perlat"	249,999,999.00	2,207,984.00	680,582.00	100%	Përfunduar
11	Rindërtimi i objektit të ri: Shkollës 9 - vjeçare & Kopsht "Adem Gjeli", dhe 9 - vjeçare "Xhelal Shtufi Shkafanaj"	130,700,000.00	1,233,179.00		100%	Përfunduar
12	Rindërtimi i objektit të ri: 9 – vjeçare "Shaqe Mazreku", 9 – vjeçare dhe kopsht "Vëllezërit Haradinaj", Durrës	321,073,500.00	2,492,000.00		100%	Përfunduar
13	"Rindërtimi i objektit të ri: Shkolla 9-vjeçare "Gosë"	110,100,100.00	1,152,685.00	509,210.00	100%	Përfunduar
14	"Rindërtimi i objektit të ri: Shkolla 9-vjeçare "Shtodhër" dhe Profesionale "26 Marsi"	209,056,073.00	2,325,000.00		100%	Përfunduar
15	Rindërtimi i objektit të ri: Rezidentë studentore kolektive "Konvikt Golem" Kavaje	69,712,050.00	784,657.00		100%	Përfunduar
16	Rindërtimi i objektit të ri: 9-Vjeçare "Jashar Hoxha"	74,013,931.00	1,074,896.00		100%	Përfunduar
17	"Rindërtimi i objektit të ri: Kopshti "Niko Hoxha"	88,888,888.00	784,070.00	492,656.00	100%	Përfunduar
18	Rindërtimi i objektit të ri: Shkollës 9 - vjeçare "Halit Coka"	235,087,777.00	2,131,731.00		100%	Përfunduar
19	Rindërtimi i objektit të ri: Kopshti "Halit Coka" dhe Kopshti "Lidhja e Prizrenit", Kamëz,	200,000,000.00	1,645,241.00		100%	Përfunduar
20	Rindërtimi i objektit të ri: Shkollës 9-vjeçare "Ahmetaq" dhe shkollës 9-vjeçare "Ramazan Subashi"	145,636,977.00	1,349,143.80	614,164.00	100%	Përfunduar
21	"Rindërtimi i objektit të ri: Kopshti "Muçaj" & Kopshti "Nr. 1" & Mesme "16 Shtatori"	137,361,200.00	1,440,700.00		100%	Përfunduar
22	Rindërtimi i objektit të ri: Mesme e Bashkuar "Kajo Karafili", Shijak	123,500,562.00	1,313,298.00		100%	Përfunduar
23	Rindërtimi i objektit të ri: Kopshti "Kodër Bërxullë", Kopshti "Marqinet", 9 - vjeçare "Lidhja e Prizrenit" + "Petrit Llaftiu"	201,000,000.00	1,589,794.00		100%	Përfunduar
TOTALI		3,973,263,607.42	36,448,592.80	3,954,205.00	99.83%	

LOTI 1	Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Kurbin dhe Lezhë	511,405,370
	<i>Shkolla 9-vjeçare Gjon Gjonaj</i>	
	<i>Shkolla 9-vjeçare At Zef Pellumbi</i>	
LOTI 2	Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Krujë	490,413,615
	<i>Kopshti Varosh</i>	
	<i>Shkolla 9-vjeçare Mukje</i>	
LOTI 4	Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Durrës 2	850,692,969
	<i>Shkolla e mesme e bashkuar Rexhep Mezin</i>	
LOTI 5	Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Kavajë dhe Rrogozhin	414,766,205
	<i>Shkolla profesionale Charles Teleford Erikson</i>	
	<i>Shkolla fillore dhe Kopshti Vilë Bashtovë</i>	
LOTI 6	Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Kamëz	621,757,340
	<i>Shkolla e mesme Sulejman Elezi</i>	
LOTI 7	Rindërtimi i objekteve arsimore Bashkia Vorë e Shijak	440,458,658
	<i>Kopshti Vlashaj</i>	

Ndërsa fondi limit në dokumentat e tenderit kap vlerën 4.175 miliardë lekë.

Vlera e mbetur nga Fondi i alokuar për FSHZH është rreth 200 milion euro, ndërkohë 9 shkolla nuk figurojnë më në listë.

Faktoje verifikoi në terren se çfarë po ndodh në këto 9 shkolla të cilat nuk janë më në listën e FSHZH dhe evidentoi se një pjesë e tyre me VKM i kanë kaluar bashkive përkatëse, dy rezultojnë se do rindërtohen/ rikonstruktohen nga "EU4schools", ndërsa për një pjesë tjetër nuk gjenden të dhëna zyrtare.

Shkolla 9-vjeçare "Gjon Gjonaj", Kurbin

Shkolla 9-vjeçare "Gjon Gjonaj" në Kurbin rezulton të jetë një prej objekteve arsimore e klasifikuara për rindërtim pas tërmetit të 26 nëntorit 2019. Në marrëveshjen kuadër rezulton si njësi zbatuese Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Bashkia Kurbin dhe Lezhë janë të përfshira në lotin 1 të kësaj marrëveshjeje, ku i është alokuar fondi me vlerë 511,405,370 lekë pa TVSH. Ndërkohë Komisioni Shtetëror i Rindërtimit në vendimin nr. 53 datë 10.10.2020, cakton Bashkinë Kurbin si njësi zbatuese për rindërtimin e shkollës 9-vjeçare, duke i alokuar vlerën 199,602,139.60



Shkolla 9-vjeçare Gjon Gjonaj në Kurbin, 17 nëntor 2021



Foto 17 nëntor 2021, Shkolla 9-vjeçare Gjon Gjonaj, Kurbin

lekë. Nga verifikimi i tenderimeve rezulton se kontrata për rindërtimin e shkollës është lidhur në datë 19.02.2021 me vlerë 196,851,127 lekë pa TVSH, ndërsa kohëzgjatja e punimeve parashikohet 5 muaj.

Faktoje verifikoi në terren ecurinë e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare "Gjon Gjonaj" në mesin e muajit nëntor 2021.

Një punonjës i cili nuk pranoi të identifikohet tregoi për Faktoje se rindërtimi për këtë shkollë, me

kapacitet 420 nxënës kishte rreth, 1 muaj që kishte nisur. Sipas tij shkolla pritej të përfundonte në maj të vitit 2022.

Në këtë objekt arsimor nuk gjetëm asnjë tabelë punimesh, ndërkohë punonjësit me të cilët komunikuam në terren thanë se financimi i rindërtimit të këtij objekti po bëhet nga shteti shqiptar, pa specifikuar nëse njësi zbatuese është bashkia Kurbin apo FSHZH.



Shkolla 9-vjeçare "At Zef Pllumi", Shëngjin/Lezhë, 17 nëntor

Shkolla 9-vjeçare “At Zef Pllumi”, Shëngjin/Lezhë

Shkolla 9-vjeçare “At Zef Pllumi” figuron e përfshirë në lotin e 1 të marrëveshjes kuadër, me njësi zbatuese Fondin Shqiptar të Zhvillimit, por sipas vendimit nr. 1047 datë 16.12.2020, Këshilli i Ministrave ka caktuar Bashkinë Lezhë si njësi zbatuese për rindërtimin, duke i alokuar fondin 226,500,000 lekë pa TVSH.

Faktoje evidentoi në terren në mesin e muajit nëntor se rindërtimi i shkollës ka përfunduar në muajin tetor 2021, por banorë të zonës tregojnë se nxënësit vijnë në mësimin në një kopsht, i cili ndodhet pranë këtij objekti.

“Shkolla ka përfunduar nga mesi i tetorit, ndërkohë

kemi parë gjatë kësaj periudhe punëtorë, të cilët ende bëjnë disa rregullime të vogla. Mësimi s’ka nisur ende, pritet që të vijë kryeministri për inagurimin”- tregoi për Faktoje, një prind.

Nga verifikimi i tenderimeve rezultoi se kontrata me vlerë 220,376,980 lekë pa TVSH, për rindërtimin e shkollës është lidhur në datë 16.02.2021 lekë, ndërsa kohëzgjatja e saj ishte 6 muaj.

Kopshti Varosh- Krujë

Në marrëveshjen kuadër të procesit të rindërtimit, kopshti “Varosh” në Krujë rezultoi të jetë i përfshirë në lotin e dytë, me vlerë totale të objekteve arsimore

Skënderbeu	9-year school	Krujë	Krujë	Repair	101,457,651.67
Varosh	Kindergarten	Krujë	Krujë	Reconstruction	44,646,703.50
3 Dëshmorët	9-year school	Kavajë	Kavajë	Repair	
Charles Telford Erickson	Professional high school	Kavajë	Golem	Repair	
Fiqiri Kurti	Kindergarten	Kavajë	Kavajë	Repair	127,383,032.20

Notes	Construction company	Supervising company
Contract Amount: 44,646,703.50	JV “STE-LA 2000” Shpk & MODESTE Shpk	JV D&C Partners shpk & ER-NO shpk & E.F.B shpk

Sports facilities	N/A
No. of laboratories	0
Psychological/Medical room	Psychological room Medical room
Construction area	427 m ²

Screenshot “EU4school”, kopshti “Varosh”, Krujë, nëntor 2021




Tabela e punimeve, Kopshti Varosh, Krujë, nëntor 2021



Kopshti Varosh, Krujë, nëntor 2021

në këtë bashki 490,413,615 lekë pa TVSH, me njësi zbatuese Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Në Open Procurement figuron hapja e tenderimeve për disa objekte arsimore në bashkinë Krujë, ku rezulton i përfshirë edhe kopshti "Varosh".

Nëse verifikojmë kontratat e lidhura për këto objekte, nuk rezulton asnjë kontratë për kopshtin në fjalë, ndërkohë në vendimin nr. 56 datë 04.11.2020, Komisioni Shtetëror i Rindërtimit miraton listën e përditësuar të objekteve arsimore si pjesë të programit "EU4Schools", ku figuron të jetë përcaktuar për rikonstruksion edhe kopshti "Varosh" në Krujë.

Në faqen zyrtare të "EU4schools", eidentojmë kopshtin "Varosh", ku vlera e kontratës së rikonstruksionit paraqitet 44,646,703 lekë. Data e lidhjes së kontratës figuron 21.05.2021 ndërsa përfundimi i saj në 14.02.2022

Nga verifikimi në terren, pamë se tabela e punimeve specifikon si njësi zbatuese për projektin "EU4schools" dhe përfundimi i procesit të rindërtimit të objektit ishte data 28 tetor 2021.

Ndërsa afati i punimeve kishte përfunduar, kopshti "Varosh" është ende në proces rindërtimi.

Shkolla 9-vjeçare "Mukje", Krujë

Shkolla 9-vjeçare "Mukje", është një ndër objektet arsimore të përfshira në procesin e rindërtimit pas tërmetit të 26 nëntorit 2019. Sipas marrëveshjes kuadër, fondi i alokuar për këtë shkollë ka si njësi zbatuese FSHZH. Nga verifikimi figuron hapja e tenderimeve për disa objekte arsimore në bashkinë Krujë, ku rezulton e përfshirë edhe kjo shkollë. Nëse verifikojmë kontratat e lidhura për këto objekte, nuk rezulton asnjë kontratë për shkollën në fjalë.

Nga të dhënat e siguruar shkolla "Mukje", nuk del e ribuxhetuar, nuk dihet kur do nisë procesi i rindërtimit dhe kush është njësi zbatuese.

Prej dy vitesh, vetëm 4 prej nxënësve të shkollës së dëmtuar mësojnë në një banesë të përshatur



Shkolla 9-vjeçare "Mukje", e dëmtuar nga tërmeti, nëntor 2021



Banesë private në Mukje, ambienti i improvizuar si shkollë, Krujë, nëntor 2021

si shkollë. Pjesa tjetër ka zgjedhur të frekuentojë shkollën e fshatit Kurcenjë.

“Vajzën e dërgova në shkollën e fshatit që kemi afër Kurcenjë, jemi vërtetë në fshat po edhe ne duam të mësojnë një gjë. Kjo (tregon me gisht nga shtëpia e përshatur në shkollë) nuk është shkollë, një mësues është për të gjithë fëmijët”-thotë për Faktoje M.F prindi i një vajze që ecën më shumë se dy orë në ditë për vajtur dhe për t’u kthyer nga shkolla në fshatin Kurcenjë.

Shkolla e mesme e bashkuar “Rexhep Mezini”, Durrës

F.M, prindi i një prej fëmijëve të shkollës “Rexhep Mezini”, tregon për Faktoje se ka rreth 1 vit e gjysmë që shkolla është shembur dhe ende nuk janë njoftuar se kur do të nisë ndërtimi i saj.

“Shkolla pësoi dëmtime nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, rreth 5 muaj më pas erdhën dhe e shëmbën pasi dëmi ishte i gradës DS5. Pas shembjes, nuk kemi pasur asnjë informacion se kur do të rindërtohet, kemi



Vendi ku ka qenë shkolla e mesme e bashkuar “Rexhep Mezini”, Durrës, 5 nëntor 2021



Asnjë tabelë punimesh për shkollën "Rexhep Mezin", Durrës 5 nëntor 2021

dëgjuar që financimin e ka marrë përsipër një firmë gjermane"- tregon për Faktoje prindi i një nxënësi të kësaj shkolle.

Shkolla e mesme e bashkuar "Rexhep Mezin", është një prej objekteve arsimore të përfshira në procesin e rindërtimit, e cila sipas marrëveshjes kuadër ka si njësi zbatuese FSHZH. E përfshirë në Lotin 4, vlera totale e alokuar për 6 objekte arsimore (ndër to edhe shkolla "Rexhep Mezin"), është 850,692,969 lekë pa TVSH. Në Open Procurement evidentohet hapja e tenderit për rindërtimin e këtyre objekteve arsimore, por nuk figuron asnjë kontratë e lidhur. Shkolla "Rexhep Mezin", nuk figuron as në buletinën e posaçëm të njoftimeve nr. 64 datë 03.09.2020 ku janë të përfshira objektet e tjera arsimore të Lotit 4.

Komisioni Shtetëror i Rindërtimit në vendimin nr.17 datë 11.05.2020 miratoi financimin nga Qeveria Gjermane nëpërmjet KfW, për rindërtimin e tre objekteve arsimore, ndër to edhe shkolla "Rexhep Mezin". Fondi i vënë në dispozicion në formën e grantit nga Qeveria Gjermane për këtë program është në masën 11 (njëmbëdhjetë) milion euro dhe është caktuar Fondi Shqiptar i Zhvillimit, si njësi zbatuese për implementimin e këtij projekti në kuadër të procesit të rindërtimit.

Shkolla profesionale Charles Teleford Erikson- Kavajë

Shkolla profesionale "Charles Teleford Erikson" në Kavajë, është një tjetër objekt arsimor e cila ka pasur fillimisht si njësi zbatuese FSHZH. Nga verifikimi i tenderimeve kjo shkollë nuk rezulton të ketë kontratë të lidhur, ndërsa figuron t'i ketë kaluar "EU4schools". Faktoje evidentoi se "Charles Teleford Erikson" është pjesë e listës së shkollave të përfshira për rikonstruksion në programin EU4schools. Në këtë



Shkolla profesionale Charles Teleford Erikson Golem, Kavajë, datë 5.11.2021

Lidhur me Shkollën Profesionale “Charles Telford Erikson” deshironim një informacion se cili është subjekti rindërtimi në kuadër të dëmtimeve nga tërmeti i 2019

Në kuadër të programit të rindërtimit deshironim të ne vendosni në dispozicion informacionin:

-Po rindërtohet/rikonstruhet konvikti i shkollës Profesionale “Charles Telford Erikson”, apo shkolla Profesionale “Charles Telford Erikson”?

- Shkolla “Charles Telford Erikson” është përcaktuar për rikonstrukcion (dëmtime të lehta) dhe do investohet në ndërtimin e një palestare të re.
- Konvikti i shkollës “Charles Telford Erikson” është rindërtuar nga fillimi. Kanë përfunduar punimet për rindërtimin e godinës dhe jemi në procedurat e dorëzimit të objektit.

-Ju lutem na vendosni në dispozicion cila është njesia zbatuese?

- Shkolla “Charles Telford Erikson” ka njësi Zbatuese UNDP
- Konvikti i Shkollës “Charles Telford Erikson” ka Njësi Zbatuese Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

-Sa është vlera e alokuar dhe kur pritet të përfundojë?

- Konvikti i shkollës “Charles Telford Erikson” është rindërtuar nga fillimi. Kanë përfunduar punimet për rindërtimin e godinës dhe jemi në procedurat e dorëzimit të objektit. Për vlerën totale të punimeve duhet të drejtoheni Fondit Shqiptar të Zhvillimit në cilësinë e Njësisë Zbatuese.

- Shkolla “Charles Telford Erikson” është miratuar si investim nga UNDP por nuk kanë filluar ende punimet. Për vlerën dhe afatin e realizimit të punimeve duhet të drejtoheni UNDP për informacione më të detajuara.

Screenshot, përgjigja e Bashkisë Kavajë datë 5.01.2022

portal nuk shfaqet data e fillimit dhe mbarimit të punimeve, dhe as vlera e kontratës.

Nga verifikimi në terren në datë 5 nëntor, Faktoje evidentoi se në shkollën profesionale “Charles Telford Erikson” në Kavajë, mësimi për 300 nxënës vijon normalisht.

Më datë 7 dhjetor 2021 Faktoje i dërgoi një kërkesë për informacion Bashkisë Kavajë për të mësuar nëse Fondi Shqiptarë i Zhvillimit është njësi zbatuese për rikonstrukcionin e shkollës Profesionale “Charles Telford Erikson”, siç është përcaktuar edhe në marrëveshjen kuadër.

Në përgjigjen e saj të ardhur më datë 5 Janar 2022, Bashkia Kavajë shkruan se shkolla Profesionale “Charles Telford Erikson” është përcaktuar për rikonstrukcion (dëmtime të lehta) dhe do investohet në ndërtimin e një palestare të re dhe ka njësi Zbatuese UNDP. Ndërsa konvikti i shkollës “Charles Telford Erikson” është rindërtuar nga fillimi, kanë përfunduar punimet për rindërtimin e godinës dhe janë në procedurat e dorëzimit të objektit, ndërkohë ka njësi zbatuese FSHZH.

Shkolla 9-vjeçare “Vilë Bashtovë”, Rogozhinë

Një tjetër objekt arsimor i përfshirë në marrëveshjen kuadër, me njësi zbatuese FSHZH, është shkolla 9-vjeçare “Vilë Bashtovë” në Rogozhinë. Gjatë verifikimit të tenderimeve nuk figuron asnjë kontratë e lidhur për këtë shkollë, por shfaqet në listën e objekteve arsimore të EU4schools. Në portalin EU4schools tregohet se shkolla është përcaktuar për rikonstrukcion, por nuk përcaktohet data e fillimit dhe përfundimit të punimeve dhe mungon vlera e alokuar.

“Shkolla funksionon, por aty bëjnë mësim maksimumi 20 nxënës. Nuk jemi të qartë, disa kanë thënë që është për rikonstrukcion, ndërkohë disa të tjerë kanë thënë që do shembet dhe do rindërtohet nga fillimi, por mësimi vijon normalisht. Flitet që njësi zbatuese për këtë shkollë është bashkia, por nuk kanë dhënë asnjë afat”- tregon A.D. një banor i zonës për Faktoje.



Shkolla 9-vjeçare dhe kopshti “Vilë Bashtovë”, datë 5 nëntor 2021



Vendi ku ka qenë shkolla e mesme "Sulejman Elezi" në Kamëz, 20 tetor 2021

Shkolla e mesme "Sulejman Elezi", Kamëz

Nuk ka mbetur asnjë gjurmë nga shkolla e mesme "Sulejman Elezi" në Kamëz. Gjatë verifikimit, Faktoje evidentoi se prej rreth 1 viti e gjysmë shkolla është shembur, pasi u përfshi në programin e rindërtimit për shkak të dëmeve, që mori prej tërmetit të 26 nëntorit 2019.

Nxënësit e kësaj shkolle, prej dy vitesh, mësojnë në shkollën 9-vjeçare "Azem Hajdari", e cila ndodhet ngjitur me vendin ku ishte gjimnazi.

"Gjimnazi është shembur menjëherë pas tërmetit për shkak të dëmtimeve që pësoi. Pritet që të ndërtohet, është një projekt me donator gjerman. Nuk kemi ende një datë se kur do të nisë rindërtimi. Aktualisht janë rreth 200 gjimnazistë të kësaj shkolle, të cilët zhvillojnë mësimin mbasdite, në katin e parë të shkollës 9-vjeçare "Azem Hajdari"- tha për Faktoje drejtoresha e gjimnazit, Lumturie Ibrahim.

Komisioni Shtetëror i Rindërtimit në vendimin nr.17 datë 11.05.2020 miratoi financimin nga Qeveria



Shkolla 9-vjeçare "Azem Hajdari" në Kamëz

Gjermane nëpërmjet KfW, për rindërtimin e tre objekteve arsimore, ndër to edhe shkolla "Sulejman Elezi". Fondi i vënë në dispozicion në formën e Grantit nga Qeveria Gjermane për këtë program është në masën 11 (njëmbëdhjetë) milion euro, me njësi zbatuese FSHZH.



Foto Kopshti Vlashaj në fshatin Vlashaj, Shijak, 5 nëntor 2021

Kopshti "Vlashaj"-Shijak

Kopshti "Vlashaj" në Shijak është i përfshirë në Lotin 7 të marrëveshjes kuadër. Në këtë lot i cili kap vlerën 440,458,658 lekë figurojnë 10 objekte arsimore pjesë e programit të rindërtimit. Kopshti "Vlashaj" figuron në listën e FSHZH, por gjatë kërkimit të tenderimeve nuk shfaqet asnjë kontratë e lidhur. Gjatë verifikimit në terren, Faktoje evidentoi se kopshti është në gjendje të rrënuar.

"Kopshti ka rreth 6-7 vite që nuk është funksional. Fëmijët i dërgojmë në Maminas dhe në Marikaj. Na kanë thënë që do e bëjnë amerikanët, por nuk kemi dijeni nëse ndërtesa do të jetë sërish kopsht. Deri tani nuk kemi parë asnjë punëtor"- tregon për Faktoje prindi i një fëmijë 4 vjeç.

B.4.3. Konvikti nr. 16 në Qytetin Studenti duhej shembur, por në të banojnë ende studentë

Publikuar më 30.10.2021 në faktoje.al

Në territorin e bashkisë së Tiranës janë disa rezidenca studentore të përfshira në projektin e rindërtimit. Në Qytetin Studenti, sipas VKM nr. 1134 datë 24.12.2020 janë planifikuar për rindërtim 3 godina,

konvikti nr. 15, 16 dhe 18, ndërsa janë përcaktuar për rikonstruksion godinat 20-21 dhe 22-23. Në total qeveria ka akorduar fondin prej 1,608,555,182 lekë për rindërtimin/rikonstruksionin e këtyre godinave.

Një prej konvikteve të planifikuara për ndërtim është godina nr. 16, ku sipas VKM nr.1134 qeveria i ka akorduar Bashkisë Tiranë fondin prej 311,425,288 lekë pa TVSH.

Gjatë verifikimit në terren mbi ecurinë e procesit të rindërtimit për rezidencat studentore, vumë re se konvikti nr. 16, ende nuk ishte shembur dhe vijon të ketë studentë të akomoduar.

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, në Bashkinë Tiranë, në vlerën 1 608 555 182 (një miliard e gjashtëqind e tetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, përkatësisht, për:

- ndërtimin e godinës TIP në RSU Nr.1 (Nr.15), në vlerën 313 436 038 (treqind e trembëdhjetë milionë e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH;
- ndërtimin e godinës TIP në RSU Nr.1 (Nr.16), në vlerën 311 425 288 (treqind e njëmbëdhjetë milionë e katërqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;
- ndërtimin e godinës TIP në RSU Nr.1 (Nr.18), në vlerën 311 425 288 (treqind e njëmbëdhjetë milionë e katërqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;
- rikonstruksionin e godinave "Nr.20-21; Nr.22-23", në RSU Nr.1, në vlerën 456 772 100 (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e njëqind) lekë pa TVSH;

Screenshot, VKM nr.1134 datë 24.12.2020



Godina nr.16 e banuar në Qytetin Studenti, tetor 2021

TË DHËNAT E KËRKUESIT		Nr. kërkesë:
Emër Mbiemër: "Faktoje.al" përfaqësuar nga gazetare : Ina Allkanjari	Adresa postare: Rruga "Nasi Pavlo", Pallati "Edil-al", shk 1, kati 3, ap 8 Adresa elektronike: [Redacted] Nr. Tel: [Redacted]	Data e kërkesës: 22.10.2021 Firma: [Signature]
TË DHËNAT E INSTITUCIONIT PUBLIK		
Institucioni Publik që i drejtohet kërkesa: Bashkia Tiranë	Qyteti i Institucionit Publik: Tiranë	
Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar		
Lidhur me procesin e Rindertimit, sipas VKM nr 1134 date 24.12.2020 është percaktuar si objekt për ndertim, RSU nr.1 (nr 16) me vlere 311,425,288 leke.		
1.A ka perfunduar shembje a godines nr.16? 2. A është lidhur kontrata për rindertimin e saj? 3. Kur pritet të përfundojë procesi i rindertimit të godines? 4. Ku janë akomoduar studentet e kësaj godine nëse rindertimi nuk ka përfunduar? 5. Bashkia Tirane ka një sërë objekte rezidenciale studentore në proces rindertimi dhe rikonstruksioni, ju lutem na informoni ku janë akomoduar studentet e këtyre objekteve?		

Screenshot, kërkesa për informacion drejtuar Bashkisë Tiranë, datë 22.10.2021

TË DHËNAT E KËRKUESIT		
Emër Mbiemër: "Faktoje.al" përfaqësuar nga gazetare : Ina Allkanjari	Adresa postare: Rruga "Nasi Pavlo", Pallati "Edil-al", shk 1, kati 3, ap 8 Adresa elektronike: [Redacted] Nr. Tel: [Redacted]	Data e kërkesës: 22.10.2021 Firma: 
TË DHËNAT E INSTITUCIONIT PUBLIK		
Institucioni Publik që i drejtohet kërkesa: Instituti i Ndërtimit	Qyteti i Institucionit Publik: Tiranë	
Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar		
Lidhur me procesin e Rindërtimit, sipas VKM nr 1134 date 24.12.2020 është percaktuar si objekt për ndërtim, RSU nr.1 (nr 16) me vlerë 311,425,288 leke.		
1.Ju lutem na vendosni ne dispozicion vendimin/oponencen ne lidhje me kete godine.		
Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni:		

Kërkesa drejtuar Institutit të Ndërtimit, datë 22.10.2021
Në mesin 16, jeta rrjedh normalisht

Për të qartësuar arsyen se përse kjo godinë, e përfshirë në listën e rezidencave studentore që duhen shembur, aktualisht akomodon studentë, iu drejtua me një kërkesë për informacion Bashkisë Tiranë. Në përgjigjen e mbërritur më datë 03.11.2021 bashkia shkruan se të gjitha konviktet e RSU Nr.1 janë përfshirë në Programin "Promovimi i Energjisë së rinovueshme dhe efikasitetit të Energjisë", marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bankës Gjermane KfW për projektin 'Rehabilitimi i konvikteve sipas efikasitetit të Energjisë i RSU Nr.1 Tiranë'.

"Në kuadër të programit "Promovimi i Energjisë së rinovueshme dhe efikasitetit të energji", përfitojnë rikonstrukcionin e plotë në fazën e parë, konviktet nr.3, nr.4, nr.14, nr.16 dhe nr.17", shkruan Bashkia Tiranë në përgjigjen e saj.

Faktoje kërkoi gjithashtu në faqen e Bashkisë Tiranë për vendimin e Këshillit Bashkiak lidhur me shembjen e kësaj godine. Nga verifikimi në këtë faqe evidentuam vendime të Këshillit Bashkiak për godinat e tjera në Qytetin Studenti të planifikuara

për shembje dhe rindërtim, por jo për konviktin nr. 16. Nëpërmjet një kërkesë për informacion, Faktoje i kërkoi Institutit të Ndërtimit të na vendosë në dispozicion vendimin/oponencën në lidhje me godinën nr. 16 në RSU nr.1. Deri me sot nuk kemi marrë një përgjigje.

Faktoje ishte në konviktin 16, ku foli me disa prej studentëve që janë të akomoduar aty që prej fillimit të vitit akademik 2021-2022.

"Nuk e di që kjo godinë është për rindërtim, nuk na kanë thënë asgjë, nuk kemi asnjë lajmërim. Brenda dhomave nuk kam parë shenja të tërmetit, por nëse ekspertët e kanë percaktuar për shembje dhe ndërtim nga fillimi, është e frikshme që ne jetojmë ende në një konvikt të tillë." – tregon për Faktoje një prej studentëve të këtij konvikti, e cila nuk pranoi të identifikohet.

Një tjetër studente, banore e kësaj godine tregon për Faktoje se kujdestarja e konviktit i ka komunikuar në muajin gusht se godina do të shembej, por ky vendim ishte ndryshuar në fillimit të vitit të ri akademik 2021-2022.



Godina nr.16 në Qytetin Studenti, tetor 2021



Foto nga konvikti nr. 16 e mbërritur në redaksinë e Faktoje nga studentë të akomoduar brenda tij, tetor 2021



Foto nga konvikti nr. 16 e mbërritur në redaksinë e Faktoje nga studentë të akomoduar brenda tij, tetor 2021



Godina nr.16 në Qytetin Studenti, tetor 2021

Disa studentë tregojnë se ndonëse shenjat e tërmetit nuk janë të dukshme, konvikti është i amortizuar dhe kushtet janë shumë të vështira për jetesë. *“Unë kam marrë informacion që kjo godinë është vendosur*

për rindërtim dhe kur nisi rindërtimi te disa godina të tjera në Qytetin Studenti e pyetëm kujdestaren se çfarë do të ndodhë me konviktin tonë. Ajo na tha që shkresa që ky konvikt të rindërtohej është firmosur prej dy vitesh, por deri më tani s’është bërë asgjë”-tregon tjetër student, që banon në konviktin nr.16.

Faktoje iu drejtua edhe Administratës së RSU nr.1 për të marrë informacion për konviktin nr.16, por punonjës të administratës e deleguan te Bashkia Tiranë. Në vijim të kërkesës tonë u informuam që godina që duhej shembur nuk qe RSU nr 16 por ajo nr. 19. (Referoju seksionit më lart ku kjo çështje e ndryshimit të VKM-së është trajtuar më hollësisht.)

B.4.4. Rindërtimi i konvikteve të studentëve, asnjë gati për vitin akademik 2021-2022

Publikuar më 28.10.2021 në faktoje.al

“Po punohet në disa kantiere në Universitetin e Mjekësisë, në Universitetin Bujqësor, edhe te

Objekti i Tenderit	Vlera / Fondi Lirë Leka	Statusi i Tenderit	Operator Ekonomik Kontraktues	Vlera fituese
Objekti i minikonkursit: “Ndërtimi i godinës “Godina nr.22, blz. Zogu i (7. katësh)” (Programi i Rindërtimit).		Lidhur Kontrata	Futhe Shpk & Edi-al -it Shpk	143814171.35
Objekti i minikonkursit: “Ndërtimi i kopshtit “Fikas”. (Programi i Rindërtimit)		Lidhur Kontrata	“Uleza Ndërtim” shpk & “Hastod” Shpk & “Flori” Shpk	19,822,144.00
Objekti i minikonkursit: “Ndërtimi i godinës Qendra Sociale “Të qëndrojmë së bashku” Kombinal Tirane”		Lidhur Kontrata	“Uleza Ndërtim” shpk & “Hastod” Shpk & “Flori” Shpk	129,297,155.00
Objekti i minikonkursit: “Ndërtimi i Godinës Tip nr.3 (nr.1) (Programi i Rindërtimit).		Lidhur Kontrata	4 A-M SHPK	305,946,636.00
Objekti i minikonkursit: “Ndërtimi i Godinës Tip nr.3 (nr.2) (Programi i Rindërtimit).		Lidhur Kontrata	“Gener 2” sh.p.k.	305,996,838.00
Objekti i minikonkursit: “Ndërtimi i Godinës Tip nr.3 (nr.3) (Programi i Rindërtimit).		Lidhur Kontrata	Alto impex” shpk & “Vega” shpk & “MF Invest” shpk	306,499,751.00
Objekti i minikonkursit: “Ndërtimi i Godinës Tip nr.3 (nr.4) (Programi i Rindërtimit).		Lidhur Kontrata	“Ante group” shpk & “AGB 3” shpk & “NOVA Construction 2012” Shpk	306,626,622.00
Objekti i minikonkursit: “Ndërtimi i Godinës Tip nr.3 (nr.5) (Programi i Rindërtimit).		Lidhur Kontrata	“Gjokuri” shpk & “Instituti Dekladi” shpk	305,798,306.00
Objekti i minikonkursit: “Ndërtimi i Godinës Tip nr.3 (nr.6) (Programi i Rindërtimit).		Lidhur Kontrata	“Senika” shpk & “GBK” shpk & “Erzeni” shpk & “Udha” shpk & “Agbes Konstruktion” shpk	306,667,237.00
Objekti i minikonkursit: “Ndërtimi i Godinës Tip nr.3 (nr.7) (Programi i Rindërtimit).		Lidhur Kontrata	BE-IS shpk & 2T shpk & Ergi shpk	305,615,961.00
Objekti i minikonkursit: “Ndërtimi i Godinës Tip nr.3 (nr.8) (Programi i Rindërtimit).		Lidhur Kontrata	G.P.G Company shpk & Shendeli shpk & NG Structures shpk	305,330,900.00
Objekti i minikonkursit: “Ndërtimi i Shkolles “Sami Frashëri” (Programi i Rindërtimit).		Lidhur Kontrata	“Startek” shpk & “B93” shpk & “Riviera” shpk & “Duka” shpk & “Vlante konstruktion” & “AL -Aufait” shpk	567,492,868.00
Objekti i minikonkursit: “Ndërtimi i godinës TIP nr.2 (Nr.3)” (Programi i Rindërtimit).		Lidhur Kontrata	“Kajger Konstruktion” shpk & “Ed konstruktion” shpk & “Rafaelo 2002” shpk	193,399,999.00
Objekti i minikonkursit: “Ndërtimi i godinës TIP nr.2 (Nr.4)” (Programi i Rindërtimit).		Lidhur Kontrata	“Kronos Konstruktion” shpk & “Everest” shpk & “Avb&Trans-2010” shpk	195294562.5

Screenshot, rindërtimi i godinave RSU nr.2 (mjekësia) dhe RSU nr.3 Universiteti Bujqësor

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, në Bashkinë Tiranë, në vlerën 1 608 555 182 (një miliard e gjashtëqind e tetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, përkatësisht, për:

- ndërtimin e godinës TIP në RSU Nr.1 (Nr.15), në vlerën 313 436 038 (treqind e trembëdhjetë milionë e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH;
- ndërtimin e godinës TIP në RSU Nr.1 (Nr.16), në vlerën 311 425 288 (treqind e njëmbëdhjetë milionë e katërqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;
- ndërtimin e godinës TIP në RSU Nr.1 (Nr.18), në vlerën 311 425 288 (treqind e njëmbëdhjetë milionë e katërqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;
- rikonstruksionin e godinave "Nr.20-21; Nr.22-23", në RSU Nr.1, në vlerën 456 772 100 (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e njëqind) lekë pa TVSH;

Screenshot VKM nr. 1134, rindërtimi dhe rikonstruksioni i objekteve arsimore në RSU nr.1

inxhinieria e Ndërtimit. Pra do të ketë disa kampuse, që kur të rinjtë të rikthehen në shtator apo në tetor në varësi se kur do të hapet shkolla, t'i mirëpresim studentët realisht në konvikte, që si fillim janë çliruar". deklaroi kryetari i Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj në prill 2021. Pavarësisht deklaratave se procesi i rindërtimit po ecën me ritme të shpejta, ende asnjë nga rezidencat studentore nuk është gati për të akomoduar studentët.

Fondi i alokuar për rindërtimin e Rezidencave Studentore Universitare është bërë me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 212, datë 11.03.2020 ku janë përcaktuar 10 konvikte, 8 prej të cilave në kampusin e Universitetit Bujqësor në Kamëz dhe 2 të tjera pranë Universitetit të Mjekësisë në Tiranë.

Ndërkohë 7 rezidenca të tjera studentore kanë si burim financimi VKM nr. 1134 datë 24.12.2020 dhe janë planifikuar për rindërtim dhe rikonstruksion në kampusin e Qytetit Studenti.

8 godina të Universitetit Bujqësor, duhet të përfundonin brenda vitit 2021

Rreth 2200 studentë të Universitetit Bujqësor në Kamëz priten të akomodohen në 8 godina të reja janë në proces rindërtimi. Sipas Open Procurement Albania data e lidhjes së kontratave për 8 rezidencat studentore RSU nr. 3 rezulton muaji tetor 2020, ndërsa kohëzgjatja e ndërtimit të këtyre godinave është parashikuar **të jetë 13 muaj**.

Faktoje verifikoi në terren në datë 20 tetor 2021, ecurinë e këtij procesi ku evidentoi se ende nuk kishte përfunduar ndërtimi i ndonjërit prej konvikteve.

Në tabelën e punimeve, nuk tregohet data se kur ka nisur procesi i ndërtimit, por vetëm kohëzgjatja prej 13 muajsh e punimeve për godinën nr. 1 në Universitetin Bujqësor.



Tabela e punimeve RSU nr.3 godina nr.1, datë 20.10.2021

VKM	Objekti Tenderit	Fondi Limit	Rindërtimi			Mblidhja	
			Vlera e Kontrates	Data e Lidhjes së Kohëzgjatja		Fondi Limit	Vlera e Kontrates
212	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.1)		305.946.636.0	27/10/2020	13 (trembëdhjetë) muaj		2,569,108.0
212	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.2)		305.996.838.0	23/10/2020	13 (trembëdhjetë) muaj		2,750,842.0
212	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.3)		306.499.751.0	21/10/2020	13 (trembëdhjetë) muaj		2,766,180.0
212	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.4)		306.626.622.0	27/10/2020	13 (trembëdhjetë) muaj		2,830,000.0
212	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.5)		305.798.306.0	27/10/2020	13 (trembëdhjetë) muaj		2,823,193.0
212	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.6)		306.667.237.0	27/10/2020	13 (trembëdhjetë) muaj		2,720,000.0
212	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.7)		305.615.961.0	27/10/2020	13 (trembëdhjetë) muaj		2,766,260.0
212	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.8)		305.330.900.0	27/10/2020	13 (trembëdhjetë) muaj		2,830,000.0

Tabela e krijuar nga Faktoje, RSU nr.3 godinat e planifikuara për rindërtim



Rezidenca studentore nr.3 godina nr.1, datë 20.10.2021



Rezidenca studentore nr.3 godina nr.2, datë 20.10.2021



Rezidenca studentore nr.3 godina nr.3, datë 20.10.2021



Rezidenca studentore nr.3 godina nr.4, datë 20.10.2021

Inxhinieri zbatues për godinën nr.2 Noel Vata, tregoi për Faktoje:

“Me këtë ecuri që kemi, shpresojmë që brenda këtij viti të jetë e përfunduar, punimet kanë filluar në fund të janarit. Godinat janë 5 kate dhe kanë një kat bodrum, ka dy ashensorë, shkallët e emergjencës, shkallët për përdorim të përditshëm, shkallët të cilat dalin në tarracë”.

Përsa i përket godinës nr. 3 në korpusin e UB, inxhinieri Zoi Dhimetrika tha se punimet parashikohet të përfundojnë në pranverën e vitit 2022.

“Ky objekt do të ketë edhe disa ndryshime në strukturë, pasi do të implementohet edhe një laborator, gjithashtu

do të duhet të realizohet një ashensor më i madh për shkak të pajisjeve. Mendojmë se kjo godinë mund të jetë e përfunduar rreth muajve mars-prill 2022. Punimet për këtë godinë kanë nisur në korrik, pasi në këtë zonë kalonin telat e korrentit”-tregon inxhinieri.

Përgjegjësi i punimeve në godinën nr.7 Ismet Islamaj, tregon për Faktoje:

“Punimet kanë nisur rreth një vit më parë në dhjetor 2020. Afati është 13 muaj, jemi në kohë me procesin e rindërtimit. Kjo godinë është 6 kate së bashku me bodrumin.”

Faktoje evidentoj se 8 godinat e planifikuara për rindërtim në kampusin e Universitetit Bujqësor ende



Rezidenca studentore nr.3 godina nr.5, datë 20.10.2021



Rezidenca studentore nr.3 godina nr.6, datë 20.10.2021



Rezidenca studentore nr.3 godina nr.7, datë 20.10.2021



Rezidenca studentore nr.3 godina nr.8, datë 20.10.2021

nuk kanë përfunduar, ndërsa një pjesë e tyre nuk mund të jenë gati për të pritur studentët brenda afateve të parashikuara sipas kontratave të lidhura.

2 godinat e Universitetit të Mjekësisë, gati vitin e ardhshëm

“Konviktet e studentëve të Universitetit të Mjekësisë do të jenë gati në vitin e ri akademik, me kushte më

të mira dhe të njëjtën cilësi si godinat rezidenciale studentore të Inxhinierisë”,- deklaroi Kreu i Bashkisë Erion Veliqaj. Por, viti akademik 2021-2021 i gjeti të papërfunduara 2 godinat e planifikuara për rindërtim, ku pritet të akomodohen rreth 200 studentë të mjekësisë. Data e lidhjes së kontratave për 2 rezidencat studentore RSU nr. 2 rezulton muaji **tetor 2020**, ndërsa kohëzgjatja e ndërtimit të këtyre godinave është parashikuar **të jetë 13 dhe 15 muaj**.

VKM	Objekti Tenderit	Fondi Limit	Rindërtimi			Mbikqyrja	
			Vlera e Kontrates	Data e Lidhjes së	Kohëzgjatja	Fondi Limit	Vlera e Kontrates
212	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.2 (Nr.3)		193,399,999.0	23/10/2020	13 (trembëdhjetë) muaj		1,496,585.0
212	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.2 (Nr.4)		195,294,562.0	26/10/2020	15 (pesëmbëdhjetë) muaj		1,870,000.0

Tabela e krijuar nga Faktoje, RSU nr.2 godinat e planifikuara për rindërtim



Rezidenca studentore nr.2 godina nr.3, datë 20.10.2021



Rezidenca studentore nr.2 godina nr.4, datë 20.10.2021

VKM	Subjekti	Objekti	Vlera VKM	Rindërtim/Rikonstruksion	
				Fondi Limit	Vlera Kontrates
1134	Bashkia Tirane	RSU Nr.1 (Nr. 15)	313,436,038	308,155,467	305,100,339
1134	Bashkia Tirane	RSU Nr.1 (Nr. 16)	311,425,288	-	-
1134	Bashkia Tirane	RSU Nr.1 (Nr. 18)	311,425,288	308,155,467	305,684,203
1134	Bashkia Tirane	RSU Nr.1 (Nr 20-21 dhe 22-23)	456,772,100	452,657,841	447,220,000

Tabela e krijuar nga Faktoje, RSU nr.1 godinat e planifikuara për rindërtim/rikonstruksion

“Godinat nr 3 dhe nr 4 janë ndërtuar nga fillimi. Përsa i përket godinës nr. 3 pritet të përfundojë vitin tjetër. Ka rreth 8 muaj që ka nisur procesi i rindërtimit, aktualisht jemi në fazën e muraturës dhe përfundimit të katit të fundit. Godina është 9 kate së bashku me bodrumin. Godina nr. 4 është pak më përpara me procesin e rindërtimit”– tregon për Faktoje, inxhinieri Agim Kaleshi.

Në disa prej godinave në Qytetin Studenti ende nuk ka nisur rindërtimi

Në Rezidencën Studentore Universitare nr.1 në Qytet Studenti, sipas VKM nr. 1134 datë 24.12.2020 janë planifikuar për rindërtim 3 godina, konkretisht konvikti nr. 15, 16 dhe 18. Ndërsa janë përcaktuar për rikonstruksion 4 godina, 20-21 dhe 22-23. Në total

qeveria ka akorduar fondin prej 1,608,555,182 lekë për rindërtimin/rikonstruksionin e këtyre godinave.

Nga verifikimi në terren godina nr. 16 ndonëse është planifikuar për rindërtim pas tërmetit të 26 nëntorit, ende nuk është shembur dhe studentët vijnë të akomodohen në këtë konvikt. Vlera e alokuar për rindërtimin e kësaj godine sipas VKM Nr. 1134 është 311,425,288 lekë.

Dy godina të tjera, të cilat duhet të rindërtohen nga fillimi janë konvikti nr. 15 dhe nr.18. Në tetor të vitit 2021 procesi për Konviktin 15 ishte ende në fazën e largimit të inerteve pas shembjes.

Inxhinieri zbatues i godinës nr.18, Erald Gjiriti tregon për Faktoje: *“Ka 1 muaj që ka nisur ndërtimi për*



RSU nr.1 godina nr.16, datë 19 tetor 2021



RSU nr.1 godina nr.15, datë 19 tetor 2021



RSU nr.1 godina nr.18, datë 19 tetor 2021

godinën numër 18. Nga momenti i nisjes së ndërtimit është planifikuar që të përfundojë brenda 12 muajve. Dy kate janë ngritur deri në këto momente, në total do të jetë 7 kate plus 1 kat bodrum. Në këtë zonë kjo është godina e parë që ka nisur punën për rindërtim.”

Gjatë verifikimit të godinave të cilat janë planifikuar për rikonstruksion, konvikti nr. 20-21 dhe konvikti nr. 22-23 nuk gjetëm asnjë tabelë të punimeve.

“Jemi duke realizuar restaurim total dhe përforsim objekti për godinat 20-21. Dy godinave po i bëhet një restaurim rrënjësor, objektit po i ngelen vetëm tulla dhe kollonat. Restaurimi ka rreth dy muaj që

ka nisur dhe po ecim me ritme të mira, nuk mund të të them se kur pritet të përfundojë pasi varet se si do të vijojë procesi i punës, pasi godina ka qenë shumë e amortizuar”- tregon inxhinieri Xhefson Isaj.

Në godinën nr. 22-23 nuk gjetëm punëtorë në terren në 20 tetor 2021, kur bëmë verifikimin, ndonëse edhe këto konvikte janë planifikuar për rikonstruksion.

Faktoje prej disa kohësh monitoron procesin e rindërtimit të objekteve arsimore në kryeqytet. Ndonëse transparenca është fokusi i këtij procesi, gjetja e informacionit, për ecurinë e rindërtimit të objekteve arsimore mbetet një sfidë.



Tabela e punimeve, RSU nr.1 godina nr.18, Tiranë, 19 tetor 2021



RSU nr.1 godina nr. 20-21, datë 19 tetor 2021



RSU nr.1 godina nr. 22-23, datë 19 tetor 2021



RSU nr.1 godina nr. 22-23, datë 19 tetor 2021

B.4.5. Rindërtimi i objekteve arsimore, listë e cunuar nga bashkia Tiranë

Publikuar më 27.10.2021 në faktoje.al

“Transparenca, shpejtësia dhe efikasiteti janë shtyllat e procesit të rindërtimit. Do të jemi transparent, do të jetë një prokurim i hapur” – deklaroi në 5 mars 2020 Ministri i Rindërtimit Arben Ahmetaj, teksa prezantoi planin e rindërtimit. Ndonëse transparenca konsiderohet si një ndër faktorët më të rëndësishëm të këtij procesi, gjetja e informacionit në faqet zyrtare të bashkive apo Ministrisë së Rindërtimit, për ecurinë e rindërtimit të objekteve arsimore mbetet një sfidë, pasi të dhënat janë të paplota. Qeveria, në kuadër të procesit të rindërtimit të objekteve arsimore në kryeqytet, miratoi vendimin nr. 212, datë 11.3.2020 ku Bashkisë Tiranë iu akordua fondi prej 3.6 miliardë lekësh. Më 29 korrik 2020 nëpërmjet një ndryshimi në VKM nr. 212 fondi i akorduar për Bashkinë Tiranë, u rrit në vlerën 5.1 miliardë lekë. Faktoje i dërgoi një kërkesë për informacion bashkisë Tiranë, ku kërkoi listën e objekteve arsimore, të cilat sipas VKM nr. 212, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore” janë planifikuar për rindërtim.

Në përgjigjen e saj, bashkia Tiranë na vendosi në dispozicion një listë me 13 objekte arsimore, në kuadër të VKM nr. 212, ku tregohen edhe afatet e përfundimit.

**DIREKTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DIREKTORIA E INVESTIMEVE TË PUNËVE PUBLIKE
RINDËRTIMI I OBJEKTEVE ARSIMORE**

Nr.	Emërtimi i Projektit	Niveli Administrativ	Vlera e Kontraktuar (Projektim, zbatim)	Vlera e Kontraktuar (Mbiqyra)	Vlera e Kontraktuar (Kolaudim)	Status i Punimeve	Filimi i Punimeve	Përfundimi i Punimeve
1	Ndërtimi i shkollës "Sami Frashëri"	9	587,492,060	4,769,669.00	-	Punimet në proces	07.12.2020	23.12.2021
2	Ndërtimi i Kopshtit "Fikas"	Penel	13,893,024	218,207.00	29,900	Kasë përfunduar punimet	07.12.2021	26.03.2022
3	Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare, "174 Shkurti, Qeveria e Vjetër"	Dajç	191,167,917	1,488,380.00	-	Punimet në proces	30.10.2020	2022
4	Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare, "Haxhi Vajgël"	9	253,492,727	1,917,024.00	181,390	Kasë përfunduar punimet	06.11.2020	30.07.2021
5	Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare "Mangall"	Penel	101,800,000	838,584.00	58,717	Kasë përfunduar punimet	18.11.2020	05.04.2021
6	Ndërtimi i Kopshtit "Gara"	Penel	30,760,000	325,462.00	-	Punimet në proces	19.11.2021	29.09.2022
7	Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare, "Muzet Toprani"	5	180,549,814	1,403,417.00	71,739	Kasë përfunduar punimet	07.12.2021	16.07.2022
8	Ndërtimi i Shkollës Çikllë E Ullit "Paga"	Penel	62,500,000	575,197.00	-	Punimet në proces	21.11.2020	16.10.2021
9	Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare, "Pezë e Vogël"	Penel	110,068,839	914,101.00	-	Punimet në proces	29.10.2020	29.07.2021
10	Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare, "Vlami Tardha"	9	362,713,599	2,681,876.00	-	Punimet në proces	18.11.2020	01.11.2021
11	Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare, "Haxhi Vajgël"	Vaguer	196,084,800	1,783,900.00	-	Punimet në proces	02.03.2021	03.01.2022
12	Ndërtimi i Shkollës në rrugën "Haxhi Vajgël"	8	139,200,124	1,400,000.00	-	Punimet në proces	05.05.2021	05.02.2022
13	Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare "Drita"	Zall Hurr	174,360,646	1,700,000.00	-	Punimet në proces	05.05.2021	05.02.2022

Mbante: Kontratat e kolaudimit nuk janë lidhur ende për objektet në proces

Lista me 13 objekte arsimore dërguar nga bashkia Tiranë, datë 22.09.2021

Në listën dërguar Faktojes, bashkia rendit vetëm 13 objekte arsimore në proces rindërtimi me një vlerë të kontraktuar për projektim, zbatim rreth **2.4 miliardë lekë**. Pas verifikimit të kontratave të lidhura në Open Procurement Albania, rezultojnë edhe disa tenderime që nuk janë të përfshira në listën e dërguar nga bashkia Tiranë, por që kanë burim financimi fondin e akorduar në VKM nr. 212. Nga shqyrtimi i tenderit të hapur nga Bashkia e Tiranës dhe kontratat e lidhura me operatorët e ndryshëm ekonomikë, vihet re se objektet të cilat nuk i disponojmë në përgjigjen e Bashkisë, janë 10 ndërtesa rezidenciale për studentët dhe dy objekte të tjera, godina Qendra Sociale "Të qëndrojmë së bashku" në Kombinat dhe godina nr. 22 në Bulevardin Zogu 1.

KËRKESË PËR INFORMACION

Emër Mbiemër: Znj. Inva Hasanaliaj	Adresa postare: Rr. "Nasi Pavlo", Pall. "Edil-Al", shk.1, kati 3, A-S, Tirana 1001 Adresa elektronike: [Redacted] Nr. Tel: [Redacted]	Data: 07/09/2021 Nënshkrimi: 
--	--	--

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

1) Në zbatim të vendimit Nr.212, datë 11.3.2020 "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE", të ndryshuar, ju lutem na vendosni në dispozicion:

1. Listën e objekteve arsimore, dhe adresën, që janë objekt të kësaj VKM?
2. Vlerën e buxhetuar/kontraktuar për rindërtimin (projektim, zbatim, mbikqyrje, kolaudim etj) e secilit objekt arsimor?
3. Statusin e rindërtimit për secilin objekt (ende pa filluar, prokuruar, kontraktuar, në fazë punimesh, përfunduar, marrë në dorëzim)?
3. Datën e fillimit të punimeve për secilin objekt arsimor?
4. Datën e përfundimit të punimeve për secilin objekt arsimor?

Kërkesa për informacion drejtuar Bashkisë Tiranë, datë 07.09.2021

2.8 Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër

1. Fondi / vlera e përafërt e kontratës **3,711,884,202 (tre miliard e shtatëqind e njëmbëdhjetë milion etetëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e dy) lekë pa tvsh**
2. Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është**
3. Burimi i Financimit : Në zbatim të VKM Nr. 212, datë 11.03.2020 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore pika 2.b", në mbështetje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurim publik" (i ndryshuar), VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".
4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: **Rindërtimi i 14 (katërmëdhjetë) objekteve arsimore në Bashkinë e Tiranës si më poshtë:**

1. Ndërtimi i godinës Qendra Sociale "Të Qëndrojmë së bashku", Kombinat
2. Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.2 (Nr.3)

3. Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.2 (Nr.4)
4. Ndërtimi i godinës "Godina nr.22, blv. Zogu I (7-katëshi
5. Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.1)
6. Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.2)
7. Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.3)
8. Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.4)
9. Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.5)
10. Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.6)
11. Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.7)
12. Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.8)
13. "Ndërtimi i shkollës "Sami Frashëri"
14. "Ndërtimi i kopshtit "Fikas"

Autoriteti Prokurues sipas Njësise së Qeverisjes Vendore	Objekti i Tenderit	Vlera / Fondi Limit Leke	Statusi i Tenderit	Operator Ekonomik Kontraktues	Vlera fituese
Qeveria Vendore Tiranë	Objekti i minikonkursit: Ndërtim i Shkolles 5- Vjeçare " Mangull".		Lidhur Kontrata	"Agri Konstruksion" shpk & "IBN" shpk & "R&T" shpk	101,800,000.00
Qeveria Vendore Tiranë	Objekti i minikonkursit: Ndërtim Kopshti Gurre"		Lidhur Kontrata	"Kacledja" shpk & "Junik" shpk	30,760,000.00
Qeveria Vendore Tiranë	Objekti i minikonkursit: Ndërtim i Shkolles 5- Vjeçare " Pajan"		Lidhur Kontrata	"Kacledja" shpk & "Junik" shpk	62,500,000.00
Qeveria Vendore Tiranë	Objekti i minikonkursit: "Ndërtim i Shkolles 5- Vjeçare 17- Shkurti Qesarake E Vjeter"		Lidhur Kontrata	Fusha Shpk & Edil-ei-h Shpk	191067917.5
Qeveria Vendore Tiranë	Objekti i minikonkursit: Ndërtim i Shkolles 5- Vjeçare " Hasan Vogli."		Lidhur Kontrata	"V.A.S Konstruksion" shpk & "Mare TCF" shpk & "Erg" shpk	253452727.75
Qeveria Vendore Tiranë	Objekti i minikonkursit: Ndërtim i Shkolles 5- Vjeçare " Peze e Vogël"		Lidhur Kontrata	"Ad Star" shpk & "2T" shpk & "K.A.E.XX" shpk	11006639.42
Qeveria Vendore Tiranë	Objekti i minikonkursit: Ndërtim i Shkolles 5- Vjeçare " Qazim Turdiu"		Lidhur Kontrata	AGI KONS & BE-IS	362,713,599.00
Qeveria Vendore Tiranë	Objekti i minikonkursit: Ndërtim i Shkolles 5- Vjeçare "Murat Topfani"		Lidhur Kontrata	"Evenses" sh.p.k & "Arbtrane -2010 sh.p.k & "Kronas Konstruksion" sh.p.k	180,549,814.00

Open Procurement Albania, lista e 8 (tetë) objekteve Arsimore në Bashkinë e Tiranës me burim financimi vendimin nr. 212

Në një listë tjetër të publikuar nga Open Procurement Albania, paraqiten 8 objekte të tjera arsimore, që figurojnë në VKM nr 212 dhe janë në listën e vënë në dispozicion nga bashkia Tiranë.

Sipas dokumentave, fondi i akoluar për këto 8 objekte arsimore kap vlerën e 1,308,064,646 lekë. Faktoje krijoi një tabelë me të dhënat e siguruara nga tenderimet për objektet arsimore në kryeqytet, që janë pjesë e procesit të rindërtimit në kuadër të VKM 212.

Nëse bëjmë një krahasim të tabelës së krijuar nga Faktoje me listën e dërguar nga bashkia Tiranë, figurojnë 12 objekte arsimore që nuk janë të përfshira në përgjigjen zyrtare të këtij institucioni, ndonëse

Faktoje kërkoi listën me të gjitha objektet arsimore për rindërtim, me burim financimi vlerën e akorduar në VKM nr. 212.

Objektet arsimore që nuk figurojnë në listën e bashkisë Tiranë janë:

- 1 Ndërtimi i godinës Qendra Sociale "Të Qëndrojmë së Bashku", Kombinat
- 2 Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.2 (Nr.3)
- 3 Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.2 (Nr.4)
- 4 Ndërtimi i godinës "Godina nr.22, blv. Zogu i (7-katëshi

VKM	Objekti Tenderit	Rinderimi				Mbikqyrja	
		Fondi Limit	Vlera e Kontrates	Data e Lidhjes se Kontrates	Kohezgjatja	Fondi Limit	Vlera e Kontrates
212	"Mobilimi me pajisje dhe orendi i objekteve arsimore të dëmtuara nga tërmeti"						
212	Rindërtimi i 14 objekteve Arsimore Tirane (Marreveshje Kuader)	3,711,884,202	3,697,602,351				32,644,764
	Ndërtimi i godinës Qendra Sociale "Të Qëndrojmë së Bashku", Kombinat		129,297,155.0	27/10/2020	5 (pesë) muaj		1,071,180.0
	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.2 (Nr.3)		193,399,999.0	23/10/2020	13 (trembëdhjetë) muaj		1,496,585.0
	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.2 (Nr.4)		195,294,562.0	26/10/2020	15 (pesëmbëdhjetë) muaj		1,870,000.0
	Ndërtimi i godinës "Godina nr.22, blv. Zogu i (7-katëshi		143,814,171.0	27/10/2020	9 (nëntë) muaj		1,163,625
	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.1)		305,946,636.0	27/10/2020	13 (trembëdhjetë) muaj		2,569,108.0
	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.2)		305,996,838.0	23/10/2020	13 (trembëdhjetë) muaj		2,750,842.0
	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.3)		306,499,751.0	27/10/2020	13 (trembëdhjetë) muaj		2,766,160.0
	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.4)		306,626,622.0	27/10/2020	13 (trembëdhjetë) muaj		2,830,000.0
	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.5)		305,798,306.0	27/10/2020	13 (trembëdhjetë) muaj		2,823,193.0
	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.6)		306,667,237.0	27/10/2020	13 (trembëdhjetë) muaj		2,720,000.0
	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.7)		305,615,961.0	27/10/2020	13 (trembëdhjetë) muaj		2,766,260.0
	Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.8)		305,330,900.0	27/10/2020	13 (trembëdhjetë) muaj		2,830,000.0
	"Ndërtimi i shkolles "Sami Frashëri"		567,492,069.0	23/10/2020	13 (trembëdhjetë) muaj		4,769,609.0
	"Ndërtimi i kopshtit "Fikas"		19,822,144.0	27/10/2020	3 (tre) muaj		218,202.0
212	Rindërtimi i 8 (tetë) objekteve Arsimore në Bashkinë e Tiranës	1,308,064,646	1,293,052,896				10,142,141
	Ndërtim i Shkolles 9- Vjeçare 17-Shkurti Qesarake E Vjetër		191,167,917	30.09.2020	6 (gjashtë) muaj		1,488,380.00
	Ndërtim i Shkolles 9- Vjeçare " Hasan Vogli"		253,492,727	30.09.2020	8 (tetë) muaj		1,917,024.00
	Ndërtim i Shkolles 9- Vjeçare " Mangull"		101,800,000	01.10.2020	5 (pesë) muaj		838,584.00
	Ndërtim Kopshti Gurre		30,760,000	01.10.2020	3 (tre) muaj		325,462.00
	Ndërtim i Shkolles 9- Vjeçare "Murat Topfani"		180,549,814	28.09.2020	6 (gjashtë) muaj		1,403,417.00
	Ndërtim i Shkolles 9- Vjeçare " Pajan"		62,500,000	01.10.2020	4 (katër) muaj		573,197.00
	Ndërtim i Shkolles 9- Vjeçare " Peze e Vogël"		110,068,839	29.09.2020	4 (katër) muaj		914,101.00
	Ndërtim i Shkolles 9- Vjeçare " Qazim Turdiu"		362,713,599	29.09.2020	8 (tetë) muaj		2,681,976.00

Tabela e krijuar nga Faktoje me listën e 22 objekteve arsimore të përfshira në procesin e rindërtimit në kuadër të VKM nr. 212

- 5 Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.1)
- 6 Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.2)
- 7 Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.3)
- 8 Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.4)
- 9 Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.5)
- 10 Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.6)
- 11 Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.7)
- 12 Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.8)

Pas konstatimit të kësaj mospërputhjeje, Faktoje iu drejtua sërish bashkisë Tiranë për të na vënë në dispozicion listën e plotë të objekteve arsimore në rindërtim bashkë me hollësitë e tjera të projekteve.

Deri më sot nuk kemi një përgjigje për këtë kërkesë.

Më herët Faktoje verifikoi nga afër ecurinë e procesit të rindërtimit të 13 objekteve arsimore të vëna në dispozicion nga bashkia Tiranë, ku rezultoi se shumica e tyre të planifikuara për rindërtim, pas tërmetit të 26 nëntorit 2019 ende nuk janë përfunduar.

Nga lista me 13 shkolla e kopshte në listën e dërguar nga bashkia Tiranë, në tre objekte vijonte puna në shkellje të afateve të parashikuara, dy të tjera pritej

TË DHËNAT E KËRKUESIT		
Emër Mbiemër: "Faktoje.al" përfaqësuar nga gazetare : Ina Allkanjari	Adresa postare: Rruga "Nasi Pavilo", Pallati "Edil-al", shk. 1, kati 3, ap 8 Adresa elektronike: Nr. Tel: [redacted]	Data e kërkesës: 25.10.2021 Firma: [signature]

TË DHËNAT E INSTITUCIONIT PUBLIK	
Institucioni Publik që i drejtohet kërkesa: Bashkia Tiranë	Qyteti i Institucionit Publik: Tiranë

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Lidhur me procesin e Rindërtimit, sipas VKM nr. 212 datë 11.03.2020 dhe VKM nr. 212 e ndryshuar në VKM nr. 631, datë 29.7.2020 ju lutem:

- 1.Na vendosni në dispozicion listën e plotë të objekteve arsimore të përfshira në procesin e rindërtimit në kuadër të kësaj VKM. (Lista e plotë me emrat dhe adresat perkatese)
2. A ka nisur rindërtimit për keto objekte arsimore? (Specifikoni kur ka nisur rindërtimit ose rikonstruksioni dhe në çfarë faze është secila prej objekteve)
- 3.Kur pritet të përfundojnë keto objekte arsimore? (Specifikoni afatet kur janë parashikuar të përfundojnë punimet për secilin prej objekteve)
4. Sa është fondi i akorduar për rindërtim apo rikonstruksion për secilin nga keto objekte arsimore? (Listoni secilin objekt me fondin perkatese)

Kërkesa për informacion drejtuar Bashkisë Tiranë, datë 25.10.2021

të përfundonin në fund të vitit 2021, ndërsa për 4 objekte përfundimi i punimeve, nuk pritet të ndodhë para vitit 2022. Referuar premtimeve të kryeministrit se të 143 shkollat e dëmtuara në rang vendi do të ishin gati në 2020-n dhe 2021, Faktoje konstatoi shkellje të përsëritur dhe zvarritje të afateve.

B.4.6. Rindërtimi në Tiranë, vetëm 1/3 e objekteve arsimore të premtuara janë përfunduar

Publikuar më 15.10.2021 në faktoje.al

Kopshti "Gurrë" në Petrelë

Bazuar në përgjigjen zyrtare, kopshti "Gurrë" në Petrelë duhej të kishte përfunduar në 29 shtator 2021. Sipas VKM Nr. 212, datë 11.03.2020 vlera e kontratës është 30,760,000 lekë pa TVSH, data e lidhjes së saj është 01.10.2020, ndërsa kohëzgjatja e punimeve, 3 muaj. Në javën e parë të tetorit 2021, gjatë verifikimit në terren konstatuam se objekti ishte ende i papërfunduar. Aty mungonin dyert, dritaret dhe pajisjet që e bëjnë objektin funksional si kopsht. Ditën e verifikimit nuk gjetëm punëtorë në terren.



Kopshti "Gurrë", dera e mbyllur asnjë punëtor në kantier 7 tetor 2021



Kopshti "Gurrë" në Petrelë, foto datë 7 tetor 2021

Një prej banorëve të zonës, i cili nuk pranoi të identifikohet tha për Faktoje: *"U bë një vit që ka nisur ndërtimi dhe nuk kemi asnjë informacion se kur pritet të përfundojë. Punëtorët mesa kam vënë re janë të pakët në numër. Ne menduam se do hapej në fund të shtatorit, sepse kështu na kishin thënë. Fëmijët i çojmë në fshatin tjetër në Daia, ka siguruar bashkia transport që i çojnë dhe i sjellin nga kopshti. Nuk jemi të qartë se kur do jetë gati, e kanë shtyrë sërish afatin, na kanë thënë që mund të përfundojë në dhjetor."*

Shkolla 9-vjeçare "Pajan"

Shkolla 9-vjeçare "Pajan", në Pezë, objekt në rindërtim me vlerë 62. 500. 000 lekë pa TVSH, ka si datë të lidhjes së kontratës 1 tetorin e 2020. Kohëzgjatja e punimeve është 4 muaj.

Fotot e objektit gjatë verifikimit në terren, dëshmojnë se shkolla do ende kohë të përfundojë, edhe pse në



Shkolla 9-vjeçare "Pajan" në Pezë, datë 7 tetor 2021



Shkolla 9-vjeçare "Pajan" në Pezë, datë 7 tetor 2021



Ambientet e brendshme të shkollës 9-vjeçare "Pajan", datë 7 tetor 2021

shkelje të afatit. *"Shembja e shkollës është bërë rreth muajit mars të këtij viti (2021), ndërsa ndërtimi ka nisur në prill. Na kanë thënë që do të përfundojë përpara Vitit të Ri, por nuk i dihet. Nxënësit i marrin me autobus dhe i dërgojnë në shkollë tjetër, në Pezë. Torturë është për këta fëmijë dhe rruga këtu është shumë e keqe!"* – tregon për Faktoje D. A, banor i kësaj zone.

Shkolla 9-vjeçare "Qazim Turdiu"

Shkolla 9-vjeçare "Qazim Turdiu", në zonën e Don Boskos në Tiranë, u planifikua për rindërtim pas tërmetit të 26 nëntorit 2019. Vlera e kontratës për këtë objekt sipas Open Procurement Albania është 362.713. 599 lekë pa TVSH. Data e lidhjes së kontratës rezultoi 29.09.2020, ndërsa kohëzgjatja e punimeve, 8 muaj.



Shkolla 9-vjeçare "Qazim Turdiu", foto datë 7 tetor 2021

Në javën e parë të tetorit 2021, kur kryem verifikimin, Inxhinieri që ndiqte ecurinë e projektit, Klaudio Dedaj, garantoj: *"Shkolla është drejt përfundimit, mendohet që në fund të tetorit nxënësit të vijnë në shkollë për tre seksionet, pra komplet godina e shkollës, përveç palestrës. Palestra do betonohet brenda muajit dhe do të punohet vetëm nga brenda. Në fund të muajit do të jetë e mbaruar tarraca dhe fasada. Në shkollë kanë*

mbetur vetëm riparime të vogla, 99% e punës është përfunduar, janë mbyllur vetratat, dyert, pllakat, hidrosanitare, ndriçuesët."

Shkolla e rindërtuar, planifikohet të dyfishojë kapacitetin, nga 300 në 600 nxënës. Afati i premtuar nga qeveria për përfundimin e shkollës ishte shtatori 2021, por objekti u përfundua në mesin e nënorit 2021.



Palestra e shkollës 9-vjeçare "Qazim Turdiu", Tiranë 7 tetor 2021

Gjimnazi "Sami Frashëri"

Gjimnazi "Sami Frashëri" në Tiranë, deri në shkurt 2020 nuk figuronte tek lista objekteve arsimore për rindërtim. Sipas Open Procurement Albania, kontrata për rindërtimin e objektit ka një me vlerë prej 567. 492. 069 lekë pa TVSH. Kontrata rezulton të jetë lidhur në datë 23/10/2020 me kohëzgjatje 13 muaj. Sipas këtij parashikimi, "Sami Frashëri" duhet të ishte gati në fund të vitit 2021. Nga verifikimi



Gjimnazi "Sami Frashëri", Tiranë 7 tetor 2021

në terren Faktoje konstatoi se ngritja e strukturës së brendshme të gjimnazit "Sami Frashëri" është realizuar, por ende nuk ka përfunduar struktura e jashtme.

Inxhinieri zbatues i projektit, Astrit Fejzaj tregoi për Faktoje: ***"Shkolla është drejt përfundimit, kanë mbetur vetëm punimet e rifiniturës, pllaka, suvatime, vetrata. Me këtë ritëm që po ecin punimet mendoj se***

rreth datës 20 dhjetor do të përfundojë. Shkolla do të do të ketë edhe një kat nën dhe, do të jetë me kushte shumë herë më të mira se ç'ka qenë".

Gjimnazi pritet të hapë dyert me kapacitet të dyfishuar nga 24 në 50 klasa, dhe nga 1400 nxënës shkolla planifikohet të ketë 1500 nxënës.

Objektet arsimore të përfunduara

Në listën e vënë në dispozicion nga Bashkia Tiranë, rezulton se procesi i rindërtimit (deri në fund të tetorit, kur janë bërë verifikimet) ka përfunduar në 4 objekte. Një ndër to është kopshti Fikas "Bletëza Maja" në Petrelë. Vlera e rindërtimit të këtij kopshti sipas Bashkisë Tiranë është 19.893.024 lekë pa TVSH. Nga verifikimi në terren rezulton se objekti është përfunduar.





Kopshti "Fikas" (Bleteza Maja) në Petrelë, datë 7 tetor 2021

"Në 15 shtator është bërë inagurimi i kopshtit. Për momentin ne kemi 30 fëmijë të regjistruar, por kapaciteti është më i lartë. Kemi tre grupe të ndara në varësi të moshës, kemi tri hapësira të ndara, ku secila përfshin tualetin dhe dhomën e fjetjes"- tregon për Faktojen drejtoresha e kopshtit Fikas.

Shkolla 9-vjeçare "Mangull" në Petrelë

Edhe shkolla 9-vjeçare "Mangull" në Petrelë, me vlerë rindërtimi 101.800.000 lekë pa TVSH, është përfunduar.



Shkolla 9-vjeçare "Mangull" në Petrelë, 7 tetor 2021

Shkolla 9-vjeçare Pezë e Vogël (Agron Hysenlliu)

Shkolla "Pezë e Vogël" duhet të përfundonte në datë 29.07.2021. Nga verifikimi në terren Faktoje konstatoi se rindërtimi i shkollës me vlerë 110.068.839 lekë pa TVSH ka përfunduar dhe ka hapur dyert për nxënësit në fillim të shtatorit 2021. Ajo çfarë evidentuam ishte se ende në ambientet e jashtme vijonte procesi i punimeve, ndonëse mësimi ka nisur rregullisht.

Drejtoresha e shkollës, Entela Caca tregon se ky objekt arsimor ka rreth 90 nxënës, dhe 15 fëmijë në moshë kopshti. *"Në shkollë po ndiqet normalisht"*



Shkolla 9-vjeçare "Pezë e Vogël" (Agron Hysenlliu), 7 tetor 2021



Shkolla 9-vjeçare "Pezë e Vogël" (Agron Hysenlliu), 7 tetor 2021



Ambientet e kopshtit, "Pezë e Vogël" (Agron Hysenlliu), 7 tetor 2021



Ambientet e jashtme, shkolla "Pezë e Vogël" (Agron Hysenlliu), 7 tetor 2021

mësimi, kanë mbetur pa përfunduar vetëm instalimi i ashensorit, i cili është drejt përfundimit dhe po punohet në ambientin e jashtëm, pasi janë tre fusha që do të shtrohen me tapet dhe do të punohet edhe me mbjelljen e barit"- tha Caca.

Shkolla 9-vjeçare "Hasan Vogli"

Shkolla 9 vjeçare "Hasan Vogli" në Tiranë ka hapur dyer këtë vit të ri shkollor (2021-2022). Vlera e rindërtimit të kësaj shkolle është 253.492.727 lekë pa TVSH, ndërsa kapacitetet janë rritur nga 600 në 900 nxënës.



Shkolla 9-vjeçare "Hasan Vogli",Tiranë 7 tetor 2021

Shkolla 9-vjeçare "Murat Toptani"

Shkolla 9-vjeçare "Murat Toptani" në zonën e Selitës, me kontratë në vlerën 180.549.814 lekë pa TVSH ka përfunduar dhe është e hapur për 360 nxënës.

Nga gushti i vitit 2020 e deri më sot, Faktoje ka identifikuar se për pjesën dërrmuese të objekteve arsimore të planifikuara për rindërtim janë shkelur afatet.



Shkolla 9-vjeçare "Murat Toptani", datë 7 tetor 2021

Në fillim të vitit shkollor 2020-2021, Faktoje raportoi se asnjë nga 143 shkollat në bashkitë e goditura nga tërmeti (Tiranë, Durrës, Kavajë, Krujë, Shijak, Kurbin, të planifikuara për rindërtimin nuk i hapi dyert për nxënësit, ndryshe nga ç'premtoi kryeministri dhe anëtarë të tjerë të qeverisë, të cilët nuk kanë hezitur të japin afate të reja pas atyre të shkelura.

B.5. KATËR ÇËSHTJE MBI PËRFITUESIT E PROGRAMIT TË RINDËRTIMIT

Në kuadër të transparencës dhe mirëmenaxhimit të fondeve publike dhe trajtimit të barabartë e të drejtë të qytetarëve që përfitojnë nga programi i rindërtimit, Faktoje dërgoi në datë 2 Shtator 2021 një listë me 4 pyetje tek Ministria e Shtetit për Rindërtimin.

TË DHËNAT E INSTITUCIONIT PUBLIK	
Institucioni Publik që i drejtohet kërkesa: Ministria e Rindërtimit	Qyteti i Institucionit Publik: Tiranë

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

- Per objektet e dëmtuara nga tërmeti të cilat kanë qenë të financuara me kredi bankare dhe të siguruar plotësisht apo pjesërisht, ju lutemi na informoni se si janë të përfshira në procesin e rindërtimit? Cila janë aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë proces? A përfitojnë nga fondet e Rindërtimit dhe si llogaritet kjo? Ju lutemi na vini në dispozicion bazën ligjore përkatëse që e rregullon këtë çështje.
- Per objektet e dëmtuara nga tërmeti që kanë patur funksione komerciale, a janë përfshirë në procesin e përfitimit me fondet e rindërtimit? Ju lutemi na informoni si për objektet komerciale, ato të siguruar dhe ato të pasiguar.
- Per objektet komerciale që ndodhen në pallatet e banimit të klasifikuara për shembje, a do të përfshihen në përfitimin e objekteve të reja? Nëse janë njeri banimi, por janë të përdorura për njeri komerciale (dyqane në katet e para) kompensimi i tyre do të jetë në njeri banimi në leke apo hapësira të reja, dhe këto hapësira do të jenë serioz në katet e para të banimit? Ju lutemi na vini në dispozicion bazën ligjore përkatëse që e rregullon këtë çështje.
- Per objektet e dëmtuara nga tërmeti të cilat janë shtëpi të dyta (si shtëpi pushimi) a përfitojnë nga fondet e rindërtimit? Ju lutemi na vendosni në dispozicion bazën ligjore që e rregullon këtë proces.

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni:

Ketë informacion mund ta vini në dispozicion nëpërmjet postës elektronike.

Përgjigje AMF

Referuar Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", ose njohur si "Programi i rindërtimit", subjektet përfituese përcaktohen në nenin 5 të tij. Në asnjë pikë të aktit normativ nuk është përmendur kategoria e ndërtesave të cilat kanë qenë të siguruar në shoqëritë e sigurimit dhe se kjo kategori përjashtohet nga ky akt. Vetëm në pikën 4 të nenit 5, përmendet përfitimi i një kategorie banesash, që nëse nuk kanë përfituar nga ndonjë program tjetër i rindërtimit, do të trajtohen sipas këtij akti.

Sigurimi i pronës nga humbjet, dëmtimet ose shkatërrimet në mënyrë të papritur, të paparashikuar dhe aksidentale si pasojë e zjarrit, tërmetit, përmytytjet, rrufesë, stuhisë, etj, rregullohet nga Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe përfshihet në klasën 8 të sigurimit (Sigurimi nga zjarri dhe rreziqet shtesë).

Rastet e objekteve të financuara me kredi bankare për të cilat është lidhur një kontratë sigurimi për efekt kredie dhe që janë dëmtuar nga tërmeti trajtohen në bazë të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Bazuar në kontratën individuale për secilin risk të siguruar, përfitues është banka e cila në cilësinë e palës së tretë ka një interes të siguroshëm.

Përgjigjja e mbërritur nga AMF, pas delegimit të kërkesës nga Ministria e Rindërtimit

Ministria e Shtetit për Rindërtimin na dërgoi përgjigje në datë 29 shtator 2021. Përgjigjen për pyetjen e parë MSHR e delegoi tek Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare. Përgjigja për këtë pyetje nga AMF mbërriti në Faktoje në datë 25 tetor 2021.

Më poshtë paraqiten 4 pyetjet drejtuar Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin, argumentimi dhe arsyeja e kërkesës si dhe përgjigjia e marrë nga autoritetet publike (MSHR dhe AMF).

1 Për objektet e dëmtuara nga tërmeti të cilat kanë qenë të financuara me kredi bankare dhe të siguruar plotësisht apo pjesërisht, ju lutemi na informoni se si janë të përfshira në procesin e rindërtimit? Cilat janë aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë proces? A përfitojnë nga fondet e Rindërtimit dhe si llogaritet kjo? Ju lutemi na vini në dispozicion bazën ligjore përkatëse që e rregullon këtë çështje.

Arsyeja dhe rëndësia: Individë, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga tërmeti mund t'i kenë blerë objektet e tyre të banimit me kredi bankare dhe kanë ende gjendje të pashlyer. Këta individë, këto banesa mund t'i kenë të siguruar nga dëmtimet e tërmetit si iniciativë personale apo kërkesë e Bankës që ka dhënë kredinë. Nëse individ përfiton dëmshpërblim nga kompani sigurimi për një banesë në pronësi të tij dhe pa kredi, a duhet ai të përfitojë edhe dëmshpërblim apo banesë të re nga Fondi i Rindërtimit? Gjithashtu, nëse një individ ka në pronësi një banesë e cila është e financuar me kredi bankare dhe e siguruar, ai ende nuk ka mbajtur të gjithë koston financiare për t'u bërë pronar i objektit të banimit. Ndërkohë që banka përfiton dhe mund të ketë mbrojtur ekspozimin e kredisë së dhënë duke arkëtuar nga kompani sigurimi dëmshpërblimin për dëmet nga tërmeti, a duhet individ të pajiset me një objekt të ri banimi, pa patur detyrime financiare për banesë (të cilën ende s'e ka paguar), siç kishte përpara tërmetit? A nuk duhet që Shteti të futej në rolin e Bankës dhe individ i pajisur me shtëpi, nëse ky është rasti, të kishte një kredi për të shlyer ndaj shtetit dhe jo ta përfitonte atë plotësisht? Ky proces duhet të rregullohej, si nëse individ do të përfitonte banesë të re apo për të llogaritur pjesën e

dëmshpërblimit financiar nga shteti vetëm për pjesën që nuk është e financuar me kredi bankare dhe për të cilën është i siguruar.

Pyetja jonë synonte të kuptonte si ishin parashikuar këto llogaritje për raste të tilla. Kjo edhe për faktin që buxheti i shtetit të mos mbante kosto të pajustificuara në këtë proces rindërtimi të kushtueshëm për taksapaguesit.

Përgjigja e MSHR: Bazuar në Aktin Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" parashikohet:

Neni 3 Fusha e zbatimit 1. Dispozitat e këtij akti zbatohen për verifikimin dhe rregullimin e pasojave të gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe të fatkeqësive të tjera, që shpallet në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile. 2. Autoritetet përgjegjëse të përcaktuara në këtë akt dhe organet e tjera shtetërore kryejnë procedurat për zbatimin e programeve në lidhje me rregullimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore dhe të fatkeqësive të tjera, sipas përcaktimeve të këtij akti dhe legjislacionit në fuqi për situatat e emergjencës.

Në lidhje me objektet e dëmtuara nga tërmeti të cilat kanë qenë të financuara me kredi bankare dhe të siguruara plotësisht apo pjesërisht, informacion më të detajuar lutem të kërkon pranë Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare.

Përgjigja e AMF: Referuar Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore", ose njohur si "Programi i Rindërtimit", subjektet përfituese përcaktohen në nenin 5 të tij. **Në asnjë pikë të aktit normativ nuk është përmendur kategoria e ndërtesave të cilat kanë qenë të siguruara në shoqëritë e sigurimit dhe se kjo kategori përjashtohet nga ky akt.** Vetëm në pikën 4 të nenit 5, përmendet përfitimi i një kategorie banesash, që nëse nuk kanë përfituar nga ndonjë program tjetër i rindërtimit, do të trajtohen sipas këtij akti.

Sigurimi i pronës nga humbjet, dërrmimet ose shkatërrimet në mënyrë të papritur, të paparashikuar

dhe aksidentale si pasojë e zjarrit, **tërmetit**, përmbytjet, rrufetë, stuhitë etj. rregullohet nga Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe përfshihet në klasën 8 të sigurimit (Sigurimi nga zjarri dhe rreziqet shtesë).

Rastet e objekteve të financuara me kredi bankare për të cilat është lidhur një kontratë sigurimi për efekt kredie dhe që janë dëmtuar nga tërmeti trajtohen në bazë të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". **Bazuar në kontratën individuale për secilin risk të siguruar, përfitues është Banka e cila në cilësinë e palës së tretë ka një interes të sigurueshëm.**

Përfundime: Nga përgjigjet e marra rezulton se ndonëse në këto raste banka është e mbrojtur nga policat e sigurimit, individët që kanë patur banesa të dëmtuara nga tërmeti të financuara me kredi dhe/ose të siguruara nuk janë të përjashtuar nga përfitimi prej "Programit të Rindërtimit". Nga analiza e aktit, nuk rezulton të ketë një llogaritje të veçantë për këta individë, të cilët nëse do të përfitonin një banesë tërësisht të re, nuk do kthehen në gjendjen para tërmetit, por në një gjendje edhe më të mirë, si pronarë banesash dhe të çliruar nga kredia bankare.

Faktoje ju drejtua përsëri me një kërkesë për informacion tek Autoriteti Mbikqyrjes Financiare në datë 02.12.2021, me një kërkesë në lidhje me sigurimet nga tërmeti i Nëntorit 2019 kërkuam;

- Listen e plotë në nivel përfituesi, objekti dhe vlerë nga sigurimi i pronës nga tërmeti.
- Nëse përfituesi ka qenë Banka ose Institucion Financiar i cili kishte dhënë kredinë, ju lutem na vini në dispozicion si emrin e bankës, ashtu dhe emrin e individit, i cili kishte siguruar pronën e marrë me kredi.
- Numrin total të objekteve të banimit që kanë qenë të dëmtuara nga tërmeti dhe të cilat kanë përfituar nga sigurimi i pronës nga tërmeti. Sa është vlera e përfitimit nga sigurimi i tyre?
- Sa është vlera e pa shlyer nga kompanitë e sigurimit deri më tani për rindërtimin e tërmetit?

- Sa është vlera e shlyer totale nga kompanite sigurimit deri më tani për rindërtimin nga tërmeti?
- Listën e institucioneve/objekteve publike të siguruar nga tërmeti dhe vlerë përfitimi nga sigurimi i pronës nga tërmeti. Sa ka përfituar secili institucion/objekt nga kompanitë e sigurimit?

Në përgjigjen të ardhur për Faktoje më 13 dhjetor 2021, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare shkruan:

Në vijim të kërkesës tuaj, regjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve me nr. rendor 7, datë 02.12.2021, bazuar në të dhënat që raportohen në Autoritet, deri në 30 nëntor 2021, situata me dëmet e shkaktuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe që kanë patur një kontratë sigurimi, rezultojnë si më poshtë:

Dëme të paguara		Dëme RBNS		Dëme të raportuara total	
Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
5,033	3,361,724,632	355	784,459,371	5,388	4,146,184,003
Dëme të paguara / Dëme të raportuara (%)		Dëme RBNS / Dëme të raportuara (%)		Dëme të raportuara / Totali i tregut Jo-Jetë (%)	
Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
93%	81%	7%	19%	100%	100%

Numri total i objekteve të siguruar rezultojnë 5388, të raportuara si praktika dëmsh. Vlera totale e dëmshpërblimit vlerësohet në 4,146,184,003 lekë.

Deri në fund të nëntorit 2021, si periudhë raportimi, shoqëritë e sigurimit kanë paguar 5033 praktika dëmsh, për një vlerë të përgjithshme prej 3,361,724,632 lekë. Në mënyrë të përmblodhur, nga shoqëritë e sigurimit janë paguar 93% e praktikave të dëmeve në numër, si edhe 81% në vlerë.

Pjesa tjetër e dëmeve, në vlerën prej 784,459,371 lekë rezultojnë në proces pagese nga shoqëritë e sigurimit.

Për këtë ngjarje, në numër rezultojnë 86% përfitues të cilët kanë siguruar pronën për efekt kredie.

Referuar kërkesës tuaj për lista emërore, në nenin 71 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", parashikohet se "Shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit janë të detyruar të ruajnë konfidentalitetin e të dhënave, faktëve dhe rrethanave që kanë të bëjnë me të siguruarit, të dhëna me të cilat njihen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre".

Përgjigja e AMF për Faktoje, 13 dhjetor 2021

- 2 Për objektet e dëmtuara nga tërmeti që kanë patur funksione komerciale, a janë përfshirë në procesin e përfitimit me fondet e rindërtimit? Ju lutemi na informoni si për objektet komerciale, ato të siguruar dhe ato të pasiguar.

Arsyeja dhe rëndësia: Së pari, me anë të kësaj pyetjeje kemi kërkuar të kuptojmë nëse objektet komerciale përfitojnë nga programi i rindërtimit dhe në ç'mënyrë. Së dyti, subjektet tregtare dhe bizneset, si pjesë e veprimtarisë së tyre duhet të mendojnë të sigurohen për raste fatkeqësie. Kompensimi i dëmeve nga Shteti, jo vetëm do rëndonte taksapaguesit, por edhe do krijonte një risk moral në lidhje me nxitjen e sjelljes së bizneseve duke mos u siguruar në të

ardhmen për këto fatkeqësi. Qeveria duhet të nxisë sigurimin nga bizneset, në mënyrë që nesër të jenë më resilient ndaj fatkeqësive. Ndërkohë një ringritje e shpejtë e bizneseve do të kontribuonte në një ringritje të shpejtë të zonave të dëmtuara nga tërmeti dhe punësimit në këto zona.

Përgjigja e MSHR: Programi i masave të rimëkëmbjes sociale dhe ekonomike është një nga programet e rindërtimit, sipas Aktit Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", ku parashikohet:

Neni 5 Subjektet përfituese pika 2. Tregtarët ose shoqëritë tregtare, të cilëve si pasojë e fatkeqësisë natyrore i është dëmtuar selia e tyre ose çdo vend i ushtrimit të aktivitetit tregtar, në pronësi të tyre, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, përveç kur është parashikuar ndryshe në këtë ligj, mund të përfitojnë vetëm nga programi i masave për rimëkëmbjen ekonomike, sipas parashikimeve të këtij akti.

Neni 30 Masa për rimëkëmbjen ekonomike, pika 1. Me qëllim favorizimin e rimëkëmbjes në sektorin e turizmit, të tregtisë, zejeve, agro-turizmit, blegtorisë dhe bujqësisë, sektorin e prodhimit, ngrihet skema e mbështetjes së rimëkëmbjes financiare të zonave të prekura nga fatkeqësia. 2. Skema e mbështetjes së rimëkëmbjes ekonomike përfshin, midis të tjerave: a) **dhënien e përfitimeve të papunësisë** për punëmarrës që kanë mbetur të papunë për shkak të shembjes ose të dëmtimit të vendit të punës ose për shkak të zhvendosjes, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, e vërtetuar me dokumente zyrtare; b) **mbështetjen financiare të shoqërive tregtare, të vogla dhe të mesme**, vendet e kryerjes së aktivitetit të të cilave janë dëmtuar dhe/ose zhvendosur për shkak të fatkeqësisë natyrore, vërtetuar me dokumente zyrtare, **me qëllim rikonstruksionin e shpejtë ose sigurimin e mjediseve të përshtatshme** për kryerjen e veprimtarisë nga punëmarrësit. 3. **Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin masa për të mbështetur sektorin privat**, me qëllim rimëkëmbjen ekonomike **sipas mundësive të veta buxhetore ose duke kërkuar financim për projekte**

të caktuara nga fondi i rindërtimit. 4. Kushtet, kriteret dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e **masave të rimëkëmbjes ekonomike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.**

Përfundime: Nga përgjigjja më lart, kuptojmë që subjektet komerciale përfitojnë vetëm nga programi i masave për rimëkëmbjen ekonomike dhe jo nga masa të tjera siç mund të jetë pajisja me një godinë të re apo rindërtimi i plotë i asaj të dëmtuar. Ndryshe nga individët dhe familjet, ata nuk janë subjekte përfituese për masa të tjera të parashikuara në Programin e Rindërtimit, si pajisja me një godinë të re nga Shteti. Kërkohej një nivel transparence në lidhje me sa subjekte komerciale dhe lista e tyre, kanë përfituar nga masat për rimëkëmbje ekonomike gjatë kësaj periudhe dhe çfarë masash kanë marrë njësitë vendore për të asistuar shoqëritë tregtare të vogla dhe të mesme si me burimet e veta apo duke përdorur fondin e rindërtimit konform ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Një analizë e alokimit të fondeve të rindërtimit me VKM do të na tregonte sa biznese dhe në çfarë vlere janë mbështetur nga Shteti gjatë kësaj periudhe të vështirë për to.

3 Për objektet komerciale që ndodhen në pallatet e banimit të klasifikuara për shembje, a do të përfshihen në përfitimin e objekteve të reja? Nëse janë njësi banimi, por janë të përdorura për njësi komerciale (dyqane në katet e para) kompensimi i tyre do të jetë në njësi banimi në lekë apo hapësira të reja, dhe këto hapësira do të jenë sërish në katet e para të banimit? Ju lutem na vini në dispozicion bazën ligjore përkatëse që e rregullon këtë çështje.

Arsyeja dhe rëndësia: Më anë të të kësaj pyetjeje Faktoje, përveç trajtimit në pikën dy, kërkoi të kuptojë trajtimin që do i bëhet objekteve komerciale në godina banimi që gjenden në katet e para të tyre. Shumë qytetarë i kanë kthyer objektet e banimit në katet e para në objekte komerciale të cilat i japin me qira dhe gjenerojnë të ardhura. Faktoje kërkoi të kuptonte që nëse objektet e përbashkëta të banimit

do të shembeshin për t'u rindërtuar në një vend tjetër ose të njëjtin, këta individë që kanë patur banesa në katet e para si objekte komerciale, çfarë do të përfitonin? Objekt banimi apo objekt komercial në katet e para të godinave të reja të banimit që do ndërtohen? Shumë qytetarë mund të bëjnë rezistencë në lidhje me këtë çështje. Gjithashtu nëse objektet e reja të ndërtuara do kenë kate komerciale në katet e para, kush do t'i përfitonte këto njësi?

Përgjigja e MSHR: Lutemi referojuni Aktit Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".

Përfundime: Përgjigjja e MSHR është një përgjigje e përgjithshme dhe nuk na adreson në nene specifike të aktit ligjor që rregullon programin e rindërtimit. Nga analiza e aktit rezultoi se shteti merr përsipër pajisjen me banesë sipas kushteve dhe kriterëve, por nuk i pajis ata me njësi shërbimi. Pra një person në katin e parë të një objekti për t'u prishur, mund të kompensohet me një objekt banimi në katet e larta të ndërtesës së re. Faktoje nuk mori një përgjigje më e zauruese për këto raste specifike të qytetarëve. Më poshtë një analizë e neneve të Programit të Rindërtimit.

Në nenin 19 të Programit të Rindërtimit, Zhvillimi i objekteve dhe/ose zonave të reja dhe i infrastrukturës publike nga autoritetet Shtetërore, pika 9, thuhet "Me përfundimin e ndërtimit të objekteve të reja, njësia zbatuese, përgatit listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës **të njësive të banimit dhe shërbimit**, nëse ka, dhe ia përcjell Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave me vendim i kalon objektet e reja në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore ose autoritetit përgjegjës shtetëror."

Ndërsa në pikën 13 të po këtij neni thuhet "Në rast se pas plotësimit të nevojave për strehim të subjekteve përfituese nga ky akt, ka njësi banimi të lira, ato administrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse, me qëllim plotësimin e nevojave për strehim, në përputhje me parashikimet e ligjit për strehimin social. **Njësitë e shërbimit në objektet e reja, nëse ka, mbeten në pronësi dhe përdoren për nevoja të funksioneve**

administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore ose të autoritetit përgjegjës shtetëror.

Ndërsa në nenin 21, Rindërtimi i objekteve të shembura nga fatkeqësia natyrore në të njëjtin truall, pika 2 thuhet: **“Përfitues të njësive të banimit në objektet e reja janë pronarët e njësive të banimit të objekteve të shembura, në trojet e të cilave ndërtohen objektet e reja.** Struktura e njësisë së banimit që i kalohet përfituesve **nuk duhet të jetë më e madhe se struktura e njësisë së banimit që përfituesi kishte në pronësi në objektin e shembur.** Rregulla për trajtimin e mospërputhjeve midis sipërfaqeve dhe strukturës së njësisë së banimit përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon strehimin.”

Në pikën 9 të këtij neni thuhet: “Në rast se, pas plotësimit të nevojave për strehim të subjekteve përfituese, sipas këtij neni, ka njësi banimi të lira, ato përdoren për subjekte të tjera përfituese, sipas parashikimeve të këtij akti dhe zbatohen, për aq sa është e mundur, rregullat dhe procedurat e parashikuara në nenin 19, të këtij akti. **Në çdo rast, njësitë e shërbimit në objektet e reja, nëse ka, mbeten në pronësi dhe përdoren për nevoja të funksioneve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore ose të autoritetit përgjegjës shtetëror.**”

Nga sa më lart kuptojmë që edhe nëse godina e re do të ndërtohet në truallin ekzistues, banorët që kishin kthyer njësitë e tyre si njësi shërbimi/ose pjesërisht të tilla, nuk do përfitojnë njësi shërbimi në objektet e reja. Këto njësi shërbimi, nëse ka, janë pronë e njësive vendore.

Qeveria ka deklaruar në media se caktimi i banesës së re brenda njësive të reja të banimit kolektiv do të kryhet me short. Ndërkohë, nëse individit ose familja që ka patur një njësi banimi të kthyer në njësi shërbimi dhe që është për t’u rindërtuar, (por familja jetonte në një banesë tjetër), pyetja për përfitim nga programi i rindërtimit për objektin e dëmtuar trajtohet në vijim.

- 4 Për objektet e dëmtuara nga tërmeti të cilat janë shtëpi e dytë (si psh. shtëpi pushimi) a përfitojnë nga fondet e rindërtimit? Ju lutem na vendosni në dispozicion bazën ligjore që e rregullon këtë proces.

Arsyeja dhe rëndësia: Më anë të kësaj pyetjeje Faktoje është munduar të kuptojë kush përfiton nga fondet e rindërtimit. A përfitojnë ata që kanë të dëmtuara shtëpitë e dyta (si ato të pushimit) çka do rriste barrën për buxhetin e shtetit dhe taksapaguesit të cilët kanë marrë në mënyrë solidare koston e strehimit të familjeve të dëmtuara? Gjithashtu objekte të dyta të banimit nuk janë domosdoshmëri, por investim ose “luks” dhe si të tilla duhet nxitur sigurimi i tyre në rast fatkeqësie. Kompensimi i dëmeve nga Shteti jo vetëm do rëndonte taksapaguesit, por edhe do krijonte një risk moral në lidhje me nxitjen e sjellje të qytetarëve duke mos u siguruar në të ardhmen për këto fatkeqësi. Ndërkohë a shihet certifikata familjare për ata individë që janë brenda të njëjtës familje, por kanë prona në emër të dy individëve të ndryshëm brenda familjes? A kompensohen ata? Po shtëpitë e plazhit?

Përgjigjia MSRR: Neni 5 *Subjektet përfituese*, Akti Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” parashikon:

- Subjekte përfituese janë individët dhe familjet, që kanë humbur një ose më shumë anëtarë të familjes dhe/ose kanë pësuar dëme në banesat e tyre dhe kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe institucionet publike që kanë pësuar dëme në ndërtesat apo infrastrukturën publike në pronësi apo në administrim të tyre, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore.
-
- Nuk është subjekt përfitues individit ose familja që ka në pronësi ose posedim të ligjshëm, më shumë se një banesë, në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, pavarësisht nëse banesa që është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore ka qenë vendbanimi i zakonshëm. Në rast se të gjitha

banesat në pronësi ose në posedim janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, individit ose familja përfiton, sipas parashikimeve të këtij akti, vetëm për banesën që në datën e fatkeqësisë natyrore përdorej si vendbanim i zakonshëm.

Përfundime: Nga sa më lart kuptojmë që kriteri ligjor është “kanë mbetur të pastrehë” dhe ky kusht është për individë dhe familje. Zbatimi rigoroz i këtij kriteri duhet vlerësuar dhe bërë objekt transparence. Edhe FMN ka kërkuar të bëhet transparente lista e përfituesve nga fondet e rindërtimit. Gjithashtu në pikën 3 të nenit të cituar nga MSRR thuhet: “Më shumë se një banesë, në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore...” dhe kjo mund të lexohet si vetëm nëse ke më shumë se një banesë në të njëjtën njësi (dy banesa në Durrës dhe është dëmtuar një, nuk përfiton) dhe jo kur banesën e ke në një njësi tjetër ose në një njësi ku nuk është

shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore (një banesë të dëmtuar në Durrës dhe një në Vlorë). Ndërkohe pika 1 ka kriterin që individit dhe familja duhet të kenë mbetur të pastrehë për të përfituar. Nga sa më lart, duhet parë zbatimi dhe bërë transparencë për përfituesit për të ulur rrezikun e abuzimit dhe përfitimit për shtëpi të dyta nga individë dhe familje, me fonde publike. Kjo edhe për individët që janë brenda një certifikate familjare.

Për çështjet e ngritura më lart, dhe për të nxitur transparencën dhe trajtimin e drejtë të nevojave të qytetarëve, Faktoje ka hapur portalin “Fakto dhe ti”. Nëse qytetarët kanë ankesa apo shqetësime për trajtimin në realitet të çështjeve të sipërcituara, por edhe çështje të tjera në procesin e rindërtimit, Faktoje u jep mundësinë që ankesën ta dërgojnë në rubrikën “Fakto dhe ti” dhe gazetarët e ndjekin atë me institucionet përkatëse.



TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA

Shqipëria u përball me pasojat e tërmetit të Nëntorit 2019. Kur kanë kaluar dy vjet nga kjo ngjarje, transparenca me procesin e rindërtimit vijon të mbetet çështje diskutimi. Në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, **“Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”** ose siç njihet Programi i Rindërtimit, qeveria ndër të tjera është angazhuar për dy elemente thelbësore.

Parimi i informimit dhe transparencës – “Autoritetet publike bëjnë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.”

Parimi i kontrollit dhe përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve – “Çdo aktivitet ose shpenzim i kryer për realizimin e qëllimit të këtij akti normativ i nënshtrohet kontrollit të ligjshmërisë, auditimit financiar dhe të performancës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.”

Gjithashu po në këtë akt parashikohet që menaxhimi, përdorimi dhe transferimi i Fondit të Rindërtimit **“kryhet sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe ligjit përkatës për buxhetin vjetor.”**

Institucione dhe parnterë ndërkombëtarë, që në fillim vunë theksin tek transparenca dhe llogardhënia ku ndër të tjera kërkuar që Kontrolli i Lartë i Shtetit të auditonte procesin e rindërtimit. Ky proces edhe sipas Programit të Rindërtimit duhet të kryhej në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e buxhetit në Shqipëri.

C.1. Raportimi i Buxhetit Faktik 2020

Në kuadër të raportimit në Kuvend për buxhetin faktik të vitit 2020, janë paraqitur edhe raportet përkatëse të publikuara në faqen e Kuvendit.

(<https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/54637>).

Në raportin e zbatimit të buxhetit **“Programi i Rindërtimit nga Tërmeti” zë në total vetëm 2 faqe të raportit** jepen vetëm në vija të përgjithshme të dhënat për fondet e përdorura për vitin 2020, por jo detajime për projektet dhe ecurinë e tyre. **Po kështu relacioni shoqërues i titulluar “Raport mbi Përdorimin e Fondeve Buxhetore për Rindërtimin Viti 2020, është vetëm dy faqe** dhe paraqet të dhëna të përgjithshme.

(https://www.parlament.al/Files/Lajme/Dokument/projektligje/Fondit_Rindertimit_vitin_2020.pdf)

Detajimi i Fondit të Rindërtimit u krye në përputhje me ecurinë e procedurave të ndërlikuara të identifikimit dhe vlerësimit të dëmeve; verifikimit të kërkesave për dëmshpërblime dhe projektimit e zbatimit të investimeve publike. Sipas planit, Fondi i Rindërtimit do të financonte:

- 5.7 miliardë lekë në sektorin e arsimit (rreth 160 objekte arsimore)
- 6.8 miliardë lekë në sektorin e strehimit (rreth 4,500 shtëpi individuale dhe 11,000 apartamente)
- 10.7 miliardë lekë grante rindërtimi
- 1.9 miliardë lekë infrastrukturë publike (rreth 28 objekte)

Gjatë vitit 2020, në zbatim të Vendimeve të Këshillit të Ministrave, për procesin e rindërtimit janë akorduar fonde si më poshtë:

- Nga fondi i planifikuar prej 29 miliardë lekësh nga Shpenzimet e buxhetit, janë akorduar 25 766 256 mijë lekë. Nga këto:
 - 405 970 mijë lekë, janë akorduar për shpenzime korrente për Njësitë e Qeverisjes Qendrore.
 - 10 451 539 mijë lekë janë akorduar shpenzime për investime për Njësitë e Qeverisjes Qendrore.
 - 14 908 747 mijë lekë janë akorduar si trasferte e pakushtëzuar për Njësitë e Qeverisjes Vendore.
- Nga fondet grante të parashikuara prej 3 miliardë lekësh janë shpërndarë në zbatim te VKM-ve rreth 2 311 738 mijë lekë.

Deri në 31 dhjetor 2020, nga Fondi i Rindërtimit u akorduan fonde në projekte specifike në masën 28.1 miliardë lekë. Nga këto, u shpenzuan nga njësitë zbatuese 15.3 miliardë lekë, ose 54.3% e fondeve të akorduara; ndërsa pjesa tjetër është mbartur në buxhetin e vitit 2021 në formën e transfertës së pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore dhe për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në përputhje me parashikimet e veçanta ligjore.

45.8% e fondeve të rindërtimit u shpenzuan nga njësitë e qeverisjes qendrore:

- Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FZSH) shpenzoi 6.4 miliardë lekë (nga 9.9 miliardë të akorduara) për rindërtimin

Raporti i Zbatimit të Buxhetit Vjetor

**RAPORT MBI PËRDORIMIN E FONDEVE BUXHETORE
PËR RINDËRTIMIN VITI 2020**

Ligji nr.88/2019 "Për Buxhetin e vitit 2020" miratoi Fondin e Rindërtimit në masën 20 miliardë lekë në nivel total vjetor, ndërkohë që Neni 7 përcakton përdorimin i tij si më poshtë:

"Fondi i Rindërtimit prej 20 miliardë lekë, i cili përdoret për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019, përbëhet nga:

- Grante 7 miliardë lekë
- Shpenzime të buxhetit të shtetit 13 miliardë lekë

Fondi prej 20 miliardë lekë, shkon kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi, të miratuar në tabelën 1, të nenit 11 të këtij ligji.

Çdo e ardhur në formë granti me destinacion përballimin e pasojave të tërmetit, mbi tavanin prej 7 miliardë lekë, rrit në të njëjtën masë të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit të Rindërtimit, duke shtuar kufijtë e përcaktuar në nenin 1, 2, 8 dhe 11, si dhe kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, të nenit 11, të këtij ligji.

Në fund të vitit buxhetor, fondet e dashpëzuara trashëgoohen në vitin pasardhës dhe përdoren për

Raporti mbi fondin e rindërtimit 2020

Mesazhet kryesore të këtyre dy raporteve janë:

- Sipas planit të vitit 2020, fondi rindërtimit do të financonte:
- 5.7 miliardë lekë në sektorin e arsimit (rreth 160 objekte arsimore)
- 6.8 miliardë lekë në sektorin e strehimit (rreth 4,500 shtëpi individuale dhe 11,000 apartamente)
- 10.7 miliardë lekë grante rindërtimi
- 1.9 miliardë lekë infrastrukturë publike (rreth 28 objekte)
- Deri në 31 dhjetor 2020, nga Fondi i Rindërtimit u akorduan fonde në projekte specifike në masën 28.1 miliardë lekë.
- Nga fondi i planifikuar prej 29 miliardë lekësh nga Shpenzimet e buxhetit, janë akorduar
- 25 766 256 mijë lekë
- Nga fondet grante të parashikuara prej 3 miliardë lekësh janë shpërndarë në zbatim te VKM-ve rreth 2 311 738 mijë lekë.
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FZSH) shpenzoi 6.4 miliardë lekë (nga 9.9 miliardë të akorduara) për rindërtimin e 1,978 shtëpive individuale (nga 2,500 të planifikuara në të gjitha vitet); 2,918 apartamenteve (nga 4,500 të planifikuara);

përfundimin e rindërtimit/rikonstruksionit të 29 nga 37 objektet shkollë të planifikuara; si dhe punime në katër nga nëntë zona të infrastrukturës publike

- Bashkia Tiranë shpenzoi 2.2 miliardë lekë (nga 11 miliardë të akorduara), për hartimin e projekteve dhe planeve të zhvillimit për zonat e reja; identifikimin dhe vlerësimin e dëmeve në territorin e saj, ndërtimin e objekteve shkollë; infrastrukturës publike dhe shtëpive individuale; si dhe grantet e rindërtimit.



- 11 bashkitë (përfshirë Tiranën) paguan rreth 7.25 miliardë lekë si grante rindërtimi për familjet e prekura nga tërmeti, nga 10.3 miliardë të miratuara. Rreth 44% e këtyre fondeve janë miratuar në bashkinë Durrës (lëvruar 3.6 miliardë nga 4.6 miliardë të akorduara); ndjekur nga Tirana (1 miliard lëvruar nga 1.2 miliardë akorduar) dhe Shijaku (0.7 miliardë lëvruar nga 1.3 miliardë miratuar). Deri në janar 2021, u paguan rreth 28,000 grante rikonstruksioni, nga mbi 33,000 të miratuara. Procesi i shqyrtimit dhe verifikimit të kërkesave vijoi edhe në vitin 2021.
- Në dhjetor 2020, ishin akomoduar në apartamente me qira 13,325 familje, të subvencionuara nga shteti; ndërkohë që disa qindrave iu dorëzuan banesat e reja. Vetëm 680 familje ishin ende në tenda në dhjetor 2020, kryesisht për arsye private, nga 12,000 familje në tenda në dhjetor 2019.
- Deri në dhjetor 2020, u finalizuan në marrëveshje konkrete 94% e granteve (277 milionë euro) dhe 11% e huave (90 milionë euro); ndërsa 1.1 milionë euro grante dhe 160 milionë euro hua ishin në proces negociimi.

C.2. FMN

Në datë 12 Tetor 2021, FMN botoi deklaratën përmbyllëse të stafit të FMN ku paraqiten gjetjet paraprake të misionit në Shqipëri. Në këtë deklaratë theksi vihet edhe tek procesi rindërtimit dhe transparenca e tij.

Sipas FMN: *“Masa për transparencën dhe llogaridhënien për shpenzime të kryera nën procedurat e emergjencës duhet të implementohen sa më shpejt dhe përdorimi i fondeve të rindërtimit nga tërmeti duhet të jetë subjekt i kontrolleve të Menaxhimit Financiar Publik. Ne mirëpresim procesin për implementimin e një regjistri publik për pronarët përfitues dhe përfundimin dhe publikimin e raportit të auditimit të KLSH për shpenzimet e tërmetit dhe pandemisë në vitin 2020.”*

Nga sa më lart FMN rithekson nevojën për nxitjen e transparencës dhe llogaridhënies. Ndër të tjera ajo kërkon të bëhet publike lista e përfituesve nga fondet e rindërtimit si instrument kryesor. Në mungesë të një liste të tillë Faktoje ka kërkuar vazhdimisht publikim e saj për të gjithë përfituesit nga fondet e rindërtimit. Gjithashtu FMN kërkon që siç parashikohet në ligj, shpenzimet për rindërtimin të jenë brenda kontrolleve të përcaktuara për menaxhimin e sistemit buxhetor ashtu si çdo shpenzim tjetër. Ajo vë theksin tek roli i KLSH dhe mirëpret raportin e auditimit në lidhje me fondet e përdorura për rindërtimin dhe pandeminë.

C.3. KLSH

Në Tetor 2021, KLSH publikoi raportin e auditimit *“Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin dhe Komisionit Shtetëror të Rindërtimit”*. Ky raport paraqet gjetjet kryesore mbi procesin e rindërtimit dhe përdorimin e fondeve për këtë proces si dhe për pandeminë. Konkluzionet kryesore të këtij auditimi u bënë pjesë edhe e Raportit mbi Zbatimin e Buxhetit për vitin 2020 që KLSH ka dorëzuar dhe prezantuar së fundmi në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Shqipërisë.

KLSH në raportimin e saj për procesin e rindërtimit ka qenë kritike ndaj Qeverisë Shqiptare. Disa nga përfundimet kryesore të auditimit të kryer janë si më poshtë vijon.

Sipas KLSH, *veprimtaria e MSHR-së për ndjekjen dhe bashkërendimin e veprimtarisë së ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit ka shfaqur mangësi në drejtim të dokumentimit të saj. Mungesa e dokumentimit të plotë është theksuar në çdo gjetje kryesore.*

KLSH identifikon këto probleme:

- **Mungon në mënyrë të dokumentuar evidentimi** i burimeve të brendshme, materiale dhe njerëzore, që disponojnë institucionet, publike e shtetërore, dhe përcaktimin e mënyrës së përdorimit të tyre;

- Ndjekja e zbatimit të përgjegjësive dhe detyrave të ngarkuara për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për trajtimin e shtetasve që kanë humbur familjarët dhe/ose kanë mbetur të pastrehë **nuk është dokumentuar plotësisht;**

- Ndjekja e zbatimit të përgjegjësive dhe detyrave të ngarkuara për strukturat e posaçme, të ngritura me ligj apo vendim, për përballimin e pasojave të shkaktuara nga tërmeti është **karakterizuar nga rutina e përditshme, pa e dokumentuar atë plotësisht;**

- **Informacionet** mbi mënyrën e përdorimit dhe eficiencën e arritur për çdo donacion apo mbështetje të ofruar nga organizatat shtetërore dhe organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë etj. **janë të paplota;**

- Ushtrimi i kompetencave të veta në lidhje me raportimin dhe ngarkimin me detyra të strukturave të mbrojtjes civile; krijimin e grupeve të punës dhe organizmin e veprimtarive për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit; bashkërendimin e punës me ministritë dhe institucionet shtetërore për sigurimin e të dhënave të nevojshme në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit për përballimin e pasojave dhe zbatimin e programeve të procesit të rindërtimit **është kryer në mungesë të dokumentimit të kësaj veprimtarie.**

KLSH është kritike edhe ndaj punës së Komisionit Shtetëror të Rindërtimit. **Gjetja kryesore është që nuk ka një program të përgjithshëm rindërtimi, vendimmarrja nuk është mbështetur në planifikim të mirëfilltë dhe nuk ka monitorim periodik të ecurisë së procesit të rindërtimit duke mos siguruar kështu transparencë për performancën e procesit.**

KLSH ka konkluduar:

- **Nuk ka hartuar, miratuar dhe përcjellë për miratim Programin e përgjithshëm të rindërtimit, dokument mbi të cilin do të mbështetej procesi i rindërtimit.** Mungesa e këtij dokumenti të miratuar nga KSHR dhe KM, përmban riskun e cënimit të efektivitetit, eficiencës, dhe ekonomicitet të procesit të rindërtimit, si rezultat se **vendimmarrja nuk është**

mbështetur mbi një planifikim të mirëfilltë, por është kryer rast pas rasti;

- **Nga ana tjetër, mungesa e monitorimit të mirëfilltë dhe periodik të procesit të rindërtimit nga KSHR, si dhe mungesa e raporteve (nga KSHR) për KM-në,** nuk ofron siguri mbi performancën e procesit të rindërtimit, përmban riskun e mosmarrjes në kohë të masave të nevojshme për përmirësim, si dhe **nuk siguron transparencë** mbi rezultatet e masave të ndërmarra deri më tani për përballimin e situatës së krijuar nga tërmeti i nëntorit 2019;

C.4. Portali i Rindërtimit

Publikuar më 18.11.2021 në faktoje.al

“Duke iu referuar transparencës, portali unik qeveritar që kemi për rindërtimin, pra website i rindërtimit për dijeninë tuaj (mund edhe ta check-oni, të na mësoni, të na kritikoni ose të na vini në dukje çfarë duhet të përmirësojmë), përditësohet minimalisht një herë në dy ditë”- deklaroi në 22 korrik 2020 Ministri i Shtetit për Rindërtimin, Arben Ahmetaj gjatë një komunikimi për mediat lidhur me transparencën në kuadër të procesit të rindërtimit.

Akti Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 10, i cili ka në fokus parimin e informimit dhe transparencës specifikon: **Autoritetet publike bëjnë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.** Ndërkohë sipas nenit 38, i po këtij akti, dëshmohej krijimi i portalit unik qeveritar në funksion të transparencës së procesit të rindërtimit dhe kriteret që duhet të përmbushë.

Portali unik qeveritar do të duhet të zbatonte prej rreth dy vitesh tashmë, pikat e sipërpërmendura për të përmbushur objektivat e transparencës.

Në mbledhjen e katërt të Komitetit Kombëtar të Rindërtimit, që u mbajt më 12 shkurt 2021, ministri Ahmetaj theksoi:

“Portali unik që iu referua kryeministri, ne tani e kemi aktiv, por gjithsesi edhe kjo është punë në proces.

Neni 38 Transparenca

1. Në funksion të transparencës të përdorimit të fondeve të procesit të rindërtimit krijohet portali unik qeveritar.
2. Portali unik qeveritar publikon informacione ku përfshihen, por nuk kufizohet vetëm në:
 - a) programin kombëtar të rindërtimit;
 - b) të dhëna mbi fondin e rindërtimit, burimin e krijimit të tij, kontributet në para dhe kontributet në natyrë dhe mënyrën e shpenzimit të këtij fondi;
 - c) projektet e realizuara;
 - d) zonat e zhvilluara dhe zonat në zhvillim;
 - e) vendimet e autoriteteve përgjegjëse;
 - f) të dhëna mbi procedurat e prokurimit në funksion të procesit të rindërtimit.
3. Në publikimin e informacionit përdoren, për aq sa është e mundur, parimet e *Open Data*.

Neni 38 i Aktit Normativ nr.9 datë 16.12.2019

Praktikisht këtu do të kemi të gjithë informacionin për rindërtimin, zonë më zonë, proces për proces, shtëpi për shtëpi, donacion për donacion, aktivitetet për aktivitetet."

Gjatë kontrollit të platformës së rindërtimit (rindertimi.gov.al), më datë 11 nëntor 2021, Faktoje evidentoj kategoritë, të cilat figurojnë në këtë portal për të verifikuar transparencën dhe raportimin e procesit. Ato listohen si më poshtë:

Paketa Ligjore ka të përfshira Ligje, Akte Normative dhe Vendime, në të cilat haset vështirësi për të gjetur


informacionin e nevojitur, pasi shoqërohen vetëm me datat përkatëse, në mungesë të një emërtimi referues të vendimit.

"Programet e Rindërtimit", që sipas nenit 38 të Aktit Normativ, duhet të disponojnë të dhëna mbi fondin e rindërtimit, burimin e krijimit, projektet e realizuara, grantet apo përfituesit e projektit, të cilët janë prekur nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 etj. Ndërkohë në këtë kategori nuk figurojnë të dhëna specifike, mungon informacioni se kush po rindërton, sa kantiere janë etj. Ajo çfarë evidentohej janë nënkategoritë të cilat përmbajnë programet e mëposhtme:


"Ndërtimi i objekteve të reja". Kjo nënkategori paraqet të dhëna të përgjithshme rreth funksionimit të procesit të rindërtimit, ku figuron i bashkangjitur Akti Normativ nr. 9 datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", por nuk rezulton asnjë e dhënë se cilat janë objektet e reja të ndërtuara, cilat janë ato të përfunduara apo në proces.

"Infrastruktura publike dhe kritike" sërisht paraqitet vetëm një informacion i përgjithshëm ku figuron i bashkangjitur Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019.

"Krijimi i fondit të banesave" është një tjetër nënkategori e përfshirë në Programin e Rindërtimit. "Për nevoja të strehimit të familjeve të prekura nga fatkeqësia natyrore, Enti Kombëtar i Banesave, sipas



Portali i rindërtimit, datë 18 nëntor 2021



Screenshot, portali Unik Qeveritar rindertimi.gov.al

përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave dhe/ose njësitë e vetëqeverisjes vendore, krijojnë fondin e banesave të nevojshme për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore, që konsiston në banesat e blera me fonde nga fondi i rindërtimit në tregun e lirë, si dhe nga banesat e dhuruara nga subjektet e treta në favor të shtetit, me qëllim përballimin e fatkeqësive natyrore”, ky është i vetmi informacion i publikuar në këtë nënkategori.

Në këtë proces transparenca mbi **“Grantet e rindërtimit”**, ka rëndësi të lartë, por evidentojmë se në këtë hapësirë paraqitet informacioni se cila kategori përfiton grantet e rindërtimit apo të rikonstruksionit, por nuk ka të dhëna se kush janë përfituesit, vlerat e grantit apo si po vijon procesi.

Grantet e rindërtimit

Postuar më 14/02/2020

Grantet për rindërtimin e banesës

1. Përfitojnë grante ndërtimi ose rikonstruksionit, sipas projekteve model, familjet e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, shtëpitë e banimit individuale të cilëve janë klasifikuar si objekt i dëmtuar ose i pabanueshëm. Rregulla për projektet model, masa e përfuturit, kushtet, kriteret, procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për vlerësimin e kërkesave dhe shpërndarjen e grantit parashikohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe të lejeve të ndërtimit, për rastet që parashikohen në pikën 1, të këtij neni, zbatohen procedurat të përshpejtuara që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Ndërtimi dhe rikonstruksionit i banesave përjashtohet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifën e aplikimit të zbatueshme për lejet e ndërtimit.

Për më tepër informacion vazhdoni në linkun :<https://ata.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/PROGRAMI-I-RINDERTIMIT.pdf>

Screenshot portali Unik Qeveritar rindertimi.gov.al, kategoria programet e rindërtimit

Në nënkategorinë e fundit të Programeve të Rindërtimit **“Rimëkëmbja ekonomike sociale”**, paraqitet një përshkrim i shkurtër rreth kompensimit të dëmeve që familjet duhet të përfitojnë nga fatkeqësia natyrore.

Prokurimet

Një ndër kategoritë e përfshira në këtë platformë, janë Prokurimet. Sipas nenit 38 të Aktit Normativ (Transparenca), kjo kategori duhet të përfshijë të dhëna mbi procedurat e prokurimit në funksion të procesit të rindërtimit. Në këtë kategori përballesh me amulli informacionesh të cilat nuk kanë strukturë kërkimi kohor apo emërtime tematike, duke sjellë vështirësi në gjetjen e informacionit të dëshiruar. Kjo kategori nuk përmbush parimet e Open Data.

Për sa më sipër, rreth dy vite më parë gjatë informimit për ecurinë e procesit të rindërtimit, ministri i Rindërtimit Ahmetaj, foli rreth programeve të cilat në bazë të ligjit janë aktive në këtë platformë duke treguar specifikat e secilit prej tyre.

Prej vitit 2020 këto programe të përfshira në kategorinë “Programet e Rindërtimit” nuk rezultojnë të kenë asnjë azhurnim, dhe nuk evidentohen raporte ecurie të botuara në zbatim të programit të rindërtimit.

Janë 4 programe në bazë të ligjit, 3 nga të cilat janë aktive. Rimëkëmbja ekonomike dhe sociale, do të jetë programi i katërt, që ka të bëjë me atë që ne i referohemi "Programi Shqipëria 2030", që do fokusohet tek rimëkëmbja ekonomike.

Tre programet aktive janë (i) Rindërtimi i objekteve të reja (ajo shuma sot e alokuar dhe aktive), (ii) Grantet e Rikonstruksionit (grantet e rikonstruksionit DS1-DS3 për sqarim për ju apo për qytetarët, janë paratë cash për familjet në bazë të vlerësimit të dëmit, të cilat shkojnë nga 1 milion lekë të vjetra deri në 5 milion lekë të vjetra për të rindërtuar shtëpitë e tyre në bazë të dëmeve nga DS1- DS3). Kemi dhe (iii) Rindërtimin e infrastrukturës publike, ku 1.1 miliard që shihni të alokuara deri më tani është vetëm 20% i projekteve të hapura dhe në bazë të alokimeve në vazhdim, sigurisht që i gjithë fondi prej 34 miliardë lekësh do të jetë deri në fund të vitit i ezauruar. (iv) Rimëkëmbja, siç e theksova, do të ketë të bëjë më programin "Shqipëria 2030".

Kategoria "Shtëpia ime"

Nëse vijojmë të shqyrtojmë platformën, në fund të faqes na shfaqet edhe aplikacioni "Shtëpia ime". Në pamje të parë, çdokush do të mendonte që duke klikuar në këtë seksion do të gjeneroheshin të dhëna që kanë të bëjnë me banesat, apo me procese në vijim lidhur me to. Por, çdo klikim mbi seksionet e platformës "Shtëpia ime", të kthen tek faqja kryesore që shfaq vetëm aktivitete dhe foto të kryeministrit dhe qeverisë që kanë lidhje me tërmetin.


Kategoria "Ndiq Projektet"

Në fund të faqes së rindërtimit figuron edhe kategoria "Ndiq Projektet". Nëse provon të klikosh, ky buton të delegon në një hartë të Shqipërisë ku paraqiten të dhëna nga Planet e Përgjithshme Vendore (PPV) dhe Planet e Detajuar Vendore (PDV) të bashkive. Në këtë hartë shfaqet vështirësi për të kuptuar nëse janë të


përfshira projektet e rindërtimit dhe faza në të cilën ndodhet ky proces.

Pjesë e këtij portali është gjithashtu platforma Eu4schools, e cila mund të shërbejë si një shembull konkret se si mund të raportohet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme mbi ecurinë e proceseve.

Portali "Eu4schools" siguron informacion të detajuar dhe në kohë reale për 63 objekte arsimore të dëmtuara në nëntor të vitit 2019. Gjatë verifikimit të portalit vihet re se ka të përfshira kategori të ndryshme të cilat janë të azhurnuara dhe sigurojnë



Screenshot, aplikacioni "Shtëpia Ime", portali Unik Qeveritar



Screenshot harta e implementuar në opsionin Ndiq Projektet, faqja e rindërtimit

transparencë për procesin e rindërtimit.

Pas verifikimit të kësaj platforme, duke iu rikthyer deklaratës së muajit shkurt të ministrit Ahmetaj, mbi rëndësinë e transparencës si një nga parimet kryesore të rindërtimit, mund të themi se shumë prej kriterëve të përcaktuara në ligj për transparencën janë shkelur.

Lidhur me procesin e rindërtimit në Shqipëri, ajo çfarë Faktoje konstatoi është gjithashtu se nuk ka një kategori ku të bëhen raportime periodike, apo vjetore. Raporti i fundit rezulton të jetë në vitin 2020, mbi përdorimin e fondeve buxhetore për rindërtimin.

Ministri i Shtetit për Rindërtimin, Arben Ahmetaj, në 16 shtator 2021, ka bërë një raportim në kuadër të programit “Shqipëria 2030”, ku paraqet disa nga të dhënat e ecursisë së procesit të rindërtimit deri në atë periudhë, duke u ndalur te numri i banesave individuale dhe apartamenteve të përfunduara dhe në proces, numrin e objekteve arsimore të përfunduara dhe në proces, si dhe të dhëna rreth infrastrukturës publike etj.


C.5. Ecuria e kërkesave për informacion

Një ndër parimet e metodologjisë së verifikimit të fakteve është ndjekja e rrugës zyrtare duke kërkuar informacion nga institucionet shtetërore. Faktoje në kuadër të këtij raporti, në lidhje me procesin e rindërtimit u ka dërguar 65 kërkesa për informacion institucioneve vendore dhe qendrore, si pjesë e metodologjisë fact-checking, por dhe duke dashur që t'i ofrojë publikut një informacion të verifikuar, zyrtar dhe të besueshëm.

Gjatë këtij procesi është vënë re një “hermetizim” në dhënien e informacionit në kuadër të procesit të rindërtimit, ku përgjigjet e dërguara shpesh vonojnë përtej afatit ligjor, janë të paplota duke mos iu përgjigjur pyetjeve konkrete, çfarë e ka bërë Faktojen që të ankimojë mbi 20 raste tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit.

Publikuar më 9.8.2021 në faktoje.al

Transparenca është cilësuar si një nga parimet kryesore të rindërtimit nga ministri Ahmetaj, që në fillim të këtij procesi. Një element i rëndësishëm i transparencës është publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak, mbi përfituesit e programit të rindërtimit, nga bashkitë që ishin pjesë e këtij procesi. Faktoje



Education facility	Municipality	Type of intervention	Consultation meeting date	Construction start date	Date of handover to the beneficiary	Nr. of children in the kindergarten	Nr. of students	Before & After
14 Nëntori	Durrës	Repair				0	750	
26 Nëntori	Tiranë	Repair	29/06/2021			0	570	
3 Dëshmorët	Kavajë	Repair	07/07/2021			0	398	
Asim Vokshi	Tiranë	Repair	06/10/2021			0	750	
Azem Hajdari	Kamëz	Repair	25/06/2021			240	0	
Beqir Çela	Durrës	Reconstruction				0	350	
Bernardina Gernishi	Durrës	Reconstruction	25/05/2021			0	150	
Bernardina Gernishi	Durrës	Reconstruction	25/05/2021			0	250	
Bënusë	Vorë	Reconstruction	18/05/2021			0	361	
Çerdhe Kamëz	Kamëz	Reconstruction	25/06/2021			60	0	
Çerdhe Nr.2	Durrës	Repair				70	0	
Çerdhe Nr.3	Durrës	Repair	21/04/2021			125	0	
Charles Telford	Kavajë	Repair	23/07/2021			0	300	
Erickson	Durrës	Reconstruction	21/07/2020			0	195	
Ertali Kapi	Durrës	Reconstruction	15/12/2020			40	542	
Emin Duraku	Tiranë	Repair	27/10/2021			0	1300	
Fran Ivanaj	Lezhë	Repair	17/06/2021			47	179	
Fshati Sipë	Durrës	Reconstruction	23/06/2021			40	0	
Gjergj Kastrioti	Durrës	Reconstruction	14/10/2021			0	628	
Gjergj Kastrioti	Lezhë	Reconstruction	17/06/2021			0	631	
Ibrahim Sashë	Kamëz	Repair	28/06/2021			101	801	
Karpen	Kavajë	Repair	07/07/2021			0	200	

Screenshot, portal Eu4schools

HOME ABOUT THE PORTAL PROGRESS UPDATE Q&A GALLERY PROGRAMME DATA YOUR FEEDBACK EN AL

 Durrës	 Kamëz	 Kavajë	 Krujë	 Kurbini	 Lezhë
 Mirditë	 Rrogozhinë	 Shijak	 Tiranë	 Vorë	

Click on the education facility line to view more information about it.
Data on the program is being collected periodically and will be uploaded accordingly.

Education facility	Type of educational service	Municipality	Administrative Unit / Village	Type of intervention	Contract amount in ALL (VAT excluded)
Ismet Nanushi	9-year school High school	Durrës	Sukth/Kullë	Reconstruction	315,820,581.30 *
Ismet Nanushi	Kindergarten	Durrës	Sukth/Kullë	Reconstruction	315,820,581.30 *
Ramazan Karaj	Kindergarten 9-year school High school	Krujë	Nikël	Reconstruction	249,580,700.25
Korb Muça	Kindergarten 9-year school	Krujë	Nikël/Qerekë	Reconstruction	214,347,718.67
Eftali Koci	Kindergarten 9-year school	Durrës	Durrës	Reconstruction	171,499,798.03
Gjokë Elezi	Kindergarten 9-year school	Kurbini	Laç	Reconstruction	166,301,631.15
Sherif Dervishi	Kindergarten 9-year school	Krujë	Bubq/Budull	Reconstruction	151,408,014.10
Dom Nikollë Kaçorri	9-year school	Kamëz	Kamëz/Laknas	Repair	138,622,580.25 *
Dom Nikollë Kaçorri	Kindergarten	Kamëz	Kamëz/Laknas	Reconstruction	138,622,580.25 *
Haxhi Qira	9-year school	Krujë	Thumanë/Rorizan	Reconstruction	136,973,778.90

Consultation meeting date

Construction start date

Date of handover to the beneficiary

No. of beneficiaries

No. of children in the kindergarten

No. of students

No. of teachers

Screenshot, portal Eu4schools

kërkoi për 11 bashkitë, që u përfshinë në procesin e rindërtimit, por publikimet e rregullta të VKB-vë me listën emërore, nuk i gjetëm në shumicën e tyre dërrmuese.

Më 28 shkurt 2020, gjatë prezantimit të modeleve të reja të rindërtimit në një konferencë për shtyp, ministri i Rindërtimit, Arben Ahmetaj, theksoi transparencën si parim kyç të këtij procesi.

"I gjithë kuadri i prezantimit ka të bëjë me një nga parimet kryesore të rindërtimit, transparenca." – tha ai.

Programi i rindërtimit pas tërmetit të nëntorit 2019 është shtrirë në 11 bashki të vendit, përkatesisht në Bashkinë Tiranë, Durrës, Krujë, Kurbini, Lezhë, Kavajë, Shijak, Vorë, Kamëz, Rrogozhinë dhe Mirditë. Bashkitë ishin njësi zbatuese për identifikimin e familjeve që merrnin bonus qiraje apo përfitonin

nga programi i rindërtimit, për rikonstruksionin e banesave në varësi të dëmit. Ne kërkuam në faqet zyrtare të secilës prej këtyre bashkive, por Vendimet e Këshillave Bashkiakë për miratimin e listave të përfituesve nga programi së bashku me listën emërore të bashkëlidhur, e gjetëm vetëm në Bashkinë Durrës.

Bashkia Tiranë

Në faqen online të Bashkisë Tiranë, e cila është funksionale, mund të gjenden Vendimet e Këshillit Bashkiak në format dokumenti word. Ne kërkuam në vendimet për miratimin e listave emërore përfituese të programeve të rindërtimit, të tilla si lista e personave të dëmtuar nga tërmeti që përfitonin bonus qiraje. Në faqen e Bashkisë Tiranë, në asnjë

Kërkesat per informacion	Numri i Kërkesave të d	Numri i përgjigjeve t	Numri i ankim	Totali
Bashkia Tiranë	10 Kërkesa	7 përgjigje	3 ankimim	65 Kërkesa
Bashkia Durrës	12 Kërkesa	9 përgjigje	3 ankimim	
Bashkia Lezhë	2 Kërkesa	1 përgjigje		
Bashkia Krujë	3 Kërkesa	1 përgjigje	1 ankimim	
Bashkia Kavajë	3 Kërkesa	2 përgjigje	1 ankimim	
Bashkia Shijak	3 Kërkesa	1 përgjigje	1 ankimim	
Bashkia Mirditë	3 Kërkesa	1 përgjigje		
Bashkia Kurbin	4 Kërkesa	1 përgjigje	2 ankimim	
Bashkia Kamëz	4 Kërkesa	2 përgjigje	1 ankimim	
Bashkia Vorë	7 Kërkesa	5 përgjigje	1 ankimim	
Bashkia Rogozhinë	1 Kërkesa	1 përgjigje	1 ankimim	
Fond Shqiptar i Zhvillimit	4 Kërkesa	4 përgjigje		
Instituti i Ndërtimit	1 Kërkesa	1 përgjigje		
Ministria Rindërtimit	4 Kërkesa	3 përgjigje	4 ankimime	
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	3 Kërkesa	1 përgjigje	1 ankimim	
Enti Kombëtar i Banesave	1 Kërkesa	1 përgjigje		
Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare	1 Kërkesa	1 përgjigje	1 ankimim	

Shumica e bashkive të rindërtimit fshehin listat emërore në publikimin e VKB-ve

rast nuk gjetëm listën emërore bashkëlidhur me vendimin.

Megjithatë, versionin origjinal të së njëjtës VKB (në format pdf), e gjetëm të publikuar në faqen Vendime.al, pavarësisht se faja e Bashkisë Tiranë nuk të orienton. Kjo faqe është ndërtuar dhe mirëmbajtur nga një organizatë jo fitimprurëse, Infoçip. Në këtë version të VKB, i cili është një skanim i vendimit origjinal me vulë dhe firmë, gjetëm edhe listën bashkëlidhur.

Bashkia Durrës

Në faqen online të Bashkisë Durrës, VKB-të mund të gjenden formatin pdf, i cili është skanim i dokumentit origjinal. Vendimet për miratimin e listave emërore përfituese kanë bashkëlidhur edhe listat përkatëse. Megjithatë, në faqen e bashkisë Durrës mund të gjenden vetëm VKB që i përkasin viteve 2020 dhe 2021, ndërsa për vitin 2019, nuk figurojnë në këtë faqe.

Bashkia Krujë

VKB në faqen e Bashkisë Krujë janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me faqen Vendime.al, duke të kaluar automatikisht aty nëse kërkon vendimet. Në vendimin nr.10 të datës 30 janar 2020, shtohet fakti që lista e familjeve të miratuara me VKB nr. 106 të datës 29 dhjetor 2019 do të përfitojë qira për 11 muaj.

Por kur kërkuam në VKB-në e vitit 2019 të Bashkisë Krujë, nuk arritëm të gjejmë VKB nr. 106 të muajit dhjetor 2019 dhe si rrjedhojë as listën emërore. Kjo për shkak se VKB-të e fundit të bëra publike të Bashkisë Krujë për vitin 2019 i përkisnin muajit maj, ndërsa mungojnë VKB-të periudhën qershor-dhjetor 2019.

Bashkia Kurbin

Bashkia Kurbin aktualisht nuk ka një faqe zyrtare online, kështu nuk gjetëm asnjë VKB mbi procesin e rindërtimit. Në faqen Vendime.al, VKB e fundit e bërë publike nga Bashkia Kurbin i përket tetorit 2019, pra një muaj përpara tërmetit të 26 nëntorit 2019.

Bashkia Lezhë

Faqja zyrtare e Bashkisë Lezhë, njofton që në hyrje se kjo është faqja e re, por kur u përpoqëm të klikonim në seksionin e Këshillit Bashkiak, na u shfaq njoftimi se faqja është në ndërtim e sipër dhe rezultuan vetëm 3 VKB 'të disponueshme' gjithsej.

Nga ana tjetër, në faqen Vendime.al, mundëm të gjenim VKB-të e publikuara të Bashkisë Lezhë. Por, në VKB nr. 118 datë 16 dhjetor 2019, për miratimin e pagesës së qirasë për familjet e prekura, vendimi nuk është bashkëlidhur me listën emërore të përfituesve, ashtu siç citohet në fund të pikës 1.

Bashkia Kavajë

Faqja online e Bashkisë Kavajë nuk funksiononte në momentin kur u përpoqëm ta aksesojmë.

Vendimet e fundit të Këshillit Bashkiak të bëra publike nga Bashkia Kavajë në faqen Vendime.al i përkasin muajit shtator 2019, dy muaj përpara tërmetit, ndaj nuk mundëm të gjenim asnjë VKB të Bashkisë Kavajë, përse i përket programit të rindërtimit.

Bashkia Shijak

Ashtu si për Bashkinë Krujë, edhe faqja zyrtare e Bashkisë Shijak të drejton tek faqja Vendime.al kur përpiqesh që të aksesosh Vendimet e Këshillit Bashkiak. Në faqen Vendime.al, mundëm të gjenim VKB e Bashkisë Shijak, ku u ndalëm tek VKB nr. 3 e datës 20 janar 2021, e cila kishte si objekt miratimin e listës paraprake të familjeve që përfitojnë bonus qiraje. Por edhe në këtë VKB, nuk gjetëm listën emërore të bashkëlidhur, siç pretendohet në pikën 1.

Bashkia Vorë

Në faqen zyrtare të Bashkisë Vorë nuk ka asnjë Vendim të Këshillit Bashkiak të publikuar. Në faqen Vendime.al, Bashkia Vorë nuk kishte publikuar asnjë Vendim të Këshillit Bashkiak për vitet 2019 dhe 2020. Megjithatë, në [VKB nr. 5](#), të datës 14 janar

2021, së bashku me vendimin për ndryshimin e nivelit të dëmit nga tërmeti, kishte përfshirë edhe listën emërore të familjeve.

Bashkia Kamëz

Në faqen zyrtare të Bashkisë Kamëz numri i VKB-ve të publikuara i përket një periudhe shumë të shkurtër, me VKB më të hershme të datës 18 dhjetor 2020. Pikërisht kjo VKB me nr. 152 ka si objekt dhënien e shpërblimit financiar për familjet e dëmtuara nga tërmeti. Por në ndryshim nga sa specifikon në pikën 1, në faqe nuk është publikuar lista emërore e familjeve përfituese.

Bashkia Rrogozhinë

Bashkia Rrogozhinë nuk ka një faqe zyrtare online, por mundëm të gjenim VKB e saj në faqen Vendime.al. Në VKB nr. 40, të datës 31 dhjetor 2019, e cila ka si objekt pagesën e bonusit të qirasë për familjet e dëmtuara nga tërmeti, lista emërore e familjeve përfituese nuk është bërë publike.

Bashkia Mirditë

Në faqen e saj zyrtare, Bashkia Mirditë ka publikuar VKB për një periudhë të shkurtër, ku VKB më të hershme i përket muajit shtator 2020. Nga ana tjetër, në faqen Vendime.al, VKB-të e publikuara datojnë edhe më herët. Ne morëm si shembull VKB nr. 64 të datës 30 dhjetor 2019, ku bashkë me vendimin për shpërndarjen e bonuseve të qirave për familjet e dëmtuara nga tërmeti, është vendosur edhe lista emërore.

Nga 11 bashki që janë pjesë e procesit të rindërtimit, vetëm 3 prej tyre kanë bashkëngjitur listën emërore të familjeve përfituese në Vendimet e Këshillave Bashkiakë.

Pas dërgimit të kërkesave të përsëritura për informacion dhe ankimeve tek Komisionerit për të Drejtën e Informimit, 9 nga bashkitë e përfshira

në procesin e rindërtimit kanë sjellë listat me emrat e përfituesve. Bashkitë që kanë dërguar listat janë:

Bashkia Tiranë
 Bashkia Durrës
 Bashkia Lezhë
 Bashkia Kavajë
 Bashkia Shijak
 Bashkia Vorë
 Bashkia Kamëz
 Bashkia Rogozhinë
 Bashkia Mirditë

Aktualisht Faktoje po ndjek nëpërmjet Komisionerit për të Drejtën e Informimit ankimimet për dërgimin e listave të përfituesve për bashkitë: **Krujë dhe Kurbin**.

Me qëllim transparencën dhe nxitjen e llogaridhënies, Faktoje ka organizuar 6 takime me bashkitë Durrës, Kavajë, Lezhë, Kurbin dhe Vorë, për lehtësimin e procesit dhe firmosjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi, për dërgimin e informacioneve që me ligj na takon t'i marrim dhe t'i bëjmë publike.

Në linkun më poshtë gjeni databazën interaktive të përfituesve të bonus qiraje, grante rindërtimi apo rikonstruksioni për bashkitë: Tiranë, Durrës, Vorë, Shijak, Kavajë, Kamëz, Lezhë, Rogozhinë, Mirditë.

C.6. Ankesat e qytetarëve të përmbledhura sipas tematikave/problematikave kryesore

Në kuadër të transparencës dhe nxitjes së llogaridhënies së institucioneve përgjegjëse, Faktoje ka krijuar aplikacionin "Fakto dhe ti", që gjendet në

faqen www.faktoje.al.

26 qytetarë nga bashki të ndryshme, konkretisht bashkia Tiranë, Durrës, Vorë dhe Kurbin, kanë dërguar ankesa në lidhje me procesin e rindërtimit. Problematikat më të shpeshta që evidentohen nga banorët lidhen me vonesat e bonusit të qerasë, probleme me rivlerësimin e dëmeve që prona e tyre ka pësuar, vonesa me nisjen e procesit të rindërtimit, dhe ankesa për mospërfitim të granteve të rindërtimit/rikonstruksionit.

-9 ankesa për mospërfitim të grantit të rindërtimit/rikonstruksionit

-8 ankesa për vonesa në bonusin e qirasë

-2 ankesa për probleme me rivlerësimin

-6 ankesa për ecurinë e procesit të rindërtimit

Faktoje delegoi 18 ankesa të ardhura përgjatë periudhës Tetor-Nëntor 2021, pranë bashkive përkatëse dhe Ministrisë së Rindërtimi dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

-4 ankesa të deleguara në Bashkinë Tiranë

-9 ankesa të deleguara në Bashkinë Durrës/ 2 prej të cilave, pas përgjigjes së Bashkisë, iu deleguan edhe Ministrisë së Rindërtimit dhe një ankesë tjetër iu delegua Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

-4 ankesa të deleguara pranë Bashkisë Vorë/ 1 prej të cilave iu delegua Ministrisë së Financave

-1 ankesë e deleguar pranë Bashkisë Kurbin

Nga 18 ankesat e deleguara në total në 4 bashkitë,

	Ankesat në Fakto dhe Ti	Bashkia Tiranë	Bashkia Durrës	Bashkia Vorë	Bashkia Kurbin	Tematika
Ankesat	26 ankesa të dërguara	4 Ankesa të deleguara	9 Ankesa të deleguara	4 Ankesa të deleguara	1 Ankesë e deleguar	9 ankesa për mos përfitim të grantit të rindërtimit/rikonstruksionit
përgjigjet	12 përgjigje të ardhura	2 përgjigje	7 Përgjigje të ardhura	4 përgjigje të ardhura	1 përgjigje e ardhur	8 ankesa për vonesa në bonusin e qirasë
						2 ankesa për probleme me rivlerësimin
						6 ankesa për ecurinë e procesit të rindërtimit

Tabela e ankesave të ardhura në "Fakto dhe ti" dhe të deleguara nga Faktoje tek institucionet

RINDËRTIMI

Në fund të pranverës së vitit 2022 nuk do të ketë më asnjë gjurmë të tërmetit

Rindërtimi është sot programi më i madh urban, ekonomik e social, që garanton më shumë se veç rimëkëmbjen pas tërmetit. Çdo familje që humbi shtëpinë, do të marrë një të re, falas, të ndërtuar më mirë, më fort, më bukur, me standarde ndërkombëtare, e po njësoj të gjitha shkollat, çerdhet, kopshtet dhe objektet publike. Sot e gjithë zona e dëmtuar është një kantier ndërtimi, që ka krijuar punësim masiv dhe një impakt ekonomik të konsiderueshëm.

Screenshot, Programi i Qeverisë 2021-2025

pranë Faktoje kanë kthyer përgjigje:

- Bashkia Durrës për 7 ankesa
- Bashkia Vorë për 4 ankesa
- Bashkia Kurbin për 1 ankesë

C.7. Afatet e rindërtimit

Afatet e ndryshuara të procesit të rindërtimit

Përmbyllja e "Programit të Rindërtimit dhe Rimëkëmbjes" nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, në 11 bashki të Shqipërisë, ka patur vazhdimisht ndryshime të afateve.

Muaji mars 2022

Më datë 28 nëntor 2020, në një intervistë për rubrikën 'Opinion' në 'News24', Ministri i Rindërtimit Arben Ahmetaj deklaroi:

"Në mars 2022 nuk do të shihni asnjë shenjë të tërmetit, dhe të gjitha banesat do të jenë të rindërtuara ose rikonstruktura. Kjo është përgjigje zyrtare, por dhe personale"- deklaroi Ahmetaj.

Prill 2022

Ndërkohë në 5 prill të vitit 2021, në emisionin "5 pyetje nga Babaramo", ministri Ahmetaj specifikoi

së në **muajin prill të vitit 2022**, nuk do të ketë më asnjë gjurmë nga tërmeti.

Pranvera e 2022

Gjatë prezantimit të programit të rindërtimit, më 5 mars 2021 Ahmetaj deklaroi se **në pranverën 2022** nuk do të ketë asnjë shenjë nga tërmeti në të gjithë territorin e dëmtuar në 11 bashkitë e vendit.

Edhe në programin e qeverisë për mandatin e tretë, publikuar në shtator 2021, në seksionin për Rindërtimin, fundi i pranverës 2022, është afati i vendosur për 'zhdukjen' e çdo shenje nga tërmeti i nëntorit 2019.

Programi i qeverisë u shoqërua me deklarata të njëpasnjëshme lidhur me afatet e procesit të rindërtimit, të cilat kanë ndryshuar disa herë përgjatë këtyrë dy viteve.

Gusht 2022

Rreth 4 muaj më vonë, afatet e deklaruara nisën të ndryshonin. Ministri i Rindërtimit, Ahmetaj gjatë inspektimeve të punimeve tek lagjja "5 Maji" në Tiranë më 28 korrik 2021, deklaroi se familjet në këtë zonë do të strehohen në **muajin gusht të vitit 2022**.

'Në fund të muajit gusht do të kemi të gjithë familjarët brenda në shtëpitë e reja që po ndërtohen nga qeveria turke dhe qeveria shqiptare'.

Shtator 2022

Ky afat do të ndryshonte disa muaj më vonë, pasi në 21 tetor të vitit 2021, gjatë një vizite në Bubq ku po inspektonte ecurinë e procesit të rindërtimit, në praninë e kryeministrit Edi Rama, ministri Ahmetaj deklaroi se muaji **shtator i vitit 2022** do të shënonte përfundimin e procesit të rindërtimit.

“Dalëngadalë, deri në shtator të vitit tjetër nuk do kemi asnjë shenjë nga tërmeti”- tha ministri Ahmetaj.

Më datë 22 shtator 2021 në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, Ahmetaj ritheksoi:

“Siç e dini, rindërtimi vijon me intensitet. Sot i kaluam me VKM Fondit Shqiptar rreth 30 mln dollarë për të vijuar punën në terren që të plotësojmë atë angazhim që kemi marrë për të mbaruar punët në shtator 2022”.

Kjo deklaratë u përforcua edhe nga kryeministri Edi Rama, i cili në 28 tetor 2021 u shpreh se në **shtator të 2022** do të ketë mbaruar procesi i rindërtimit.

“Afatet e rindërtimit nuk u arritën për shkak të pandemisë”- theksoi Rama.

Vjeshtë 2022

Vetëm 1 muaj më vonë, në 26 nëntor 2021, në dy-vjetorin e tërmetit tragjik të 2019-s, në një intervistë për News 24, ministri i Rindërtimit Ahmetaj theksoi:

“Puna përfundimisht do mbarojë në vjeshtë të vitit 2022”.

Shtyrja e vazhdueshme e afateve të përfundimit të rindërtimit të banesave të prekura nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, ngre dyshime mbi arsyet e zvarritjes së procesit të rindërtimit.



GJETJE & REKOMANDIME

GJETJE 1

Nga Konferenca e Donatorëve në Shkurt të vitit 2020 Shqipëria **përfitoi një angazhim** për të asistuar në përmbushjen e nevojave në shumën totale prej **1.15 miliard euro**, nga të cilat rreth **295 milion euro në grante** dhe rreth **853 milion euro në kredi**.

11 muaj më vonë nga mbyllja e vitit 2020, ndryshe nga sa është raportuar në relacionin e zbatimit të buxhetit për vitin 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në përgjigjen e saj të datës 9 Dhjetor 2021 konfirmon konstatimin e Faktoje mbi mungesën e kredive nga procesi i rindërtimit duke u shprehur se **“Nuk është nënshkruar deri në këto momente asnjë kredi”**.

REKOMANDIM

Qeveria Shqiptare duhet të raportoj dhe të bëjë transparencë të saktë ndaj qytetarëve dhe Kuvendit mbi ecurinë e përthithjes së kredive të buta nga Konferenca e Donatorëve dhe të raportojë mbi arsyet e një performancë larg angazhimeve mbi këto kredi, të cilat do kishin një kosto më të ulët për buxhetin e shtetit në krahasim me financimim e shpenzimeve buxhetore me instrumenta borxhi në tregjet vendase dhe të huaja.

GJETJE 2

Sipas Raportit të zbatimit të buxhetit Faktit 2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe informacionit të Ministrisë së Rindërtimit rezulton **se 277 milionë Euro ose 94% e granteve të premtuara në Konferencën e Donatorëve janë nënshkruar dhe në zbatim**.

- a Në **portalin e rindërtimit nuk raportohen të dhëna mbi shkallën e përfitimit të granteve** në funksion të procesit të rindërtimit dhe sesa prej tyre janë realizuar apo janë përkthyer në investime publike për qytetarët shqiptarë.
- b Në **raportet e zbatimit të buxhetit si dhe në materialet e projekt-buxheteve nuk raportohet dhe detajohet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga grantet nga Konferenca e Donatorëve** dhe projektet e investimeve që këto grante mbështesin.
- c Sipas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në lidhje me nivelin e disbursimit të granteve për rindërtimin, **nuk identifikohen në databazën e “Sistemit Informatik të Menaxhimit të Ndihmës së Huaj, të dhëna të raportuara nga partnerët për zhvillim.”**

REKOMANDIM

- a Lista e plotë e objekteve të financuara nga donatorët me vlerat përkatëse të jetë pjesë e raportimit si pjesë e realizimit të buxhetit por edhe portalit të transparencës.

- b Qeveria Shqiptare në përputhje me kërkesat ligjore për menaxhimin e sistemit buxhetor të ndjekë dhe raportojë periodikisht mbi ecurinë dhe nivelin e disbursimit të granteve nga rindërtimi për projektet që ata financojnë.
- c Në treguesit fiskal të raportohen të ardhurat nga grantet dhe realizimi i tyre dhe në listën e investimeve të detajohen projektet e financuara nga grantet dhe ecuria e tyre faktike.

GJETJE 3

Nga analiza e Vendimeve të Këshillit të Ministrave që alokojnë fondet për rindërtimin dhe mundësojnë firmosjen e kontratave dhe fillimin e punimeve rezulton se: **Vlera e alokuar prej vitit 2020 është në tejkalim të buxhetit vjetor dhe atij 3-vjeçar të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, duke ndërmarrë kështu një faturë që nuk reflektohet në treguesit fiskalë.**

- a Në vitin 2020, qeveria ka alokuar me VKM, një vlerë prej 46.5 miliardë lekë (ose rreth 381 milion euro) duke hapur kantiere pune, në tejkalim të buxhetit në fuqi në atë vit.
- b Në vitin 2021, kanë vijuar të miratohen fondet me VKM të reja dhe që sot janë të pambështetura me fonde buxhetore.
- c Me buxhetin e ri 2022-2024 vlera e pambështetur në fonde buxhetore shkoj në masën rreth 33.7 miliardë lekë (ose rreth 276 milion euro).

REKOMANDIM

- a Qeveria Shqiptare dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit të bejnë transparencë dhe nxisin llogaridhënien mbi alokimin e fondeve për procesin e rindërtimit si dhe angazhimet e ndërmarra në zbatim të këtyre alokimeve që janë përtej fondeve të buxhetuara dhe miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

- b Të gjitha angazhimet e ndërmarra në zbatim të alokimeve të fondeve me VKM të rregjistrohen dhe raportohen me të dhëna ta sakta dhe të plota sic kërkohet nga legjilacioni në fuqi dhe të ndiqet ecuria e tyre, rregjistrimi në kohe i faturave dhe disburimi i pagesave.
- c Duke raportuar kështu edhe për nevojat shtesë për financim që do mundësonin një pamje të saktë të faturës së rindërtimit dhe ndikimin në borxhin publik.

GJETJE 4

Nga raportimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për fund vitin 2020 dhe publikimin e 10 mujorit të vitit 2021, **rezultoi se ka mos buxhetim në vlerën e plotë të projekteve.**

Në listën e investimeve kapitale 2022-2024 pjesë e projekt buxhetit 2022 **nuk parashikohet asnjë projekt investimi rindërtimi** (jo vetëm FSHZH) në proces apo i ri, ndërkohë që **viti 2022 presupozohet të jetë viti i përfundimit të procesit të rindërtimit.**

Përgjatë vitit **2021 janë hapur projekte të reja të cilat nuk detajohen në vitin 2022.**

REKOMANDIM

- a Qeveria Shqiptare në zbatim të legjislacionit në fuqi por edhe rekomandimeve të FMN duhet të raportojë listën e detajuar të çdo projekti të financuar nga fondet e rindërtimit si në fazë planifikimi buxhetor ashtu edhe në fazë raportimi mbi zbatimin e buxhetit.
- b Detajimi i projekteve duhet bërë sic kërkohet në nivel projekti dhe të përfshihet në ciklin buxhetor dhe kontrollet standard të tij.



Akti Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 10, ka në fokus parimin e informimit dhe transparencës specifikon: Autoritetet publike bëjnë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore. Në nenin 38 të këtij akti, dëshmohet **krijimi i portalit unik qeveritar në funksion të transparencës së procesit të rindërtimit dhe kriteret që duhet të përmbushë.**

Shumë nga informacionet që duhet të përmbante ky portal në bazë të Aktit Normativ, **nuk janë të aksesueshme për qytetarët** në mënyrë të organizuar dhe rifreskuar **ose nuk janë paraqitur fare** (për më shumë referojuni pjesës përkatëse të raportit). Një ndër këto kërkesa të Aktit Normativ ishte dhe publikimi i të dhënave mbi procedurat e prokurimit në funksion të procesit të rindërtimit.

REKOMANDIM

- a Qeveria Shqiptare të garantojë funksionimin e plote të Portalit duke bërë transparencë të paktën në nivelin minimal sipas akteve ligjorë në fuqi. Përveç listës së përfituesve të vendoset dhe lista e detajuar me të dhëna në nivel kontrate dhe operatori ekonomik për prokurimet e zhvilluara në procesin e rindërtimit.
- b Në lidhje me procedurat e prokurimit ato mund të përmbajnë të dhëna për oferta fituese, numrin e konkurrentëve me qëllim nxitjen e transparencës.
- c Të botohet lista e objekteve të rindërtimit që mbulohen nga këto kontrata dhe ecuria në nivel projekti e procesit të rindërtimit me vlerat përkatëse të kostos së financuar.
- d Lista e pagesave të kryera nga thesari për përfitues dhe operatorë ekonomik të bëhet publike dhe të jetë lehtësisht e aksesueshme për qytetarët duke identifikuar programet dhe projektet që i përkasin Procesit të Rindërtimit.



Faktoje konstatoi është se **nuk ka një kategori ku të bëhen raportim periodike, apo vjetore dhe se raporti i fundit rezulton të jetë në vitin 2020**, mbi përdorimin e fondeve buxhetore për rindërtimin.

REKOMANDIM

Qeveria Shqiptare duhet të vlerësoj mundësinë e botimit të raporteve të detajuara periodike për procesin e rindërtimit. Fokusi i këtyre raporteve duhet të jetë mbi ecurinë e outputëve në nivel projekti, qofshin të financuara nga grande apo buxheti i shtetit, dhe përdorimin e inputeve.



Përmbyllja e programi i Rindërtimit dhe të rimëkëmbjes nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019, në 11 bashki të Shqipërisë, **ka patur vazhdimisht ndryshime të afateve.** Në programin e qeverisë shqiptare bërë publik në Shtator 2021, në seksionin për Rindërtimin **fundi i pranverës 2022, ishte afati ku nuk do të kishte më pas një gjurmë të tërmetit.** Ndërsa **në deklaratat të mëtejshme publike të Qeverisë ky afat u shty për në Shtator 2022.**

Në **Bashkinë Tiranë kërkohet raportim dhe transparencë për projekte të alokuara** si dhe në problematikat e identifikuar me buxhetimin dhe raportimin financiar të trajtura në këtë raport. **Përmbushja e angazhimeve për përfundimin e procesit rezulton jo realiste duke u shtyrë gradualisht në kohë.**

REKOMANDIM

Qeveria Shqiptare dhe Njësitë zbatuese të procesit të rindërtimit të raportojnë dhe kryejnë një analizë realiste të ecurisë së procesit të rindërtimit

dhe burimeve të nevojshme për të përmbushur angazhimet. Qeveria Shqiptare të analizojë shkaqet e vonesave në përmbushje të afateve të vendosura si dhe masat që po ndërmerren për përfundimin sa më shpejt të procesit.



Nga puna e kryer në terrën ka rezultuar se **procesi i demolimit të objekteve të dëmtuara nga tërmeti në disa raste ka hasur vonesa dhe ka paqartësi për klasifikimin e objekteve** nga banorët e godinave të klasifikuara të dëmtura të cilët banojnë ose ka rrezik të banojnë në to.

Procesi për demolimin që i hap rrugë rindërtimit ka hasur vonesa si në rastin e Bashkisë Tiranë. **Ndryshimet e klasifikimit të objekteve ndërtimore**, heqja dhe shtimi i objekteve nga procesi rindërtimit ende pas 2 vjetësh (shih rastin e Rezidences Studentore nr. 16) është **tregues i sfidave të këtij procesin dhe rrit riskun në përfshirjen në këtë proces të punëve publike që nuk janë detyruesisht të lidhura me tërmetin e nëntorit 2019.**

REKOMANDIM

Qeveria Shqiptare së bashku me Institutin e Ndërtimit dhe njësitet zbatuese të bëjnë transparente në nivel objekti dhe datë vlerësimi përfundimtar listen e objekteve të dëmtuara nga tërmeti si dhe kalsifikimin e tyre. Cdo ndryshim apo shtesë në këtë listë të bëhet transparente. Mbi të gjitha për të siguruar jetën e banorëve, objekteve të klasifikuara si të pabanueshëm dhe ende për tu demoluar duhet të trajtohen si të tilla dhe të mbetën larg aksesit të publikut. Qeveria duhet të kryej një analizë të ecurisë së procesit të demolimit me qëllim përmbushjen e angazhimeve për përfundimin e sukses të procesit.



Me VKM Nr. 212, datë 11.03.2020, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore", Bashkisë Tiranë i alokohet një vlerë totale prej 3.63 miliardë Lekë (ose rreth 30 milionë Euro) për rindërtimin e objekteve arsimore. Fondi total i alokuar Bashkisë Tiranë është rritur me 2.48 miliardë lekë (ose rreth 20 milionë Euro) duke kapur një vlerë totale për këtë bashki në vlerën 6.11 miliardë lekë (ose rreth 50 milionë Euro) për rindërtimin e objekteve arsimore në këtë njësi zbatuese.

Me fondet e alokuara me VKM 212, të ndryshuara, do të financohej rindërtimi i 22 objekteve arsimore në Bashkinë Tiranë, mbikqyrja e punimeve të tyre dhe mobilimi. Nga analiza e Dokumentave Standarde të Tenderave, rezulton se për këto objekte arsimore janë nënshkruar 5 marrëveshje kuadër me vlerë totale rreth 6 miliardë lekë , për rindërtimin, mbikqyrjen e punimeve dhe mobilimin e tyre. Ndërsa vlera e alokuar me VKM për Bashkinë Tiranë ka qenë 5.18 miliardë lekë.

Pra **Bashkia në Tiranë ka hyrë në marrëveshje kuadër për një vlerë rreth 810 milionë Lekë (ose rreth 6.64 milionë Euro) në tejkalim të fondeve të alokuara në atë moment. Legjislacioni në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor nuk lejon marrjen e angazhimeve financiare (kontratave) në tejkalim të fondeve të alokuara në momentin e firmosjes së tyre.** Për më tepër ky legjislacion kërkon që kontratat të regjistrohen në sistemin e thesarit brenda 5 ditëve nga data e firmosjes së tyre. Mos zbatimi i dispozitave ligjore, ka dhe masat përkatëse administrative që duhen marrë.

REKOMANDIM

Qeveria Shqiptare duhet të disiplinojë procesin e regjistrimit dhe raportimit të angazhimeve për të adresuar riskun e marrjes së angazhimve apo lidhjes së marrëveshjeve në tejkalim të fondeve të akorduara

me VKM. Për angazhime të ndërmarra në tejkalim të fondeve të akorduara nga njësitë zbatuese të zbatohen masat e parashikuara në legjislacionin në fuqi. Qeveria të disiplinoi procesin për tu siguruar që të gjitha kontratat janë të mbështetura me fonde buxhetore dhe nuk kthehen në borxh të fshehur për qytetarët.



Qeveria Shqiptare me VKM nr. 1134, datë 24.12.2020, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, në bashkinë Tiranë dhe caktimin e bashkisë Tiranë si njësi zbatuese.”, i caktoi bashkisë Tiranë një fond prej rreth 1.61 miliardë lekë (ose rreth 13.2 milionë Euro) për rindërtimin disa rezidencave studentore (konvikte) dhe një shkolle. Nga analiza e kontratave të lidhura në zbatim të kësaj VKM-je rezulton se është lidhur kontratë duke përdorur si burim financiar “VKM 1134” **për ndërtimin e shkollës “Besim Daja” në vlerë totale rreth 140 milionë lekë ose 1.15 milionë Euro ndërkohë kjo shkollë nuk është pjesë e VKM 1134 si objekt përfitues.** Për më tepër vlera totale e alokuar me VKM 1134 është 1.608 miliardë lekë, ndërkohë **Bashkia Tiranë ka lidhur kontrata në zbatim të kësaj VKM-je për një vlerë 1.69 miliardë lekë, me një tejkalim të fondit të alokuar prej 82 milionë lekë ose rreth 670 mijë Euro.**

REKOMANDIM

Qeveria Shqiptare dhe Ministria e Financave të monitoroj marrjen e angazhimeve buxhetore brenda limiteve të miratura dhe rregjistrimin e tyre në kohë. Të krijoj sic kërkon ligji premisat në sistemin buxhetor për rregjistrimin e angazhimve në vlerë të plotë dhe në kohë dhe të marrë masa për rregjistrim e të gjitha kontratave në sistemin e thesarit. Për cdo vonesë ose mos raportim në plotë të zbatohen kërkesat e legjislacionit në fuqi për masa administrative ndaj njësisë zbatuese për

vonesa në rregjistrimin e angazhimve. Pas kryerjes së vlerësimeve në nivel kontrate dhe angazhimi, për ato angazhime të ndërmarra në tejkalim të fondeve të miratura të zbatohen dispozita e legjislacionit në fuqi që ja ngarkojnë përgjegjësinë nëpunësve të njësisë zbatuese të ngarkuara nga VKM-të përkatëse. Është shumë e rëndësishme ndjekja e angazhimeve në nivel projekti dhe jo vetëm realizim fondi, për të garantuar jo vetëm mos tejkalim të tij por edhe përdorimin e tij për ato output/projektë për të cilat është alokuar duke u kujdesur dhe për variancat sasiore.



Me VKM Nr. 212, datë 11.03.2020, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore”, **FSHZH i alokohet një vlerë prej 4.35 miliardë lekë (ose rreth 36 milionë Euro) për rindërtimin e 45 objekteve arsimore në disa bashki të vendit si dhe mbikqyrja e punimeve të tyre. Vlera e alokuar e rindërtimit (pa mbikqyrjen) është 4.175 miliardë lekë** e ndarë në 7 Lote. Nga analiza e të dhënave për realizimin e kontratave **rezulton se si pjesë e kësaj kontrate është investuar në 37 objekte nga 45 të planifikuar** që do financonte VKM 212. Nga **analiza rezulton se 9 objekte arsimore nuk ishin në listën e paraqitur nga FSHZH:** 2 janë transferuar me VKM nga FSHZH për t’u zbatuar nga njësi të tjera, 3 janë për t’u financuar dhe zbatuar nga EU4Schools, 2 objekte për financim nga KfW Gjermane, dhe 2 objekte nuk mundem të përcaktonim ende çfarë ndodhi. Pas kërkesës së Faktojes për informacion, për rindërtimin e 36 objekteve (pa shkollën Jashar Hoxha që u shtua) janë shpenzuar 3.90 miliardë lekë. **Pra numri objekteve ka rënë me 9 ndërkohë fondet kanë rënë vetëm me rreth 275 milionë lekë.** Nëse llogarisim që Granti Gjerman për 3 shkolla është 11 milion Euro dhe do të financoj dy nga shkollat që më parë kanë qenë pjesë e listës për financim nga VKM nr. 212 atëherë kursimi që duhet t’i vinte buxhetit të shtetit është rreth 894 milionë lekë ose 7.3 milionë

Euro. Po kështu dy objekte arsimore si shkollat 9 vjecarë "Gjon Gjona" dhe "At Zef Pëllumbi" që u transferuan me VKM tek të tjera njësi zbatuese atëherë dhe vlera respektive e tyre, që në total është 424 milionë lekë ose rreth **3.5 milionë euro duhet të ishte kursyer nga FSHZH.**

REKOMANDIM

Qeveria Shqiptare duhet të kryej një analizë të detajuar të financimit të objekteve arsimore duke analizuar variancat si sasiore dhe në vlerë monetare me alokimin dhe shkaqet që sollen këtë situatë. Qeveria Shqiptare të detajoj dhe monitoroj financimet nga rindërtimi në nivel objekti/projekti, se ky mos detajim edhe sipas KLSH e bën të vështirë ndjekjen e zbatimit të projekteve në aspektin financiar. Qeveria Shqiptare duhet të sigurohet që fondet e donatorëve të shërbejnë për uljen e barrës për buxhetin e shtetit. Qeveria Shqiptare duhet të marrë masa për adresimin e risqeve financiare dhe sapo një objekt të jetë financuar nga një burim tjetër apo transferuar për zbatim një njësie tjetër të kryej një analizë transparente për rishikimin e alokimeve të mëhershme që i ishin bërë njësive zbatuese.



Ndryshe nga sa përcaktuar fillimisht me Vendimin nr. 6, datë 16.12.2019, të Komitetit Ndërmintor për Emergjencat Civile dhe me mbylljen e venddepozitimit të Porto – Romanos, **inertet e krijuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019 rezultojnë të jenë depozituar në Landfillin e Sharrës pa pagesë. Sipas Bashkisë Tiranës kostoja për këtë depozitim në këtë Landfill, mbulohen në kuadër të ndihmës për përballimin e pasojave të tërmetit nga Shoqëria "Integrated Energy BV SPV". Rezulton se ky kontribut në natyrë nga shoqëria koncesionare nuk raportohet në listën e donatorëve me vlerën përkatëse të ndihmës së dhënë.**

REKOMANDIM

Qeveria Shqiptare dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore të prekura nga tërmeti, të bëjnë transparencë, të rregjistrojnë, rregullojnë dhe raportojnë ku janë depozituar inertet e rindërtimit dhe volume përkatëse, si dhe vlerën e ndihmës në natyrë të dhënë nga Shoqëria "Integrated Energy BV SPV".



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

“Ky raport është realizuar si pjesë e projektit “Gjurmo Paranë - e rimëkëmbjes nga tërmeti në Shqipëri” mbështetur financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun tëAmbasadës së SHBA në Tiranë.Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorit dhe nuk përfaqesojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.”

